

Jëllmaz Ozakpënar

# Kultura dhe qytetërimi

/një teori mbi qytetërimin/





© LOGOS - A  
2 0 0 3



S H K U P  
P R I S H T I N Ě  
T I R A N Ě



**Jëllmaz Ozakpënar**

# **Kultura dhe qytetërimi**



**/një teori mbi qytetërimin/**



Përktheu nga turqishtja:  
**mr. Ali Pajaziti**

Titulli i origjinalit:  
Yılmaz Özakpınar,  
Kültür ve Medeniyet  
Anlayışları - Bir Medeniyet Teorisi,  
Kubbealtı Neşriyatı, 1. baskı, İstanbul, 1997.

**Jëllmaz Ozakpënar**

# Kultura dhe qytetërimi

**/një teori mbi qytetërimin/**



# Përmbajtja

Hyrje.....	9
KREU I.....	13
Kultura dhe qytetërimi - veçori të njeriut.....	15
Themeli biologjik dhe psikologjik i kulturës dhe qytetërimit	
KREU II.....	23
Mënyrat e të kuptuarit të kulturës dhe qytetërimit.....	25
Qëndrimet antropologjike, sociologjike dhe historike	
Dobësia teorike e qëndrimeve ekzistuese	
KREU III.....	41
Një teori e qytetërimit.....	43
Lindja e qytetërimeve	
Ndarja kulturë-qytetërim	
Relacioni kulturë-qytetërim	
Shkatërrimi i qytetërimeve	
Ndryshimet kulturore	
KREU IV.....	71
Qytetërimet e vjetra në dritën e teorisë së elaboruar.....	73
Qytetërimi i Mesopotamisë.....	77
Qytetërimi i Egjiptit.....	97
Qytetërimi grek.....	103
Qytetërimi romak.....	119
KREU V.....	127
Panorama e sotme dhe pamja e ardhmërisë.....	129
Bota ndërmjet qytetërimit Islam dhe atij perëndimor	
Treguesi.....	165



## Hyrje

Në çështjen e të kuptuarit të kulturës dhe qytetërimit, midis shkencëtarëve dhe mendimtarëve, ekzistojnë dallime të dukshme. Nga ana tjetër, në pikën e "mjegullirës" rreth çështjes së përmbajtjes së këtyre dy koncepteve ekziston pothuajse një unitet total mendimesh (konsensus). Në pjesën e shtatë të ligjëratave mbi kulturën dhe qytetërimin, që do të zgjatin pesë javë, do ta trajtoj veçorinë më të përgjithshme të kulturës dhe qytetërimit. Pa marrë parasysh përmbajtjen e veçantë të fenomeneve të quajtura kulturë dhe qytetërim, mund të thuhet se ekziston një cilësi e përbashkët e tyre. Si kultura ashtu edhe qytetërimi, nuk janë fenomene që ekzistojnë në natyrë para veprave të njeriut. Lindja dhe formimi i tyre nuk mund të trajtohen si rezultat i kapaciteteve të lindura të njeriut apo si rezultat automatik i fantazisë gjenetike të tij. Pra, kultura dhe qytetërimi nuk janë fenomene që njeriu i gjen të gatshme në natyrë ose në strukturën e vet biologjike. Njeriu, kulturën dhe qytetërimin, i formon në një fushë të mundësive në saje të preferimeve të veta. Në pjesën e shtatë të diskutimit tim serial, do ta elaboroj themelin biologjik dhe psikologjik të kulturës dhe qytetërimit. Ky themel që e dallon njeriun nga gjallesat tjera - qytetërimin dhe kulturën i bën cilësi specifike të njeriut.

Javën e ardhshme, në pjesën e dytë, do t'i qasem shkakut të ekzistimit të koncepteve të ndryshme mbi kulturën dhe qytetërimin në sferë të antropologjisë, sociologjisë

dhe historisë. Po ashtu do të mundohem të tregoj se njëri nga shkaqet kryesore të shumësisë në të kuptuarit e kulturës dhe qytetërimit është përkufizimi i tyre duke u bazuar në përshtypje personale. Kur shihet se shumësia dhe kompleksiteti i ngjarjeve nuk mund të përmblihen brenda përkufizimeve, flitet për *paqartësinë* - sikur ajo të ishte një veçori e domosodshme e temës në fjalë - *e çështjes së koncepteve kulturë dhe qytetërim*. Kurse e vërteta është se *konceptet kulturë dhe qytetërim nuk janë të pavarura nga botëkuptimet tona*. Konceptet janë mjete të shkencave në sferë të të menduarit, kuptuarit dhe sqaruarit. Në shumë raste qysh në hap të parë, një qëndrim rreth kulturës dhe qytetërimit që përputhet me preferimin personal ose botëkuptimin e përgjithshëm prezentohet si një përkufizim i prerë. Përkufizimet e këtilla, në vend që të bëjnë përpjekje ta kuptojnë thelbin unifikues të ngjarjeve në planin observues të tyre, mundohen t'i tregojnë dallimet e "dukurive" konkrete. Kurse, konceptet shkencore, duke i tejkalluar dallimet konkrete sipërfaqësore, me anë të operacioneve ose veprimeve të mendimit abstrakt e nxjerrin në pah thelbin që i unifikon fenomenet. Konceptet shkencore, përkundër klasifikimeve/tipologjive të bazuara në ngjashmëritë, bëjnë determinimin (në planin e mendimit) e pikës së përbashkët të të dukshmive të pangjashëm dhe shpjegojnë se në ç'mënyrë kanë lindur ngjarjet dhe fenomenet në format e tyre manifeste. Si domosdoshmëri e metodës shkencore, konceptet janë në pozitë të hipotezave. Për këtë arsye, ekziston nevoja e verifikimit të çështjes nëse ato (konceptet) me të vërtetë e shpjegojnë parimin e lindjes së ngjarjeve/dukurive.

Për një teori të qytetërimit, të bazuar në një konceptualizim si ky, si dhe për vetë metodën, më tepër njohuri do të ofroj në kreun e tretë. Atëherë do të kuptohet më mirë se paqartësia në sferën e koncepteve kulturë dhe



qytetërim (çështje kjo që trajtohet në kreun e dytë) buron nga dobësia teorike e qëndrimeve gjegjëse. Do të vërehet se teoria e re nuk ka dalë në skenë me pretendim për prerësi (ekzaktësi) dhe pandryshueshmëri. Si parim metodologjik i shkencës dhe domosdoshmëri e hulumtimit shkencor, teoria shkencore gjithmonë do të mbetet në pozitë të hipotezës. Mu për këtë arsye, nga teoria nuk mund të pritët ekzaktësi dhe pandryshueshmëri. Një teori, pavarësisht se a është e saktë ose e gabuar, për t'u dukur e vlefshme qysh në fillim dhe për t'u treguar interes për të, duhet t'i ketë këto cilësi:

*E para* - duhet të jetë e shprehur shumë qartë, në mënyrë që të mos lë vend për paqartësi. Atë që mëton ta thotë duhet ta shprehë me një gjuhë të prerë.

*E dyta* - duhet të jetë konsistente me vërtetimet (observimet) ekzistuese.

*E treta* - vërtetimet që do ta verifikojnë atë, si rezultate logjike të domosdoshme të strukturës së vet, duhet t'i shprehë qartë dhe prerazi.

Në shkencë merret parasysh vetëm një teori me cilësi të këtilla. Në studimet e bëra duke u nisur nga një teori e këtillë, vërtetimet e bëra *de facto* në kushte të paracaktuara, nëse janë si rezultati logjik i nxjerrë nga teoria përkatëse, do të thotë se teoria mbështetet (përmbahet). Nëse vërtetimet e bëra ndryshojnë nga rezultati logjik, kjo nënkupton se edhe teoria është e pabazë ose e pasaktë.

Teoria shkencore nuk është fundi i një fushe të një subjekti të caktuar. Ajo është në status të një hipoteze, e cila u sjell një rend ngjarjeve në plan të vërtetimit, e cila i jep frytshmëri mendimit dhe ua hap rrugët studimeve të reja. Teoria shkencore prezentohet me një gjuhë të prerë jo për arsye se ajo paraprakisht pranohet si ekzakte, por me qëllim të nxjerrjes së prerë të rezultateve të domosdoshme logjike të teorisë. Rezultati i prerë deri te i cili arrihet, kërkohet në plan të fenomeneve, ndërsa vërtetimet

e bëra në kushte të caktuara, nëse janë si rezultati i domosdoshëm logjik i teorisë, e nënkuptojnë atë se vërtetimet e reja e mbështesin teorinë. Nëse vërtetimet e bëra në kushte të caktuara nuk përputhen me rezultatin e domosdoshëm logjik të teorisë, kjo tregon se vërtetimet e reja e përgënjeshtrojnë teorinë. Një teori e mbështetur nga argumentet e vërtetimit, përderisa nuk përgënjeshtrohet nga hulumtimet e ndryshme, pranohet si e drejtë ose e saktë. Kuptimi i kësaj është: Bile edhe nëse vërtetimet e deritashme e mbështesin një teori, mundësia për shfuqizimin e teorisë në fjalë me anë të vërtetimeve të ndryshme asnjëherë nuk humbet. "Saktësia" në shkencë gjithmonë paraqet një saktësi në shkallë të posibilitetit.

Në shkencë, si pasojë e faktit se teoritë përherë mbeten si hipoteza, po ashtu përherë janë të hapura edhe dyert që me anë të hulumtimeve të reja të gjenden anët e mangëta dhe të gjymta të së njëjtave (teorive). Teoria që nuk përputhet me observime të shëndosha, me gjetjen e një teorie më të mirë, përnjëherë braktiset. Shkenca duke i përmirësuar gabimet e veta, pandërprerë përparon. Ja pra, në kreun e tretë, teorinë time të qytetërimit do ta elaboroj me anë të kësaj metode. Pas "ndërtimit" të kulturës dhe qytetërimit si dy koncepte të ndryshme do ta elaboroj lidhshmërinë reciproke midis tyre. Me anë të këtyre koncepteve do ta shpjegoj lindjen e qytetërimeve, çështjen e ndryshimeve kulturore, shkatërrimin e qytetërimeve etj.

Në kreun e katërt, qytetërimet e vjetra si ai i Mesopotamisë, Egjiptit, Greqisë dhe Romës Antike do të studiohen me qëllim të arritjes së konkluzioneve që do ta verifikojnë teorinë në fjalë.

Në kreun e fundit, do t'i zbërthej pozitat e ndërsjella të dy qytetërimeve të mëdha të gjalla, atij islam dhe atij perëndimor. Nga perspektiva e teorisë së qytetërimit që do ta zbërthej, do të mundohem të parashikoj se si do të duket ardhmëria.

**KREU I**



## Kultura dhe qytetërimi - veçori të njeriut

Njeriu si një gjallesë, çdo sekondë të jetës së vet e jeton me anë të instiktit për të mbetur në jetë. Njeriu dëshiron të jetojë, andaj kapet për këtë jetë. Dëshira për të jetuar dhe mbetur në jetë vijnë nga natyra e njeriut. Kjo tendencë instiktive, është një cilësi që e bashkon njeriun me gjallesat tjera. Të gjitha gjallesat janë të ndieshme ndaj disa ndikimeve fizike dhe kimike të ambientit jetësor. Gjallesat, në korniza të rrethit që e perceptojnë, nevojën e të ushqyerit dhe të vendbanimit, si dhe mbrojtjen nga faktorët e dëmshëm dhe nga armiqtë etj., e plotësojnë me anë të veprave dhe sjelljeve të veta.

Të gjitha gjallesat krijojnë lidhshmëri me rrethin me anë të perceptimit dhe reagimit. Njeriu është lloji i vetëm i gjallesave që reagimet i çliron nga hegjemonia e perceptimeve. Sjelljet e njeriut nuk janë të kufizuara me perceptimin e botës së jashtme dhe reagimin ndaj saj në momentin përkatës, sepse njeriu, bile edhe pas humbjes së trupave dhe ngjarjeve nga plani i perceptimit, mund të vazhdojë t'i përfytyrojë të njëjtit (trupa) në mendjen e vet. Njeriu me operacionet mendore mbi projeksionet simbolike të trupave dhe ngjarjeve, jep gjykime dhe merr vendime në lidhje me veprat që do t'i bëjë. Njeriu, me veprat që i bën sipas vendimeve të tij jashtë ndikimit të stimuluesve konkretë të humbur nga plani i perceptimit, ngritet në një nivel më të lartë të sjelljes nga ai i të gjitha gjallesave të tjera.

Edhe kafshët reagojnë në mënyrë jorefleksive ose joiinstiktive. Edhe ato mësojnë dhe mendojnë. Reagimit të kafshëve që nuk është nga repertori i sjelljeve me prejardhje nga lindja, e i cili është fituar nga përvoja dhe stërvitja, i themi *mësim*. Në situatat me karakter të problemit, kur lind një reaksion që siguron zgjidhje, procesit mendor të relacioneve në planin e perceptimit i themi *mendim*. “Nëse pranojmë se kafshët mendojnë, mund të parashtrohet pyetja vallë ç'dallim mbetet midis njeriut dhe kafshës?” Këtu mbetet një dallim i madh dhe i rëndësishëm. Sepse, të menduarit, te njeriu tregon veçori të shumta që nuk gjenden te asnjë kafshë.

Procesi i mendimit te kafshët, varet nga stimuluesit dhe shenjat konkrete në planin e perceptimit. Bile edhe kafshët që tregojnë reaksion zgjidhjesjellës në planin e perceptimit, si pasojë e faktit se të menduarit e tyre varet nga shenjat konkrete, nëse nuk ekziston plani i perceptimit, nuk mund ta vazhdojnë procesin e të menduarit. Nga ana tjetër, njeriu, botën e jashtme, në mendjen e vet e njeh me anë të simboleve. Pas humbjes së planit të perceptimit, ai të menduarit e vet e vazhdon duke bërë veprime me anë të simboleve në vend të perceptimit konkret. Njeriu i cili krijon relacione konkrete midis simboleve që gjenden në mendjen e tij, duke i nxjerrë rezultatet e relacioneve simbolike merr *vendim* dhe mund të gjykojë nëse janë të drejta ose jo vendimet që i ka marrë. Krijimi i relacioneve midis simboleve, arsyetimi konkret, marrja e vendimit dhe mundësia për ta gjykuar vendimin e marrë, janë lajmërues të kapacitetit specifik të njeriut. Domethënë, njeriu nuk mbetet vetëm me të menduarit me anë të simboleve, ngase ai edhe kur tërhiqet mbrapa mendimit të vet, e studion atë. Njeriu mund të mendojë edhe rreth mendimeve të veta dhe mund t'i studiojë ato sikur e studion ndonjë trup të vrojtimit ekstern.

Njeriu nuk është i vetëdijshtëm vetëm për botën e jashtme, por është i vetëdijshtëm edhe për faktin se është i vetëdijshtëm. Njeriu, mu si kafshët, fiton vetëdije për botën e jashtme me anë të perceptimit. Por, për dallim prej kafshëve, ai është i vetëdijshtëm edhe për atë se zotëron vetëdije për botën e jashtme. Njeriu i cili mendon me anë të simboleve, është i vetëdijshtëm për atë që e mendon. Në saje të këtij potenciali të njeriu zhvillohet koncepti *unë*. Njeriu e përfytyron vetveten si një qenie të ndarë nga bota e jashtme. Ai është i vetëdijshtëm për egon e vet. Në këtë mënyrë, njeriu jo vetëm që e njeh botën e jashtme me anë të perceptimit, por në mendjen "e vet" që e përfytyron ndaras nga bota e jashtme, mund ta krijojë edhe projektionin simbolik të botës së jashtme. Mendja në saje të aftësisë që në psikologji quhet *introspeksion*, mund ta observojë vetveten. *Uni* zotëron edhe me mendjen e vet edhe me *vetëdijen konceptuese/kuptuese* të botës së jashtme.

Të qenët i vetëdijshtëm për vetëdijen, mundësia për të thënë "unë", mundësia për të bërë introspeksion, formimi i koncepteve dhe kryerja e veprimeve me anë të simboleve, paraqesin forma të ndryshme të kapacitetit mental themelor që është specifik për njeriun. Ky kapacitet është edhe baza e fenomenit të gjuhës. Andaj nuk duhet habitur pse fenomenin e gjuhës e hasim vetëm te njeriu. Sepse gjuha, si të qenët i vetëdijshtëm për vetëdijen, paraqet fenomenin e përfaqësimit të botës së jashtme në mendjen e njeriut me anë të simboleve që i ka zgjedhur vetë ai. Fjalët që janë simbol i gjërave jashtë vetes (gjësë), në të njëjtën kohë janë emër koncepti. Fjala "lulja" paraqet simbolin gjuhësor të lules e cila është një trup. Por, ajo në të njëjtën kohë është edhe një emër i konceptit, sepse në botën e jashtme "lulja" nuk ekziston si koncept. Në natyrë nuk ekziston ndonjë lule pa lloj, trup, ngjyrë, ind dhe formë. Atëherë pra, "lulja" nuk është simbol i një trupi të

caktuar në natyrë, por është një koncept që e kemi krijuar në mendjen tonë duke e abstrahuar nga lulet e botës së jashtme. Kur duam ta shpjegojmë një lule të caktuar që ekziston si trup, duhet të bëjmë disa kualifikime, ose duke e shfrytëzuar kontekstin ku është përdorur simboli "lule" duhet paramenduar lulen të cilën e kemi për qëllim. Midis simboleve, relacionet krijohen edhe nëpërmes disa simboleve gjuhësore si lidhëzat ose pjesëzat, të cilat prapë bazohen në të vendosurit. Kësisoj, ngjarjet, fenomenet dhe relacionet e botës së jashtme në mënyrë simbolike barten edhe në mendjen e njeriut. Mendja, bën veprime të mendimit mbi këto simbole dhe arrin në vendime mbi to pavarësisht nga bota e jashtme. Mendja, e cila vendimet në planin e mendimit simbolik i krahason me botën e jashtme, në të njëjtën kohë e kontrollon edhe përputhshmërinë e vendimeve me realitetin.

Njeriu i shpëtuar nga prangat e perceptimit konkret, me anë të projeksioneve simbolike në planin abstrakt, botën e jashtme e bart në mendjen e vet. Duke qenë i vetëdijshëm për vetëdijen, ai e gjykon botën e jashtme. Njeriu, në nivelin e projeksioneve mendore abstrakte, kalon përtej pamjeve konkrete të botës së jashtme. Ai bëhet kureshtar për shkaqet e këtyre pamjeve (aparencave) dhe për trajtën e formimit të ngjarjeve. Në kuadër të aktivitetit të projektimit dhe gjykimit ai krijon koncepte sqaruese, ndërsa me anë të proceseve të arsyetimit rreth projeksioneve simbolike mbi evenimentet konkrete që i bart në mendjen e vet, bën abstraksione dhe krijon relacione. Në këtë mënyrë duke u nisur nga dukuritë konkrete të botës së jashtme, ngritet në parimet sqaruese *që ekzistojnë vetëm në mendjen e vet*. Parimet sqaruese, nga ngjarjet konkrete nxirren me anë të operacioneve të arsyetimit. Por, ato (parime) nuk i përkasin fushës së vrojtimit (observimit), d.m.th. nuk i përkasin natyrës. Në natyrë ekzistojnë



vetëm ngjarje, dukuri të vrojtueshme. Parimet sqaruese nuk mund të vrojtohen. Ato krijohen në mendjen e njeriut me anë të disa operacioneve simbolike.

Ja pra, *dija (dituria)* në kuptimin shkencor paraqet një trajtë konceptuese të mendjes së njeriut, gjykim (vendim) i dhënë dhe parim sqarues që e derivon ajo (mendja e njeriut). *Dija shkencore* nuk paraqet përshkrim të ngjarjeve konkrete, por parime abstrakte që e sqarojnë formimin dhe ngjarjen e tyre. Dija nuk është një përvojë perceptuese pasive. Edhe kafshët perceptojnë, por vetëm njeriu është ai që nga perceptimet, pjesë-pjesë nxjerr një projeksion simbolik të plotësuar të botës. Njeriu, duke i tejkaluar tjetërshmëritë në aparenat konkrete të ngjarjeve me anë të arsyetimit, duke bërë abstraksione zhvillon një pikëpamje, apo një botëkuptim. Duke shikuar nga një kënd konceptual, ai e nxjerr parimin abstrakt që i bashkon tjetërshmëritë.

Fakti që te kafshët nuk ekziston fenomeni i gjuhës, nuk është një çështje që ka të bëjë me pamjaftueshmërinë e organeve të të folurit, por është një çështje që ka të bëjë me mungesën e kapacitetit mendor. Kafshët nuk janë të vetëdijshme se janë të vetëdijshme për botën e jashtme. Ato nuk arrijnë te koncepti *unë*, nuk mund të bëjnë introspeksion, nuk mund t'i studiojnë proceset e veta mendore, nuk mund të mendojnë simbolikisht dhe nuk mund të krijojnë koncepte. Për shkak të kësaj varfërie intelektuale, ato nuk mund ta realizojnë as fenomenin e gjuhës, sepse gjuha nuk është gjë tjetër pos një sistem simbolik i krijuar në formën e të qenët i vetëdijshtëm për vetëdijen.

Në themelin e krijimit të marrëdhënieve shoqërore dhe strukturave shoqërore që tregojnë kontinuitet, te njeriu prapë qëndron kjo aftësi (kapacitet). Te njeriu nuk ekziston mekanizmi i refleksive dhe instikteve që do t'ia mundësonte atij të jetojë si individ ose i mëvetësuar. Mu

për këtë arsye themi se vazhdimësia e gjinisë së njeriut varet nga krijimi i strukturave shoqërore duke filluar nga familja e kështu me radhë. Vazhdimësinë e strukturave shoqërore e mundësojnë normat që e rregullojnë interaksionin midis individëve. Normat e sjelljes formësohen duke u kryer veprat e caktuara. Në lëminë e interaksionit shoqëror, të vrojtueshme janë vetëm sjelljet. Përveç kësaj, individët që janë duke u edukuar, normat i abstrahojnë nga sjelljet dhe të njëjtat i mësojnë.

Njeriu, siç mund t'i inspektojë dhe gjykojë mendimet e veta lidhur me botën e jashtme, po ashtu mund t'i inspektojë dhe gjykojë edhe veprat e veta në rrafshin e mendimit simbolik. Ja pra, koncepti i *moralit* lind si pasojë e një kapaciteti të këtillë mendor. Individu, veprat e veta dhe të tjerëve i vlerëson duke i kualifikuar si *të mira* ose *të këqija*. Normat e sjelljes që i rregullojnë marrëdhëniet midis individëve të një shoqërie të caktuar dhe që rrëfejnë se si duhet vepruar në kushte dhe rrethana të caktuara, e formojnë moralin, mbi të cilin mbështetet struktura shoqërore.

Ekzistojnë shumë lloje të kafshëve që jetojnë në gjendje të bashkësisë. Pjesëtarët e këtyre bashkësive kryejnë vepra të ndikimit të ndërsjellë (interaksionit), por normat që e rregullojnë jetën e këtyre pjesëtarëve janë rezultat i një organizimi biologjik. Kafshëve nuk u bie ndërmend dhe nuk duan të sillen ndryshe, d.m.th. ato nuk mund të veprojnë jashtë këtyre normave. Kurse njeriu, në kuadër të një fushe të mundësive, veprat e veta i zgjedh me plot vetëdije dhe vetëvendosje. Para dhe pas kryerjes së akëcilës vepër, ai mund ta inspektojë dhe të japë gjykim duke e kategorizuar atë si të mirë ose të keqe. Rregullat e vërejtura në sjelljet e kafshëve që duken si sjellje shoqërore nuk janë norma të derivuara me anë të operacioneve të mendimit simbolik, por janë norma të programuara në aspektin biologjik. Për këtë arsye, normave që e rregullojnë

jetën e kafshëve në bashkësi nuk mund t'u thuhet moral, sepse morali nënkupton zgjedhje dhe vlerësim të vetëdijshëm. Kafshët, pasi që janë të privuara nga aftësia e reprezentimit simbolik, mund të thuhet se janë të burgosura brenda kornizave të perceptimit të botës së jashtme dhe reagimit ndaj saj. Kafshët, të cilat nuk mund të përdorin simbole dhe të cilat nuk mund të bëjnë projeksione me anë të operacioneve mendore mbi simbolet, nuk mund të arrijnë deri te dija abstrakte. Kafshët, të cilat reaksionet e veta në planin e mendimit nuk mund t'i marrin nën fokusin e studimit, nuk mund të marrin vendim për ndryshimin e mënyrave të reagimit. Në llojet e ndryshme të kafshëve, pos atyre më të thjeshtave, ekziston aftësia për të mësuar. Por ç'e do që të mësuarit e kafshëve është imagjativ (fiktiv). Për këtë arsye, të gjithë pjesëtarët e një lloji të caktuar në çdo brez mësojnë në trajtë të njëjtë. Në reaksionet e treguara nga pjesëtarët e ndryshëm të kafshëve nuk ekziston dallim i madh. Kjo është kështu ngase kafshët përvojat e veta në lidhje me botën e jashtme në mendjet e veta nuk mund t'i reprezentojnë në nivelin simbolik dhe nuk mund të arrijnë në vendime duke bërë operacione me simbole abstrakte. Sikur që nuk ekziston dallim midis pjesëtarëve të një brezi, po ashtu nuk ekziston dallim edhe midis brezave të ndryshëm. Te kafshët, si pasojë e strukturës gjenetike, ekzistojnë reaksione të gatshme dhe mësimet statike të lidhura me organizimin gjenetik. Reaksionet, në kuadër të kësaj fushe të mundësisë nuk tregojnë variabilitet (ndryshueshmëri). Kafshët, pasi që nuk mund të projektojnë dituri abstrakte lidhur me botën e jashtme dhe pasi që nuk mund të bëjnë plan të aksionit për ndryshimin e saj, të njëjtën nuk mund as ta ndryshojnë. Ato kënaqen vetëm me reagime të kallëposura (të modeluara). Duke përdorë një shprehje të temës sonë, mund të themi se kafshët nuk mund të krijojnë kulturë dhe qytetërim.

Më parë thashë se, pa marrë parasysh përmbajtjen e kulturës dhe qytetërimit, këto dy fenomene në natyrë nuk ekzistojnë vetvetiu. Kujtoj se sqarimet që i bëra, qartë tregojnë se ç'kapacitet mendor nevojitet për krijimin e kulturës dhe qytetërimit. *Veglat (mjetet)* që i ka ndërtuar njeriu për t'i plotësuar nevojat e veta në mënyrë efektive dhe produktive, *mitologjitë* që i ka zhvilluar si përgjigje ndaj pyetjeve që kanë lindur në mendjen e tij në lidhje me ngjarjet, fenomenet në natyrë dhe fatin e vet, *veprat artistike* që i ka krijuar me qëllim të caktimit dhe shprehjes së ndjenjave të veta, *normat morale* që e bëjnë të mundshme koekzistencën, *gjuha*, e cila ndihmon në sferën e përfaqësimit dhe përcjelljeve të diturive me anë të simboleve, *besimi*, që mbështetet në konceptimin e diturive me burim nga zbulesa hyjnore (vahi), *shkenca* e cila paraqet një metodë të verifikimit të hipotezave lidhur me mekanizmin e formimit të dukurive natyrore, thënë shkurt të gjitha fenomenet me të cilat hyjmë në marrëdhënie me kulturën dhe qytetërimin, paraqesin vepër të një kapaciteti mendor-intelektual që është specifikë vetëm e njeriut. Kultura dhe qytetërimi kontinuitetin dhe trashëgiminë e vet e ruajnë duke u përcjellë prej brezi në brez me anë të gjuhës. Përcjellja e të folurit, që bart një sistem simbolik, me anë të shkrimit, i cili paraqet transfer në një sistem simbolik tjetër, duke i penguar harrimet dhe shtrembërimet, njohuritë ose të dhënat i ruan ashtu siç janë. Anëtarët e një shoqërie, kulturën dhe qytetërimin, të cilat shfaqen në sjelljet e tyre, brezave të ardhshëm ua përcjellin me anë të interaksionit. Injektimi i stilit jetësor të një shoqërie brezave të rinj quhet *terbije*. Procesit të përgatitjes së brezave të rinj duke e shfrytëzuar trashëgiminë e ruajtur me anë të veprave të shkruara, duke i shfrytëzuar metodat e zyrtarizuara dhe institucionin e shkollës i themi *edukatë (ëgëtim)*. Edhe *arsimimi (ögëretim)*, i cili paraqet procesin e mbjelljes së njohurive të caktuara nga tema të caktuara, është pjesë e edukatës.

# KREU II



## Mënyrat e të kuptuarit të kulturës dhe qytetërimit

Metoda e re shkencore e simbolizuar me hulumtimet e Galileut në shek. XVII, paraqet një pikë kyç në historinë e mendimit njerëzor.

Aristoteli, edhe pse ka jetuar katër shekuj para Isait (a.s.), filozof ky i cili në Evropë si manifestim i fatit ose Kishës është sjellë në pozitë të përfaqësuesit të mendimit mesjetar, nga mendimet që ai i ka parë si të vërteta të kthjellëta dhe të pakontestueshme (aksioma-A.P.), ka derivuar përfundime logjike që i kanë përmbajtur mendimet në fjalë dhe, në këtë mënyrë i ka shpjeguar fenomenet në çdo subjekt ose temë dhe ashtu ka marrë vendime në sferë të çështjeve të caktuara. Provë më e mirë se me çfarë arsytimi të prerë dhe të pakontestueshëm janë arritur këto përfundime është vetë fakti i pranimit të Aristotelit si autoritet të padiskutueshëm për më tepër se dy mijë vjet. Por, metoda e Galileut, tregoi një mangësi të zgjidhjes së çështjeve me metodën aristoteliane. "Thembra akiliane" e kësaj metode ishte kjo: Nëse ideja, që, në fillim duket si e vërtetë e pakontestueshme, është e gabuar, pa marrë parasysh se me ç'logjikë të fortë dhe të sigurtë rezonohet, edhe përfundimet e arritura janë të gabuara.

Galileu nuk është nisur nga idetë për të cilat ka besuar se janë aksiomatike. Duke u nisur nga vërtetimet, ai arriti deri te një ide e cila i sqaron ato në një trajtë

konsistente. Ai mendonte se, bile edhe nëse ideja deri te e cila ka arritur, i sqaron vrojtimit si konsistente, ajo ide menjëherë nuk mund të pranohet si e drejtë. Kjo për të është kështu për arsye se ekziston mundësia e arritjes në ide të tjera që të njëjtat vrojttime i sqarojnë në mënyrë konsistente. Në këtë rast, çështja lidhej në pikën e verifikimit nëse ideja e arritur është e vërtetë. Si mund të arriheshin provat (argumentet)? Një mendim i saktë që e sqaron natyrën, duhet që patjetër të përmbajë disa përfundime lidhur me dukuritë natyrore. Në atë rast, përfundimet që i përmban mendimi derivohen me një logjikë të domosdoshme dhe nëse kështu vihen përballë natyrës, nga përputhshmëria ose mospërputhshmëria e tyre kuptohet se a është ose nuk është i drejtë mendimi i caktuar. Nëse mendimi është i drejtë, rezultatet e tij logjike në lidhje me fenomenet natyrore njëjtë duhet të vrojtohen edhe në natyrë. Mendimi, me anë të rezultateve logjike që i përmban, pararrëfen se ç'do të vrojtohet në natyrë në kushte të caktuara. Vrojtimi, të cilin mendimi e bën të menduar dhe të kërkuar në natyrë, nëse përputhet me eksperimentin e bërë në kushte të caktuara sipas rezultatit logjik të idesë, do të thotë se mbështetet nga ideja e cila nga vetvetja me një logjikë të domosdoshme e nxjerr rezultatin e vrojtimit. Në eksperiment, nëse bëhet një vrojtim që nuk përputhet me rezultatin që e ngërthen ideja, do të thotë se natyra e përgënjeshton atë ide.

Kjo *strategji e verifikimit*, e cila përbën themelin e mentalitetit shkencor dhe palcën kurrizore të metodës shkencore në dy pika dallon nga mentaliteti i Mesjetës. E para - mendimi në fillim nuk pranohet si një e vërtetë e pakontestueshme. Pika e dytë, që në fakt është e lidhur me pikën e parë, është kjo: Pranimi i rezultateve të mendimit si të vërteta nuk varet vetëm nga kushti i të qenët e tyre të derivuara me një logjikë të drejtë. Ajo varet edhe nga kërkimi



i tyre (rezultateve) në natyrë dhe të përputhurit e tyre me të. Kësisoj, edhe pse arsyetimin e bën shkencëtari, fjalën e fundit në çështjen e saktësisë së mendimit e thotë natyra. Ja pra, procesit të ballafaqimit të rezultateve të domosdoshme logjike me natyrën, ose dhënies së fjalës së fundit natyrës në çështjen e vërtetësisë së mendimit, i themi *operation i verifikimit*. Sistematizimet që e sigurojnë këtë operation i quajmë *eksperiment*. **Baza e eksperimentit shkencor** nuk është **të provuarit** në trajtën *të shohim se ç'do të bëhet ose ç'do të ndodhë*, por **verifikimi i idesë** (së formuar para eksperimentit) në trajtën *të shohim a do të bëhet ose ndodhë ashtu*.

Pra, specifika e mentalitetit shkencor të Shekullit të Ri përballë natyrës, është strategjia e verifikimit e cila e jep mundësinë e peshimit të shkallës së përputhshmërisë së mendimeve me natyrën. Kjo është pika që mentalitetin shkencor të Shekullit të Ri e dallon nga logjicizmi në të cilin ishte tërhequr Mesjeta. Në procesin e vendosjes për vërtetësinë dhe saktësinë e një mendimi sqarues, si shtojcë logjike, operationit të verifikimit i bëhet referim i cili mbështetet në vërtetime eksperimentale. Për ta gjetur të vërtetën në lidhje me natyrën kusht është zhvillimi i mendimit me një logjikë të drejtë. Pra vetëm saktësia logjike siguron *qëndrueshmëri* të mendimit. Faktin, nëse mendimi përputhet (është i përshtatshëm) me natyrën, e tregon operationi i verifikimit. Baza e eksperimentit shkencor mund të rezymohet në tre shkallë:

1. Arritja deri te ideja sqaruese duke rezonuar mbi vërtetimet që ndjellin kurajo.

2. Nxerrja e përfundimeve nga natyra që e përmban ideja deri te e cila është arritur (këto përfundime shpiejnë në planin e eksperimentit).

3. Verifikimi i idesë me anë të vërtetimeve të reja të bëra në kushte të determinuara me qëllim të kërkimit të atyre përfundimeve (rezultateve).

Në shkencë, ideja sqaruese quhet *teori*, ndërsa teoria është një hipotezë. Teoria bile edhe nëse mbështetet me operacione të shumta verifikuese, prapëseprapë nuk pranohet si e vërtetë e prerë. Teoria e mbështetur piloton ose udhëheq me veprimtarinë e ardhshme shkencore. Por, teoria bile edhe nëse në çdo fazë të studimeve mbështetet me prova (argumente), prapëseprapë mbetet hipotezë. Andaj edhe sikur të arrihej ekzaktësia në cilëndo qoftë fazë, hulumtimet shkencore do të duhej të ndërpriteshin.

Nëse ndalemi pak me kujdes mbi strategjinë verifikuese, do të vërejmë se ajo nuk është e kufizuar vetëm me mendimin shkencor, sepse kjo strategji, në përgjithësi është një trajtë produktive dhe e përshtatshme e të menduarit. Në çdo lëmi ose temë, nëse jepet një ide lidhur me një çështje, është shumë e natyrshme që të dyshohet në saktësinë e saj dhe të ndihet nevojë për provimin dhe verifikimin e saj. Qëllimi i verifikimit është gjetja e argumentit *pro* ose *contra* (idesë së shprehur). Detektivi për t'u vërtetuar se  $x$  personi është doras kërkon prova. Mjeku që dyshon në një mikrob të sëmundjes, kërkon prova. Gjykatësi nuk e gjykon të akuzuarin pa pasur prova të caktuara. Tregtari që merr një lajm të tregut, duke e hulumtuar burimin e lajmit dëshiron të bindet nëse lajmi është i besueshëm ose jo. Një njeri i cili e dëgjon një thashetheme, dëshiron të vërtetojë se në çka bazohet pretendimi i tillë. Niveli i fortësisë së standardit që lidhet me pikën e pranimit të rezultateve si *argument*, edhe pse ndryshon sipas rëndësisë që i jepet çështjes dhe karakterit të njeriut dhe në përgjithësi idetë, në çdo fazë të jetës, sipas disa argumenteve të vrojtimit vlerësohen nga pikëpamja e saktësisë. Natyrisht, nuk duhet harruar se në rastet kur në çështjen në fjalë përzihen pasionet dhe emocionet, të cilat e pengojnë të menduarit e drejtë, një-rëzit, pa ndjerë nevojë për verifikim, menjëherë i ngjiten

një ideje dhe ia mbyllin dyert çdo argumenti kundër ide-së gjegjëse. Por, këto raste duke i llogaritur si ekskluzivitete, mund të themi se shkenca, operacionin e verifikimit, të cilin e bëjnë edhe njerëzit e rëndomtë, e trajton si një punë serioze dhe e kryen në mënyrë sistematike. Përparësia e shkencës qëndron në faktet se ajo nuk shpejton, se njohuritë metodologjike dhe teknikën e të menduarit ua dhuron studiuesve me një edukatë të posaçme dhe se përkundër rasteve nga jeta e përditshme, në rastet kur nuk gjenden argumente të mjaftueshme, nuk është e detyruar të japë vendim të caktuar. Pothuajse nuk ekziston asnjë fushë ku nuk është shfaqur mentaliteti i verifikimit (që është pjesë e metodës shkencore), mentalitet ky që përfaqëson kalimin nga mesjeta në Shekullin e Ri. Qëndrimet dhe qasjet në jetën e përditshme, stili i përpunimit dhe vlerësimit të temave të artit, stili i zbërthimit të çështjeve shoqërore, teknika e kontrollimit të gjykimeve të dhëna në sferën e historisë etj., pra të gjitha këto janë formuar nën ndikimin e mendësisë së verifikimit

Pas metodologjisë shkencore ekziston një mentalitet i ri që në tërësi ndikon mbi mendimin e njeriut. Asnjë fushë e hulumtimit nuk mund të mbetet e huaj ndaj këtij mentaliteti. Mentaliteti shkencor paraqet një stil të ri të të menduarit dhe të gjykuarit me përmasa globale. Për këtë arsye, ky mentalitet nuk është specifik vetëm për shkencën. Themeli i mendësisë shkencore, të cilën janë të detyruar ta pranojnë edhe joshkencëtarët, është të mbështeturit e ideve në vërtetime dhe verifikimi i tyre me vërtetime të reja. Kështu mund të thuhet se asnjë fushë e hulumtimit që veten e quan "shkencë", bile edhe nëse e ka atributin sociale, nuk mund të dalë jashtë kornizave të mendësisë shkencore. Nuk mund t'u iket përpjekjeve verifikuese duke pohuar se "është rëndë të bëhet eksperiment në fushën shoqërore". Eksperimenti i kontrolluar

është një potencial që në çdo shkencë arrin grada. Me rëndësi është që të bëhen përpjekje me kujdesin, shkathhtësinë dhe precizitetin më të madh për shfrytëzimin e mundësive. Sepse, siç thotë edhe fiziologu i madh i shek. XIX Claude Bernard, eksperimenti paraqet të gjykuarit duke u bazuar në një komparacion. Në eksperiment, vrojtimi krahasohet me një vrojtim të kushteve dhe rrethanave të tjera, i cili në shumë aspekte është i njëjtë me të parin, por dallon nga ai kur jepet gjykim lidhur me ndikimin e dallimit të shkaktuar me vetëdije (në sferën e kushteve) përballë fenomenit. Ekzistenca ose mosekzistenca e këtij ndikimi e luan rolin verifikues të idesë sqaruese që ngërthen rezultat të derivuar në kushte të caktuara nga ndikimi i caktuar. Si strategji, verifikimi ose ekzaminimi në të gjitha shkencat është i njëjtë, kurse teknika e operacionit të verifikimit, gjegjësisht taktika, dallon nga cilësitë e temës së shkencave, nga mundësia e marrjes nën kontroll të kushteve gjatë eksperimentit dhe nga shkathhtësia eksperimentuese e shkencëtarëve të një lëmie shkencore. Me rëndësi është që të ruhet koncepti verifikues i mendësisë shkencore. Në këtë aspekt, shumë normale është që ata që punojnë në lëmenjtë e quajtur "shoqërorë", si sociologjia, antropologjia dhe historia, ta pëlqejnë mendësinë shkencore. Qëndrimi i studiuesve nga këto sfera shoqërore larg rrugës së formimit dhe ekzaminimit të ideve të shkencave natyrore dhe përpjekja për paraqitje sa më racionale të ideve të veta me anë të një teknike të disputacionit që mbështetet vetëm në logjikë dhe bindje psikologjike, nuk është një sjellje e pranueshme.

Në korniza të një arsyetimi, mbështetja vetëm në logjikë dhe bindje psikologjike në vend të referimit fenomeneve që do ta verifikojnë idenë në fjalë, paraqet kryeshkakun e numrit më të madh të mosmarrëveshjeve në fushë të shkencave sociale. Si pasojë e insistimit në një

qëndrim të këtillë, idetë e bazuara në përkufizime të bëra që më parë, qysh në fillim të hulumtimit prezantohen me një bindje se janë të drejta. Idetë, nuk shikohen si hipoteza që duhet të vërtetohen, por si pretendime që duhet mbrojtur deri në fund ose që duhet sulmuar me çdo kusht. Në një platformë si kjo, të pashmangshme janë edhe fërkimet dhe mosmarrëveshjet, që vazhdojnë me një dialektikë të fjalës dhe logjikës të cilat gradualisht përskeqen. Në kuadër të një polemike të këtillë, qëllimi nuk është të kërkuarit e të vërtetës ose të drejtës por të dalurit i drejtë. Në këtë rast, të dhënat e vrojtimit nuk janë të dhëna të kërkuara me qëllim të vërtetimit ose ekzaminimit të një ideje, por shembuj anues të cilat mbrojtësi ose kritiku i ka zgjedhur për ta përforcuar pozicionin e vet. Kjo nuk është rruga e shkencës. Artikujt dhe librat që shkojnë në këtë rrugë, bile edhe nëse janë shkruar duke iu përmbajtur referencave shkencore dhe nëse në to është përdorur terminologji që jep përshtypje të shkencshmërisë, mund të thuhet se në vete bartin një mendësi mesjetare.

Ja pra subjekti i kulturës dhe qytetërimit, pasi që nuk është çliruar nga mentaliteti mesjetar, paraqet një fushë të paqartësive, inkosistencave dhe mosmarrëveshjeve. Në këtë fushë, në vend të *koncepteve shkencore* të "ndërtuara" në pozitë të hipotezave me qëllim të sqarimit të vrojtimeve, ekzistojnë *përkufizime logjike*, në vërtetësinë e të cilave besohet *a priori*. Ja kështu veprohet: Duke u qëndruar besnik deri në fund përkufizimeve të fillimit, bëhet klasifikimi i dukurive në fushën përkatëse, pastaj të njëjtat komentohen dhe jepen gjykime për çështje të caktuara. Kriter është vetëm të qenët racional dhe logjik. Ai që ofron një ide nuk ofron një operacion të ekzaminimit. Ai që e pranon idenë nuk kërkon ta vërtetojë saktësinë e idesë me anë të një operacioni të ekzaminimit. Duke e përdorë logjikën dhe intuitën, bindet në saktësinë e idesë. Edhe ai që e kundërshton idenë, duke mos ndjerë

nevojë për procesin e ekzaminimit dhe duke e përdorë logjikën dhe intuitën e vet bie vendim për josaktësinë dhe jovaliditetin e idesë. Edhe ata *pro* idesë e edhe ata *contra* saj gjejnë shembuj në të cilët i mbështesin pozicionet e veta, por duhet pranuar se këtu ekziston një gabim i mendësisë dhe një mangësi e metodës.

Menjëherë dua të theksoj se prej vlerësimit që e bëra nga aspekti strategjik lidhur me panoramën e përgjithshme, nuk duhet nxjerrë përfundimin se e mohojmë kontributin e mendimtarëve dhe hulumtuesve në sferë të kulturës dhe qytetërimit. Si pasojë e gjurmëve dhe dokumenteve arkeologjike, interpretimeve të bëra në bazë të tyre, si dhe vrojtimeve dhe përpjekjeve mendore për të arritur në një sistem shpjegues, veprat e arkeologëve, historianëve, sociologëve dhe social-psikologëve, të cilat e kanë pasuruar thesarin lëndor dhe mendor, duhet kujtuar me respekt. Edhe vetë shkenca është një traditë. Hulumtimet e kohës aktuale realizohen duke u mbështetur në ato të së kaluarës, duke u nisur nga pika problematike që kanë arritur ato. Por parimisht, në shkencë, idetë, nuk mund të shpëtojnë nga të qenët hipotezë. Për këtë shkak, shkencëtarët, gjithmonë e shqyrtojnë shkallën e "shëndetit" të lidhjes midis ideve dhe fenomeneve.

Deri më sot, lidhur me çështjen e kulturës dhe qytetërimit, nuk është shfaqur ndonjë ide sqaruese në pozitë të hipotezës. Në këtë fushë, në sy bie mungesa e një teorie formale të prezantuar me qëllim të verifikimit (të saj), e cila do t'i plotësonte kushtet e traditës së shkencës empirike. Në të shumtën e rasteve, bëhet përkufizimi i kulturës dhe qytetërimit, dhe më pas, sipas përkufizimit të paraqitur, bëhet klasifikimi dhe interpretimi i fenomeneve. Përkufizimet, pasi që bëhen duke synuar përfshirjen e të gjitha pamjeve konkrete të fenomeneve, janë të gjata dhe dredhuese. Por, pa marrë parasysh se sa një përkufizim është detajoz, prapëseprapë disa elemente dhe tipare

mbesin jashtë tij. Të njëjtat elemente ose tipare që mbesin jashtë, për syrin e një hulumtuesi tjetër janë shumë të rëndësishme. Në këtë rast, e pashmangshme është dalja në eter e përkufizimeve tjera. Kësisoj mund të thuhet se çdo përkufizim disa gjëra i lë pa përfshirë dhe nuk përputhet me përkufizimet tjera. Është më se e vërtetë se asnjë përkufizim, pa marrë parasysh sa do të shumohen, nuk mund ta përfshijë në tërësi tërë larminë dhe komponentët e fenomeneve. Zgjerimi i përfshirshmërisë në kuptimin e vërtetë dhe në trajtë përmbledhëse, është i mundur me anë të abstraksioneve, të cilat arsyetimin e shpëtojnë nga të qenët i varur nga fotografitë konkrete ose manifeste. Në vend të përkufizimeve që e bëjnë përshkrimin dhe tipologjizimin e fenomeneve, duke u nisur nga variabiliteti në fotografitë konkrete të tyre, duhet arritur në një mendim unifikues nga aspekti i cilësisë abstrakte. Përderisa arsyetimi bëhet mbi dukuritë e vrojtues, kualiteti i abstrahuar është një konstrukcion intelektual, d.m.th. një koncept. Koncepti, në fakt është mënyra jonë e të kuptuarit të së vërtetës mbi fenomenet. Koncepti i përshtatshëm i përmbledh fenomenet në një kategori sipas relacionit të rëndësishëm nga lindja e tyre, bile edhe nëse tregojnë ndryshim në pamjet e tyre konkrete. Në këtë aspekt, ideja sqaruese që quhet hipotezë ose teori, duke i hudhur në plan të dytë ndryshorët (variablet) aksidentale ose margjinalë dhe të parëndësishëm, paraqet një koncept të ri i cili në plan të parë e nxjerr relacionin që i bashkon të gjitha fenomenet. Fuqia sqaruese e një teorie që del në skenë me një koncept të ri, vërehet në faktin e tregimit pa kontradikta të lindjes së fenomeneve dhe relacionin midis tyre. Teoria e suksesshme, ngjarjet ose fenomenet, në vend që t'i klasifikojë sipas ngjashmërive, të gjitha i redukton në një parim abstrakt.

Në pjesën tjetër të ligjëratës sime të sontme do të jap shembuj nga përkufizimet e ndryshme të kulturës

dhe qytetërimit. Do të mundohem që nën dritën e mendimeve të mia rreth metodës, të cilat i kam shfaqur deri tani, ta qartësoj mënyrën se si të njëjtat ua kanë hapur rrugët paqartësive, për të cilat ankohen hulumtuesit nga sfera e kulturës dhe qytetërimit.

Mumtaz Turhani (Mümtaz Turhan), i cili çështjen e ndryshimeve kulturore e ka studiuar nga prizmi i social-psikologjisë, në veprën e tij *Kültür Değişmeleri*, vend të gjërë u kushton përkufizimeve të shumta të "kulturës", të cilat i ka studiuar antropologu amerikan E. Sapir. Sapiri pohon se, koncepti kulturë ashtu siç e përdorin etnologët dhe historianët e kulturës, përmban çdo komponentë lëndore dhe shpirtërore të cilat njeriu i përfiton në jetën e vet shoqërore. Kuptimi i dytë që e konstatoi Sapiri shihet në sintagmën "njeriu i kulturuar". Në këtë kontekst me shprehjen kulturë nënkuptohen subtiliteti, xhentiliteti, aftësia e të shprehurit, dituria dhe maniret e njeriut. Por, qëndrimi shoqëror i "njeriut të kulturuar" përmban në vete edhe një distancim nga stili jetësor i popullit dhe shijet e tij. Kuptimi i tretë i kulturës, i cili përsëri kuptimit të parë që e nxjerrin etnologët (të cilët kulturën më tepër e projektojnë si një gjë shoqërore sesa individuale), më tepër i afrohet kuptimit të dytë. Kjo është kështu sepse më tepër përmban elemente shpirtërore sesa materiale. Por prapë sipas Sapirit, nuk mund të thuhet se kultura në kuptimin e tretë përmban vetëm elemente shpirtërore dhe se është e kufizuar vetëm me religjionin, shkencën dhe artin. Sepse, sipas tij, qëllimi i pikëpamjes rreth kulturës që u jep rëndësi elementeve shpirtërore është përmbledhja në një term e qëndrimeve që e determinojnë strukturën specifike të një shoqërie, përmbledhja e vlerave, stilit jetësor, botëkuptimit specifik të saj dhe aparençës së qytetërimit bren-dapërbrenda shoqërisë së njëjtë



Turhani e përcjell përkufizimin e antropologut gjerman, R. Thurnwald, mbi kulturën dhe qytetërimin. Te Thurnwaldi shihet se megjullira në fushë të ndarjes kulturre-qytetërim që e hasim te Sapiri veç më është kthjelltësuar. Sipas Thurnwaldit qytetërim do të thotë pajisje teknike dhe dituri, kurse kulturën e përfaqësojnë struktura e marrëdhënieve shoqërore, mendësia dhe vlerat e një bashkësie. Sistemi i traditave, institucioneve dhe ideve që formohet gjatë jetës në bashkësi e përfaqëson kulturën. Kultura është mënyra e jetesës dhe mënyra e vlerësimit në kuadër të një shoqërie.

Edhe sociologu amerikan R. M. MacIver jep përkufizime në të cilat vërehet dallimi midis kulturës dhe qytetërimit. Përmbajtja e kulturës dhe qytetërimit në përkufizimet e Maciverit tregon dallim që ta asocon Thurnwaldin. Dallimi që e bën MacIver midis kulturës dhe qytetërimit bazohet në funksionet e ndryshme të tyre. Sipas MacIverit, çdo mjet ose vegël e orientuar kah dobia është element i qytetërimit. Qytetërimi i përfshin mjetet materiale dhe teknike, sistemet organizative, ligjet, shkollat, kutitë zgjedhore dhe bankat. Qëllimi i elementeve të kulturës është vetvetja. Ato nuk bëhen vegël e qëllimeve tjera jashtë vetvetes. Kulturën e formon stili jetësor, ai i të menduarit të një shoqërie, marrëdhëniet e përditshme, mënyra e shprehjes së njerëzve në art, në letërsi, në fe, në gëzime dhe ahengje etj.

Sipas Turhanit, është Zija Gokalpi (Ziya Gökalp) ai i cili në Turqi i pari në mënyrë sistematike e ka përkufizuar kulturën dhe qytetërimin. Sipas Gokalpit, qytetërimi është ndërkombëtar kurse kultura kombëtare, ngase kombet të cilat jetojnë në një rreth shoqëror të përbashkët mund të formojnë edhe qytetërim të përbashkët. Format specifike të qytetërimit në kuadër të çdo kombi brendapërbrenda rrethit qytetëruar i paraqesin kulturat. Jeta fetare, morale, artistike, gjuhësore, ekonomike dhe teknike e kombeve të

ndryshme (që janë pjesë përbërëse të një rrethi qytetërimor të njëjtë) mund të kenë shumë pika të përbashkëta. Por prapëseprapë, këto elemente në çdo komb bartin cilësi të veçanta. Një kualitet tjetër mbi të cilin mbështetet tipologjia kulturë-qytetërim është e vërteta se elementet e qytetërimit lindin me një metodë dhe dëshirë individuale, kurse ato të kulturës janë formacione shoqërore. Për shembull, gjuha e një kombi paraqet një formacion të këtillë natyror-shoqëror. Zija Gokalpi thekson se, mendimi filozofik ose teoria shkencore në lidhje me një gjuhë është komponentë e qytetërimit. I njëjtë është edhe rasti me shkencat mbi religjionin, edhe pse të njëjtat merren me elemente të religjionit si besimi, ndjenja, morali dhe adhurimi (ibadeti). Përderisa elementet e qytetërimit përfaqësojnë thesarin e përbashkët të kombeve si pjesë përbërëse të të njëjtit qytetërim, elementet e kulturës i lindin egot e mëvetësishme të kombeve të ndryshme.

Turhani, në sferën e kulturës dhe qytetërimit e parapëlqen përkufizimin e Zija Gokalpit. Ai i kritikon ata që thonë se nuk ekziston dallim midis këtyre dy nocioneve. Sipas tij, ata që mendojnë kështu, kur bëhet fjalë vetëm për një komb mund të duket se kanë të drejtë, por mashtrohen dhe gabojnë si pasojë e dukurisë së fshirjes së dallimeve midis kombeve të ndryshme që e ndajnë qytetërimin e njëjtë. Turhani pranon se elementet kulturore dhe qytetëruese të një populli paraqesin tërësi homogjene, por megjithatë sipas tij, ekziston një realitet që kulturën e një kombi e ndan nga kombet tjera. Kultura kombeve ua dhuron veçantinë. Tërësia sociale më e përbashkët dhe më e madhe e kulturës dhe qytetërimit është kombi.

Sipas Turhanit, në sferën e përkufizimit dhe ndarjes së termeve kulturë dhe qytetërim nga njëri-tjetri, midis dijetarëve ekzistojnë dallime të mëdha. Në literaturën gjermane etnoset dhe kombet, pa iu referuar konceptit qytetërim, ndahen në *Naturvölker* dhe *Kulturvölker*. Në

këtë klasifikim me apelativin *Naturvölker* (shoqëritë e natyrës) emërtohen shoqëritë e cilësuara si "primitive", kurse me atë *Kulturvölker* ato të cilësuara si "të civilizuarra". Turhani cek se kjo tipologji lë përshtypje sikur shoqëritë primitive nuk zotërojnë aspak kulturë. Nga ana tjetër, antropologët dhe sociologët amerikanë dhe anglezë, termin "kulturë" e përdorin kur flasin për të gjitha shoqëritë, gjegjësisht për stilin jetësor si të shoqërive primitive ashtu edhe të atyre të qytetëruara. Ata duke mos bërë klasifikime të tipit e thjeshtë-komplekse, primitive-e përparuar, racionale-iracionale, pohojnë se të gjitha shoqëritë e kanë kulturën e vet. Termin "qytetërim" e përdorin në lidhje me shoqëritë të cilat janë ngritur në një nivel të caktuar, të cilat kanë kulturë të shkruar, të cilat kanë përparuar veçanërisht në fushë të shkencës dhe të cilat duke u nisur nga kjo e kanë përparuar teknologjinë dhe sistemin e vet organizativ. Turhani, pohon se nga aspekti i përparimit midis kulturave, krahasimi mund të bëhet vetëm në pjesën materiale të kulturës, në veçanti në aspektin e teknikës. Mëtej ai shton se në pjesët tjera të kulturës, në zakonet e mira (*wf*) dhe adetet, në stilin jetësor, në normat fetare dhe etike, në organizimin shoqëror dhe në art nuk mund të bëhet një vlerësim "i/e përparuar"- "i/e prapambetur". Turhani potencon se kultura paraqet mendësi, trajtë e vlerësimit, qëndrim dhe pikëpamje specifike. Sipas tij, në këto lëmenj shpirtërorë mund të flitet vetëm për fenomenin e tjetërsimit (tr. başkalaşma). Por, duke u mbështetur në antropologun amerikan Kroeber, thekson se cilësia që qytetërimit grek antik i jep pavdekshmëri dhe e bën që ai perëndimor të llogaritet ve për ose gjurmë e tij është objektiviteti në shkallën më maksimale të mundshme në të qasurit natyrës dhe njeriut. Sipas tij, veprat filozofike dhe artistike të krijuara me këtë pikëpamje ose botëkuptim, e formësonin qytetërimin grek sikur që sot shkenca e karakterizon qytetërimin perëndimor.

Një pjesëtar tjetër i shkencave shoqërore i cili e ka trajtuar çështjen e kulturës dhe qytetërimit është Erol Gyngor (Erol Güngör), i cili kulturën e konsideron si një tërësi të besimeve, njohurive, ndjenjavedhe emocioneve. Edhe pse në kulturë sheh edhe elemente materiale, Gyngori prapëseprapë është i mendimit se elementet materiale janë forma të jashtme reflektuese të kulturës. Për shembull, besimi fetar është kulturë, ndërsa lëvizjet e vrojtueshme nga jashtë që bëhen në namaz paraqesin formë materiale që besimi e merr në praktikë. Gyngori në shumë shkrime të tij qytetërimin e sheh si teknologji. Përskaj kësaj, duke e ndarë mendimin e Sapirit, ai kulturën e përkufizon si trajtë të përcjelljes së qytetërimit ndër shoqëri të ndryshme.

Qëndrimet e dijetarëve perëndimorë dhe atyre turq në lidhje me kulturën dhe qytetërimin, të cilat i përmendëm deri këtu bazohen në përkufizime dhe në klasifikimin e përmbajtjeve të vrojtimeve konkrete. Përkufizimet në fjalë tregojnë edhe ngjashmëri edhe dallime. Por një gjë është e dukshme: edhe nëse e ndjekim ndonjërin nga këto qëndrime e edhe nëse i pajtojmë ato, prapëseprapë nuk do të mund ta kuptojmë qartë se ç'është kultura e ç'është qytetërimi. Vallë, a është kultura vetëm shpirtërore, apo siç theksojnë në disa raste edhe ata që pohojnë kështu, mund të ndahet në kulturë lëndore dhe shpirtërore? Vallë, kultura e shkakton qytetërimin ose qytetërimi e shkakton lindjen e kulturave me tipare të ndryshme? Nëse qytetërimi përbëhet më tepër nga elementet materiale, kurse kultura nga ato shpirtërore, si është e mundur që kultura të konsiderohet stil i përcjelljes së qytetërimit në një shoqëri? Vallë elementet e quajtura materiale janë ekzistenca në formësimin e të cilave nuk depërtojnë elementet shpirtërore, të cilat nuk kanë lidhje me shpirtin e njeriut, të cilat lindin pa kontaktuar me mendësinë, mendimin, njohuritë dhe shpresat e njeriut?

Cili është ai faktor që ka lindur në periudhat kohore kur nuk kanë ekzistuar dallime të mëdha teknologjike midis shoqërive dhe që qytetërimeve u ka dhënë identitete të ndryshme? Kështu kur mundohemi t'u japim përgjigje pyetjeve të lartpërmendura në kuadër të qëndrimeve të theksuara, ose nuk mund të gjendet përgjigje, ose përgjigja e dhënë një pyetjeje tregon se nuk përputhet me përgjigjen e dhënë një pyetjeje tjetër.

Në mesin e historianëve që i studiojnë qytetërimet, perandoritë dhe shtetet e vjetra, e në këtë kontekst edhe jetën shoqërore në to, si p.sh. te Henri Frankforti, hasim perceptime që dallojnë nga konceptualizimet dhe botëkuptimet e social-antropologëve dhe sociologëve. Por, prapëseprapë nuk mund të thuhet se është zhvilluar një qëndrim teorik. Frankforti, i cili potencon se termat "kulturë" dhe "qytetërim" në përgjithësi përdoren si sinonime, më tutje shton se çdo ndarje nuk mund t'i shpëtojë të qenët arbitrare. Sipas mendimit të tij, ekzistojnë arsye etimologjike të preferimit të njërit përballë tjetrit. Fjala "kulturë" asocon në formacionet iracionale, kurse fjala "qytetërim" u drejtohet atyre që njeriun para së gjithash e shohin si *homo politicus*.

Frankforti thotë se qytetërimet paraqesin një "formë", se kanë lindur me një formë. Sipas tij forma nuk është një kallëp konkret në të cilin do të shohim nëse vrojtimit tona përputhen me të ose jo. Forma, kur e trajtojmë si të izoluar, paraqet një tërësi e cila i jep kuptim një elementi kulturor, kuptimi esencial i të cilit nuk duket. Frankforti këtë tërësi e sheh si "qytetërim". Në këtë pikë ai siguron mbështetjen e antropologut amerikan të kulturës, Ruth Benedict. Benedicti, mënyrën e jetesës të quajtur kulturë e sheh si një zgjedhje nga mesi i mundësive të shumta. Në çdo vend, çdo shoqëri i ka zgjedhur institucionet e veta kulturore. Një shoqëri, një element që tjetra e ka trajtuar si aksidental, e ka sjellë në pozitë të

bazës së veprimtarive të veta. Bëhet fjalë për një zgjedhje kompaktësuese. Një vepër e cila si e vetme duket e çuditshme, në relacion me një qëllim të caktuar thuase e ndryshon aparencën dhe fiton një domëthënie shumë të ndryshme. Sipas Benedictit, kuptimi i këtyre veprave është i mundur vetëm me anë të kuptimit të zemberekut të ndjenjave dhe mendimeve të shoqërisë përkatëse. Frankforti, i cili e firmos këtë qëndrim, qytetërimi e sheh si trend të përgjithshëm në veprimtaritë e ndryshme të shoqërisë dhe me këtë sy qytetërimet e vjetra i studion në mënyrë komparative.

Benedicti dhe Frankforti, shprehen se kultura paraqet një tërësi dhe se pjesët e saj kanë kuptim vetëm sipas tërësisë pjesë përbërëse e së cilës janë. Ky qëndrim i tyre inspirimin e merr nga integralizmi i *geshtallt* psikologjisë në formën "tërësia është diçka më tepër sesa shuma e pjesëve". Kjo shprehje edhe pse është një perceptim i bukur megjithatë nuk e kthjelltëson relacionin tërësi-pjesë. Në çdo tërësi, vërehet një karakteristikë e cila e ndryshon perceptimin e pjesëve, por nuk thuhet se ç'është kjo karakteristikë. Geshtallt teoria dhe qëndrimet e Benedictit dhe Frankfortit mbeten si qëndrime që prekin gjëra të rëndësishme, por nuk shpjegojnë qartë se ç'janë ato. Kurse nga ana tjetër, për verifikimin e qëndrimeve shkencore nevojitet që gjëja e thënë të thuhet qartë dhe duke i nxjerrë në pah rezultatet e domosdoshme logjike të idesë së shprehur dhe t'i kërkojë ata në fushë të fenomeneve. Për këtë arsye, geshtallt teoria, e lindur në fillat e shek. XX, edhe pse nga aspekti i proceseve të perceptimit dhe mendimit, mundëson realizimin e vërtetimeve shumë interesante, edhe pse nga shkencëtarët shikohet si shumë racionale, si pasojë e mossigurimit të pjellshmërisë hulumtuese duke sjellë operacione ekzaminuese, është e gjykuar të mbetet në marginat e traditës së hulumtimit shkencor.

# KREU III





## Një teori e qytetërimit

Në ligjëratën time të javës së kaluar u mundova të tregoj se qëndrimet e sociologëve, antropologëve të kulturës dhe historianëve rreth problemit të kulturës dhe qytetërimit kanë mbetur të ngjitura me fotografitë konkrete të fenomeneve dhe se mu për këtë arsye nuk kanë arritur t'i sjellin një rend rrëmujës së detajeve dhe ndryshueshmërive. Është e vërtetë se hulumtimi shkencor bazohet në parimin e vrojtimit dhe studimit të detajeve dhe ndryshimeve të fenomeneve, por vrojtimi dhe studimi i fenomeneve (që presin sqarim) paraqesin vetëm pikënisjen e mendimit shkencor. Pikësynimi i mendimit shkencor është që nga një parim abstrakt të derivohen lidhshmëritë midis fenomeneve, trajta e ngjarjes së tyre dhe variabilitetet në fotografitë konkrete të tyre. Ja pra, kuptimi i fjalisë "synimi i shkencës është sqarimi i fenomeneve" është shprehja e një parimi abstrakt - që i ndriçon fenomenet - në pozitë të një teorie. Teoria në pozitë të hipotezës, e cila vrojtimit ekzistuese i sqaron si konsistente dhe nga premisat që i përmban mund të nxjerrë përfundime në lidhje me fushën e vrojtimit, ka karakter shkencor. Përfundimet që derivohen nga teoria me anë të një logjike të domosdoshme, krahasohen me përfundimet eksperimentale - që janë përgatitur për t'i kërkuar ato përfundime - d.m.th. me atë se në ç'mënyrë bëhet edhe verifikimi i teorisë. Pra teoria shkencore duhet të jetë e verifikueshme, por për të qenë e vlefshme për t'u

verifikuar, më parë duhet që pa kurrfarë kontradikte t'i sqarojë vrojtimit ekzistuese.

Bile edhe nëse teoria, në mënyrë konsistente i sqaron vrojtimit ekzistuese, prapëseprapë ekzistojnë dy shkaqe që na shtiejnë ta ndjejmë nevojën për verifikim.

Shkaku i parë është ai se mund të projektohen edhe teori tjera që përputhen me ato vrojtimit, d.m.th. operationet arsyetuese që gravitojnë duke u ngritur nga vrojtimit kah teoria bazohen në një logjikë të detyrueshme. Teoria është konsistente me vrojtimit, por nuk është rezultat i domosdoshëm i tyre (vrojtimit). Si pasojë e asaj që teoricieni teorinë e vet e ka themeluar duke pasur parasysh që ajo të jetë e qëndrueshme me vrojtimit ekzistuese, teoria e tij mund të përputhet me vrojtimit por mos ta reflektojë realitetin nga natyra. Në këtë rast, qëllimi i procesit të verifikimit është tregimi nëse  $x$  teoria e pasqyron realitetin dhe e përshkruan parimin që i drejton fenomenet natyrore. Nëse bëhet fjalë për më tepër teori, procesi i verifikimit e bart qëllimin e tregimit se vallë njëra nga to është apo nuk është parim që e reflekton realitetin.

Shkaku i dytë që na shtie që teorinë, bile edhe nëse është konsistente me vrojtimit ekzistuese, ta verifikojmë nuk është krejtësisht i pavarur nga i pari. Fenomenet që merren parasysh gjatë formimit të një teorie nuk janë të gjitha të një fushe, por ato janë vetëm disa shembuj nga ato fenomene. Nëse do të ishim shprehur me terminologji të statistikës, do të kishim thënë se shumën e përgjithshme të fenomeneve e quajmë *popullacion (masë)*, kurse fenomenet që vrojtohen si shembull i quajmë *ekzemplarë (modele)*. Sipas kësaj, teoria duhet të jetë në përputhshmëri me ekzemplarin e marrë nga popullacioni. Por parashtrahet pyetja, vallë a përputhen fenomenet me popullacionin? D.m.th. teoria është një teori e projektuar enkas për fenomene të kufizuara të cilat dihen se ç'janë,

ose një teori e cila i përmbledh të gjitha fenomenet, respektivisht pa gabime dhe në mangësi e reflekton realitetin natyror. Ja pra, në operacionet ose proceset e verifikimit kërkohet argumenti i të qenët të teorisë konsistente me popullacionin (shumën e përgjithshme të) e fenomeneve. Një argument me kualitet të këtillë, paraqet vrojtim të ri i cili nuk merret parasysh gjatë formimit të teorisë.

Kjo është logjika e të quajturit të vrojtimit të ri provë ose argument. Nëse teoria është një parim i cili e koncepton realitetin e popullacionit të fenomeneve, ne nga i njëjti, me një logjikë të domosdoshme duhet të nxjerrim përfundim se çfarë rezultatesh do të lindin në natyrë. Kur kemi parasysh se teoria është një bashkësi e premisave të shprehura prerë, themi se rezultatet ose përfundimet e saj nxirren me një logjikë të domosdoshme dhe me shprehje të prerë. Deduksioni logjik thotë se çkado që të vrojtohet në kushte të caktuara e ka kuptimin e planit të eksperimentit. Vrojtimet që bëhen sipas këtij plani, nëse janë ekuivalente me përfundimin e deduksionit, do të thotë se teoria, vrojtimet e reja në lidhje me popullacionin e fenomeneve prej më parë, me një logjikë të domosdoshme, i nxjerr nga brendia e strukturës së vet. Kjo provë, nuk do të thotë se teoria verifikohet si një e vërtetë e prerë. Nëse teoria në operacionin e verifikimit e paradëfton një vrojtim të ri dhe përputhet me të (vrojtimin e ri), kjo do të thotë se ekziston mundësia që e njëjta ta përmbajë parimin që e shfaq të vërtetën. Mosshprehja e vërtetësisë së teorisë prerazi por si potencialitet ose posibilitet, është pasojë e moskonsumimit të popullacionit të vrojtimeve dhe fenomeneve të reja. Kur e kemi parasysh kompleksivitetin dhe ndryshueshmërinë e natyrës, vijmë në përfundim se popullacioni i fenomeneve asnjëherë nuk do të mund të konsumohet. Sipas kësaj, çdo teori shkencore mbetet në status të hipotezës.

Por, teorisë e cila nuk përgënjeshtrohet nga vërtetimet e reja dhe e cila vazhdimisht mbështetet, gradualisht i rriten gjasat që në sytë e shkencëtarëve të jetë e saktë ose e drejtë.

Përparimi permanent i shkencës buron nga të pranuarit e diturisë shkencore si posibilitet e jo si ekzaktësi. Si pasojë e mosarritjes së ekzaktësisë, pandërprerë bëhen hulumtime të reja dhe arrihet në observime të reja. Parimi sqarues, i cili pranohet si i saktë në shkallë të mundësisë dhe i cili bëhet udhëheqës ose busull në sferën e hulumtimeve të reja, sipas atyre observimeve dhe nevojës përmirësohet, ose riparohet. Në rastet kur parimi i teorisë qartë përgënjeshtrohet nga themeli, shkohet në drejtim të formimit të një parimi më përfshirës i cili i sqaron edhe vërtetimet që nuk përputhen me parimin.

Teoria ime në fushë të kulturës dhe qytetërimit të cilën do ta elaboroj duhet kuptuar nga ky pozicion. D.m.th. kjo teori nuk është një pretendim që do ta mbrojë deri në fund, por është vetëm një hipotezë shkencore që do të shqyrtohet. Hipoteza që nuk konfrontohet me vërtetimet e deritashme, që atyre u jep një rend dhe formon një strukturë dhe që rrëmujën e dukshme në sferë të dallimeve konkrete e shndërron në një thjeshtësi që kuptohet ose konceptualizohet me një parim abstrakt, meriton të ekzaminohet. Në pjesën vijuese të ligjëratës sime do ta ekspozoj teorinë dhe do të mundohem të tregoj se është me karakter të hipotezës. Teoria e cila nxit në kërkimin e vërtetimeve të reja (të paracaktuara si duhet të jenë), bëhet frytdhënëse duke i zgjeruar dhe thelluar hulumtimet.

Një teori e caktuar madje edhe nëse përgënjeshtrohet nga ana e vërtetimeve verifikuese, prapëseprapë mbetet e dobishme për shkencën, sepse ne pas atyre vërtetimeve përgënjeshtroese, duke u larguar nga drejtimi të cilin na e ka treguar teoria që na ka shtyrë në vërtetime,

fillojmë të mendojmë. Kësisoj rriten gjasat për gjetjen e destinacionit të vërtetë. Fusha e paqartë e problemit ngushtohet me braktisjen e rajonit të gabimësisë së caktuar nga teoria e përgënjeshtruar. Nëse të diturit është ikje ose shpëtim nga paqartësia, atëherë ngushtimi i fushës së paqartësisë do të thotë fitim i diturisë. Ja pra, teoria e përgënjeshtruar na e mëson një gjë në këtë kuptim. Është e natyrshme që teorinë time ta shpreh duke shpresuar se do të mbështetet me vërtetime të reja, por realiteti i logjikës shkencore është se teoria, qoftë edhe jona, mund të përgënjeshtrohet. Në shkencë, duke u përgënjeshtruar teori të ndryshme, arrihet deri te teoria që akoma nuk është përgënjeshtruar. Teoria e cila sjell një perspektivë të re duke ua hapur shtigjet hulumtimeve të reja bëhet produktive dhe përderisa nuk përgënjeshtrohet, pranohet si "e saktë ose e drejtë".

Ekziston mundësia që dikush të jetë kureshtar se si kam arritur deri te teoria ime e qytetërimit. Kjo pikë ka të bëjë me lindjen dhe zhvillimin e saj. Sonte, interesi i jonë do të jetë i koncentruar në atë se ç'thotë ajo teori në lidhje me çështjen e kulturës dhe qytetërimit. Teoria, pa marrë parasysh se si është arritur deri te ajo, është ajo që është. Mënyra se si është arritur deri tek ajo nuk ndikon pozitivisht ose negativisht në fuqinë e saj sqaruese. Nga aspekti i metodologjisë shkencore, siç u cek edhe më parë, me rëndësi është që teoria të jetë e mbështetur nga operacioni i verifikimit. Edhe pse lindja e idesë kryesore në lidhje me teorinë dhe zhvillimi i saj si një bashkësi e premisave sqaruese formale kalojnë nëpër faza interesante, tema e sotme do të jetë përmbajtja ose brendia e teorisë. Por le të themi se kjo përmbajtje, e cila ma ka zgjuar dëshirën dhe e cila ma ka preokupuar mendjen në drejtim të kthjelltësimit të vërtetimeve me karakter të problemit, është rezultat i një procesi pesëvjeçar (1990-

1995) të mendimit. Me këtë nuk dua të them se para kësaj periudhe nuk e kam lodhur aspak kokën lidhur me këtë subjekt, por mendimi që paraqet bërthamën e teorisë, doli në dritë në tekstin me titull “*Mevlânâ'nın Modernliği ve Modern Bilim*” (Moderniteti i Mevlanës dhe shkencat moderne) që e prezantova në Kongresin II Ndërkombëtar rreth Mevlanës, të mbajtur në maj të vitit 1990 e të organizuar nga Selçuk Üniversitesi (Konja). Fakti se këtë mendim e ndaja me të tjerët më vetëdijësoi në çështjen e kulturës dhe qytetërimit. Kështu më lindi dëshira që mendimin tim - për të cilin kujtoja se e ka prekur të vërtetën, duke e nxjerrë nga pozita e idesë së bazuar në intuitë - ta bie në pozitë të teorisë formale, struktura arsye-tuese e së cilës është e qartë dhe mund të vërtetohet.

Mu në këtë kohë, miku im i ndershëm dhe kolegu im i çmuar prof. dr. Sulejman Hajri Bollaj, (S. H. Bollaj) në cilësi të botuesit, duke më dhënë një afat gjashtëmuor, kërkoi nga unë ta përgatis një studim lidhur me Mumtaz Turhanin. Kjo ishte zanafilla e veprës *Mümtaz Türhan ve Batılılaşma Meselesi* (Mumtaz Turhani dhe çështja e perëndimizimit), shkruarja e së cilës m'i mori pesë vite. Librit në fjalë nuk arrija dot t'i jap përfundim. Ndodhte kështu për arsye se në konceptin e Turhanit rreth kulturës dhe qytetërimit ekzistonte një pikë që mua nuk më kënaqte, e të cilën unë nuk arrija ta identifikoja se ç'është. Turhani kishte plot të drejtë në insistimin se është më se i nevojshëm përfitimi ose pajisja me mentalitetin shkencor dhe se hulumtimet shkencore duke u institucionalizuar duhet që t'i japin dinamizëm shoqërisë, por më dukej se në çështjen e “perëndimizimit” (ang. westernization-A.P.) dhe “hyrjes ose inkuadrimit në qytetërimin perëndimor” kishte një pikë gabimi. Kjo pikë kishte të bëjë me konceptin e tij mbi kulturën dhe qytetërimin, të cilin nuk e konsideroja satisfaksionues, por

ç'e do që nuk mundja ta përcaktoj se ç'ishte ai në fakt. Por, kur e projektova teorinë e qytetërimit, temë kjo e ligjëratës sime, besova se isha në gjendje që drejt t'i interpretoja idetë e Turhanit. Tani veç më mund të jepja gjykime rreth tyre. Kur e ndjeva këtë, me shpejtësi e mbarova librin, i cili u botua në nëntor të vitit 1995. Në fund të po atij viti më erdhi kërkesa për një artikull që do të botohej në numrin e marsit të revistës *Türk Yurdu*, numër ky që i kushtohej Zija Gokalpit. Në artikullin me titull "Ziya Gökalp'ta Kültür ve Medeniyet Kavramı" (Konceptet kultura dhe qytetërimi te Zija Gokalpi) në trajtë një çik më detajozë e sqarova projeksionin tim mbi kulturën dhe qytetërimin që e kisha elaboruar në kapitullin e fundit të veprës sime *Mümtaz Turhan ve Batılulaşma Meselesi* – "Mümtaz Turhan'da Kültür ve Medeniyet Kavramı" (Konceptet kultura dhe qytetërimi te Mumtaz Turhani). Çështjen e qytetërimit e preka edhe në artikullin tim me titull "İnsanlığın Bugünkü Meseleleri ve İnsan Zihninin Niteliği" (Çështjet aktuale të njerëzimit dhe cilësia e mendjes së njeriut) që u botua në numrin e prillit të revistës *Türk Yurdu* me rastin e përvjetorit të vdekjes së rahmetli mikut tim, mendimtarit të madh Erol Gyngor. Në artikullin me titull "Hakikat ve Hoşgörü" (E vërteta dhe toleranca) që e prezantova në simpoziumin "Kur'an Işığında Barış ve Kardeşlik" (Paqja dhe vëllazëria nën dritën e Kur'anit) të mbajtur në Ankara në shtator të vitit 1996 nën patronazhin e İstanbul İlim ve Kültür Vakfı-t (Fondacioni i Stambollit për shkencë dhe kulturë) natyrës së çështjes së qytetërimit i jam qasur nga një perspektivë tjetër.

Në fazën kur po mendoja se projeksioni im mbi qytetërimin ka ardhur në një pozitë të shfaqjes si një teori dhe titull libri, vëllai i ndershëm, profesori i letërsisë bashkëkohore turke Kazem Jetish (Kazım Yetiş), i cili me

sinqeritetin dhe interesin emocionues ndaj temës së zënë ngoje, kërkoi nga unë që në kuadër të “*Kubbealti Akademik Toplantıları*” (Konferencave akademike Kubealltë) të mbaj një seminar lidhur me kulturën dhe qytetërimin që do të vazhdojë në formë seriale gjatë pesë mbrëmjeve të së premtëve të muajit nëntor. Pjesën e tretë, d.m.th. atë të kësaj mbrëmjeje, ia kam ndarë teorisë sime të qytetërimit, për aventurën e zhvillimit të së cilës fola deri tani.

Në hyrje, në mes tjerash, i shpreha edhe këto fjalë: "Si kultura ashtu edhe qytetërimi, nuk janë fenomene që ekzistojnë në natyrë para veprave të njeriut. Lindja dhe formimi i tyre nuk mund të trajtohen si rezultat i kapaciteteve të lindura të njeriut, si rezultat automatik i fantazisë gjenetike të tij. Pra, kultura dhe qytetërimi nuk janë fenomene që njeriu i gjen të gatshme në natyrë ose në strukturën e vet biologjike. Njeriu, kulturën dhe qytetërimin, i formon në një fushë të mundësive në saje të preferimeve të veta". Kjo është pika kyç e teorisë. Duke u nisur nga kjo pikë, teoria në fjalë çdo vepër të njeriut dhe çdo gjë që e krijon ai jashtë sjelljeve të tij refleksive dhe instiktive e sheh brenda konceptit *kulturë*. Sepse, veprat dhe objektet janë fryte të cilat njeriu i formon me dëshirën ose zgjedhjen e vet dhe të cilat ai ia shton natyrës. Në këtë aspekt, të gjitha shoqëritë njerëzore si ato "të civilizuarat" ashtu edhe ato "primitive" kanë kulturën e vet dhe nuk ekziston bashkësi njerëzore pa kulturë. Në këtë pikë, qëndrimi i antropologëve të kulturës është me vend dhe i drejtë. Sepse njeriu, në çdo vend dhe në çfarëdo kushtesh, bile edhe në nivel të plotësisimit të nevojave të veta biologjike, në kuptimin që më parë u theksua si pikë kyç e teorisë, krijon kulturë. Ai zgjedh dhe e zhvillon formën e gjuajtjes. Me këtë qëllim e zhvillon një vegël e cila kërkon një projekt të thjeshtë. Nga lëndët ushqyese të cilat i kultivon e zhvillon metodën e përgatitjes



së gjellës, e zhvillon formën e kujdesit dhe edukimit të fëmijës. Këto vepra paraqesin trajta të sjelljes që kanë alternativë dhe që nuk gjenden në strukturën biologjike në formë të kallëpeve (matricave) instiktive. Si vetë format e sjelljes që janë zgjedhur dhe zhvilluar, ashtu edhe trupat, veglat dhe gjërat konkrete që janë zhvilluar në saje të atyre sjelljeve, paraqesin elemente të kulturës. Një trup për të qenë pjesë e kulturës nuk duhet që me çdo kusht të jetë *i prodhuar* nga njeriu. Edhe gjetja e funksionit dhe trajtës së përdorimit (në mendjen e njeriut me anë forcës imagjinative dhe projeksionuese) të një trupi që vetvetiu ekziston në natyrë, bën pjesë në kulturë.

Elementet e kulturës, në esencë, nuk janë vetë trupat. Kultura ka të bëjë me trajtën e pikëpamjes, projeksionit, imagjinatës, emocionimit, konceptimit dhe vlerësimit që e bën mendja e njeriut. Mendja e njeriut është ajo që produkteve që dalin si trupa të cilët në mënyrë manifeste mund të perceptohen u jep formë dhe funksion. Ndarja e kulturës në atë materiale dhe shpirtërore është e pavend, sepse esenca e kulturës në tërësi është shpirtërore, apo kognitive. Vepra letrare, përralla, epepeja, teoria shkencore, doket dhe traditat, çdo metodë teknike, qëndrimet psikologjike dhe sociale, muzika, arkitektura, veprat artistike si piktura, kaligrafia etj., të gjitha paraqesin elemente të kulturës. Pas të gjithave këtyre "fshehet" një qëndrim, një trajtë perceptimi dhe mendimi. Thelbin shpirtëror të këtyre elementeve të kulturës e vërejmë shumë lehtë. Por, edhe formësimi i veglave dhe gjërave konkrete dhe praktike edhe dhënia funksion atyre, sikurse edhe elementet e kulturës që i numëruam më parë, në thelb paraqesin vepra shpirtërore. Niveli i cilësisë psikologjike që është shkak i formimit të tyre paraqet nivel kognitiv-intelektual. Në këtë kontekst mund të themi se: Elementet e kulturës (e cila deri më tash

është ndarë në atë lëndore dhe shpirtërore) ndërmjet vete nuk i ndan lëndshmëria ose shpirtshmëria por konkretësia dhe abstraktësia në aparencën e tyre, dallimi në sferën e të qenët praktike ose larg nevojave praktike.

Bile edhe në nivel të plotësimit të nevojave biologjike, nëse kultura lind si një domosdoshmëri e strukturës intelektuale njerëzore, si një gjë e patjetërsueshme, respektivisht nëse në kuptimin antropologjik nuk mund të ekzistojë një bashkësi njerëzore e pakulturë, atëherë ç'është burimi i ndarjes (ndarje kjo që është bërë traditë e gjuhës) së shoqërive njerëzore (në trajtë që shpreh gjykim vlerësimi) me kualifikimet *primitiv/e* dhe *i/e qytetëruar*? Kjo ndarje vallë ka një mbështetje objektive përtej të qenët paragjykim? Kualifikimet "primitiv/e" dhe "i/e qytetëruar" mund të përdoren në një trajtë përçmuese dhe me një sjellje të shikimit të vetvetes si superior ndaj tjetrit. Por, një ndarje e këtillë mund të lind edhe nga përpjekja e shkencës për determinimin objektiv të dukurive me të gjitha specifikat e veta. Qytetërimet e mëdha të së kaluarës, të cilat i përshkruajnë historianët, me çfarë konceptualizimi e kanë marrë emrin "qytetërim/e"? Social-antropologët dhe sociologët e kohës aktuale bëjnë dallim midis shoqërive që cilësohen si "primitive" dhe atyre që cilësohen si përfaqësuese të një "qytetërimi" të caktuar. Vallë konceptualizimi i historianëve rreth qytetërimeve të vjetra i ka bazat e njëjta me konceptin e qytetërimit të sociologëve dhe antropologëve, të shprehur në ndarjen ose tipologjinë e lartpërmendur? Kur hulumtohet materiali i historianëve, antropologëve dhe sociologëve lidhur me qytetërimin vërehen disa pika të përbashkëta:

1. Shteti i organizuar me kufij të caktuar,
2. Lindja e klasave shoqërore dhe e punëtorëve në sfera të ndryshme si bujqësia, tregtia, zejtaria dhe prodhimtaria industriale.

3. Përdorimi i shkrimit, lindja e arteve të bukura dhe veprave ideore.

Por, radhitja e njëpasnjëshme e këtyre pikave, që në shkallë të ndryshme i hasim në çdo qytetërim, nuk e ndriçon çështjen e lindjes së qytetërimit. Nëse këto pika në shkallë të ndryshme ekzistojnë në çdo qytetërim, atëherë parashtrohet pyetja kush ua jep po atyre qytetërimeve identitetet e ndryshme? Kjo na tregon se vetëm me radhitjen e pikave të përbashkëta të qytetërimeve nuk do të mund të arrijmë në thelbin e konceptit qytetërim. Atëherë pra, del në shesh fakti se duhet të bëhet një konceptualizim i cili do ta shpjegojë fenomenin e formimit të identiteteve të ndryshme të qytetërimeve. Cili është burimi i këtyre pikave të përbashkëta?

Kjo është çështje e projeksionimit të filleve të procesit të lindjes së çdo qytetërimi me identitetin e vet specifik. Çdo shoqëri e ka kulturën e vet. *Por ajo që qytetërimit i jep jetë është të hetuarit e njeriut se vetë mendja e tij është një burim i mundësive.* Qytetërimi lind në bashkësitë njerëzore që pothuajse duke dalë jashtë mendjes, njohjes së vet, e projeksionojnë ekzistencën dhe mentalitetin e vet, që mundohen t'i japin kuptim jetës së vet, që duke dhënë koment në rrafshin racional lidhur me ekzistencën dhe jetën e determinojnë synimin e jetës së vet. Pra "qytetërimi", do të thotë "prodhim" i veprave të paracaktuara në mendjen e njeriut (nga vetë njeriu) në një drejtim shpirtëror të vetëdijshëm, duke u ngritur mbi veprat e kryera në këtë ose në atë mënyrë si pasojë e domosdoshmërisë biologjike. *Qytetërimi nuk e nënkupton vetëm reaksionin ndaj natyrës, por edhe atë që njeriu duke arritur në vetëdijen e realitetit të vet mendor ta determinojë ekzistencën, mendjen e vet, natyrën, relacionin me natyrën dhe qëllimin e jetës dhe veprat e tij t'i sjellë në pozitë të "prodhimit" të tyre me plot vetëdije.* Sipas kësaj, qytetërimi paraqet vetëdije të ngritjes shpirtërore, apo besimin

që e përmban ajo ngritje. Ky besim nga aspekti i "prodhimit" të veprave në një drejtim të caktuar paraqet sistem moral. Përderisa reaksioni i drejtpërsëdrejtë ndaj natyrës mbetet në nivel të nevojave biologjike dhe është i mbushur me emocione, "prodhimi" i veprave duke arritur në vetëdijen e realitetit të vet mendor zhvillohet në një shkallë racionale pa qenë i varur nga nevojat biologjike. *Trajtimi i problemeve në planin racional duke mos qëndruar në varësi të drejtpërdrejtë nga nevojat biologjike dhe duke e tejkaluar nivelin e reagimit të drejtpërdrejtë ndaj natyrës, zhvillimi i projeksioneve me plot vetëdije, vendosja për veprat në përputhshmëri me ato projeksione dhe duke zhvilluar fusha veprimi të reja jashtë nevojave biologjike, paraqet burimin psikologjik të qytetërimit.* Ky burim është ai i cili i ka lindur veprat e mëdha kulturore. Te të gjitha qytetërimet ekziston një besim, llogaria e të cilit bëhet në nivelin e vetëdijes dhe arsyes. Sistemi moral i lidhur me një besim të cilësisë së këtillë bën ndërtimin e shoqërisë. Bashkësia njerëzore që në nivel të vetëdijes dhe racios bën llogarinë ose peshimin e besimit dhe sistemit moral ndaj të cilit është lidhur, ndjen sigurinë e të qenët e pajisur me atë besim ose sistem të moralit. *Themeli shpirtëror i qytetërimit është besimi, kurse themeli shoqëror, sistemi moral i lidhur me atë besim. Ata njerëz që e ndiejnë vetëdijen dhe sigurinë e të qenët të bashkuar mbi këtë themel, duke e krijuar organizimin shtetëror dhe strukturën ekonomike që do ta jetësojë atë besim dhe sistem të moralit, krijojnë vepra të mëdha kulturore.*

Besimi i formuar në një rrafsh të vetëdijes dhe arsyes, në të gjitha qytetërimet thellë ndikon mbi shpirtrat. Besimi, në të njëjtën kohë është burimi i energjisë shpirtërore të pjesëtarëve të shoqërisë dhe determinues i drejtimit dhe cilësisë së sjelljeve të tyre. Veprimtaritë në shoqëri kryhen konform vlerave të mbjellura nga besimi.

Njerëzit ngurrojnë nga të kryerit e veprave që bien ndesh me besimin. Besimet ua tregojnë synimet veprave dhe i formësojnë ato në drejtim të vendmbërritjes. Besimet i determinojnë veprat që duhet kryer, që mund të kryhen dhe që nuk duhet të kryhen. Jeta duket komplekse dhe e paparashikueshme; natyra është e pakuptueshme, ndërsa pasvdekja është e panjohur. Njeriu është i detyruar ta vazhdojë rrugën e vet në mesin e këtyre paqartësive (ambiguiteteve). Zgjedhja dhe gjykimi rreth veprave të veta njeriut ia dhuron ndjenjën e përgjegjësisë. Njeriu, për ta vazhduar jetën e vet në mes të paqartësive dhe brenda ndjenjës së përgjegjësisë, është i detyruar që t'i zgjedhë veprat e veta. Por, si domosdoshmëri e strukturës së vet shpirtërore, njeriu nuk mund ta durojë gjatë paqartësinë ose papërkufizueshmërinë. Në kuadër të paqartësisë, veprat janë të dyshimta. Kjo bëhet shkak i paqëndrueshmërive dhe humbjes së kohës. Si përfundim i kësaj nëse vazhdohet papërkufizueshmëria, lind mosrehatia shpirtërore. Me vepra inkonsistente nuk mund të vazhdohen marrëdhëniet shoqërore. Jeta shoqërore bazohet në norma të mira ose të këqija, por të cilat e sigurojnë rendin dhe stabilitetin.

*Në çdo shoqëri, burimi i normave është besimi i cili i eviton paqartësitë. Ja pra, themeli i fenomenit të të qenët e kulturës një tërësi harmonike dhe kuptimplote që përbëhet nga elemente që përputhen dhe e plotësojnë njëri-tjetrin është besimi. Besimi, sipas vlerave që i përmban, i kabëzon, i zgjedh dhe i formëson të gjitha veprimtaritë, dhe aktivitetet. Ky fenomen ekziston edhe në kulturën e shoqërive të quajtura "primitive" edhe në atë të të quajturave "të civilizuarra". "Qytetërimi", me një besim që mendja e njeriut e ka zhvilluar në një pozitë të vetëdijes dhe arsyes, paraqet ngritje mbi nivelin e plotësimit të nevojave biologjike dhe reagimit ndaj natyrës. Nga aspekti i intelektit, niveli i plotësimit të nevojave biologjike*

me anë të frikës, dëshirës dhe shpresës ndaj natyrës paraqet nivel primitiv të kulturës. Madje, edhe nëse intelekti nisët nga plotësimi i nevojave biologjike, orvatja për kuptimin e vetëdijshëm dhe racional të natyrës, duke e tejkaluar nivelin e reagimit emocional ndaj saj, do të thotë se është arritur niveli i qytetërimit. Dallimi ndërmjet kulturës së një fisi primitiv dhe kulturave në kuadër të qytetërimeve të vjetra me mileniume si ai i Mesopotamisë, i Egjiptit, Indisë dhe Greqisë Antike është dallim mendor - intelektual. Dallimi në nivelin mendor - intelektual ndërmjet kulturave primitive dhe kulturave që burojnë nga një qytetërim, shprehet në atë se në kulturat primitive ekziston besimi i cili shkakton *reagim përplot ndjenja dhe emocione*, kurse në kulturat civilizuese hasim besimin që ka arritur në *projeksionin abstrakt dhe racional*.

Teoria që e ofrojmë ne, parasheh që besimi, nga aspekti i të qenët burim i qytetërimit, të jetë në nivel intelektual të së vetëdijshmes, abstraktes dhe racionales, që njeriut t'i mundësojë t'i ndriçojë marrëdhëniet me natyrën, jetën dhe përtejjetësoren dhe t'i ofrojë atij një sistem moralo-etik. **Teoria në fjalë, e cila nga aspekti i të qenët të besimit burim qytetërimi, nuk ndalet mbi përmbajtjen e tij, d.m.th. mbi atë se ç'thotë në fakt ai (besimi), madje nuk ndalet edhe mbi atë se ç'përmbajtje ka sistemi moralo-etik të cilin e lind besimi.** Nga prizmi i teorisë, sistemi moralo-etik mjafton të përmbajë norma dhe rregulla të cilat i pëlqen dhe u përmbahet shoqëria. Njeriu, duke e marrë për epiqendër besimin e vet mund që një besim tjetër ta konsiderojë nonsens. Duke e marrë për kriter sistemin moralo-etik të shoqërisë së vet, mund që disa norma nga një sistem moralo-etik i huaj t'i shpallë të papëlqyeshme ose diametrale me "moralin dhe etikën". Por, ne synojmë që teoria jonë të jetë abstrakte dhe e përgjithshme, t'i përfshijë të

gjitha qytetërimet dhe përskej të gjitha dallimeve, ta konceptualizojë themelin e përbashkët dhe të domosdoshëm mbi të cilin mbështeten të gjithë ato. Më parë u tha se besimi duhet të përmbajë një nivel kognitiv të vetëdijshëm, abstrakt dhe racional. Tash, sistemi moralo-etik që lind nga një besim me cilësi të atillë nuk konceptohet nga pikëpamja e përmbajtjes por nga pikëpamja e funksionit që e kryen. Koncepti "moral", të cilin duam ta përdorim si vegël mendimi në sferën e studimit të qytetërimeve, është i abstrahuar nga përmbajtja e sistemeve të ndryshme të moralit dhe është në pozitë logjike kur nuk bën ndarje nga ndryshueshmëria e përmbajtjeve të tyre, por unifikon në mënyrë konceptuale për nga aspekti i ngjashmërisë së funksionit që e kryejnë ata.

Funksioni i përbashkët dhe i domosdoshëm që i bashkon sistemet e moralit nga kjo pikëpamje konceptuale, është fakti se të gjitha sjellin rregulla dhe norma jetësore. *Normat që ndikimin e marrin nga besimi dhe i japin jetës një sistem, e formojnë moralin.* Fuqia e padukshme e cila e nxit njeriun që në lidhje me marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe veprat e tij të japë vlerësime si *e mirë - e keqe, e bukur - e shëmtuar, e kuptimtë - e pakuptimtë, e vlefshme - e pavlefshme,* që vë ose tregon synime në sferën e aktiviteteve shoqërore, e cila në këtë mënyrë u prin dhe i kahëzon sjelljet njerëzore është sistemi i besimit dhe moralit, i cili qëndron në themelin e strukturës shpirtërore dhe shoqërore të njeriut. Sistemi i besimit dhe i moralit, pasi që thellë ndikojnë në shpirtëra dhe parapëlqehen nga brendësia, paraqesin burimin e elanit dhe vullnetit të veprave individuale dhe shoqërore. Energjinë e atyre veprave dhe aktiviteteve të njeriut e jep sistemi i besimit dhe moralit.

Njeriu, i cili e zotëron aftësinë e të menduarit simbolik, projektton vepra që nuk janë në natyrë dhe që nuk janë të gatshme në programin gjenetik. Projektet e veta,

ai i shndërron në planin e veprave konkrete. Më pastaj, këtë plan të ekzekutimit e nxjerr jashtë në trajtë të veprave të vrojtueshme dhe frytdhënëse. Pra, *çdo gjë të cilën njeriu ia shton natyrës në formë të veprave dhe gjurmëve quhet kulturore*. Elementet e kulturës nuk lindin rastësisht. Sistemi i besimit dhe moralit, që qëndron në themelin e strukturës shoqërore, *i cili e çon njeriun t'i zgjedhë elementet kulturore, t'u japë formë dhe t'i kabëzojë, i kufizon ato dhe e jep inspirimin e elementeve*. Thënë shkurt, *sistemi i besimit dhe moralit i cili në kuadër të një kornize shpirtërore i gjeneron elementet kulturore quhet qytetërim*. Pjesëtarët e shoqërisë e parapëlqejnë shpirtin e qytetërimit, ngase me anë të vetëdijes, elanit dhe ndjenjës që e jep ai shpirt, e marrin edhe vendin në strukturën shpirtërore dhe kontribuojnë në lindjen e elementeve kulturore të vrojtueshme.

Sistemi i besimit dhe moralit që e konceptualizuar me shprehjen "qytetërim", duke i kufizuar tendencat instiktive dhe pasionet egoiste të pjesëtarëve të shoqërisë, u mundëson atyre (pjesëtarëve të shoqërisë) ta formojnë strukturën shoqërore nën siguri dhe stabilitet. Individët tendencat instiktive dhe pasionet egoiste i kontrollojnë konform sistemit të besimit dhe moralit që e kanë parapëlqyer. Asnjë bashkësi e cila nuk tregon sukses në sferën e kontrollimit të tyre nuk mund të krijojë qytetërim. Në një rafsh shpirtëror të vetëdijshëm dhe racional i cili e tejkalon satisfaksionimin e nevojave biologjike, me krijimin e një strukture shoqërore stabile dhe të sigurtë, qytetërimi fiton një realitet shoqëror. Në një situatë të rrëmujës së instikteve dhe përplasjes reciproke midis pasioneve egoiste është e pamundur të krijohet struktura shoqërore. Në rrethet ku nuk është formuar struktura shoqërore stabile që jep ndenjë të sigurisë dhe ku nuk është arritur një vetëdije e ngritjes shpirtërore mbi nevojat biologjike, nuk mund të krijohen as vepra të mëdha kulturore.



Bashkësitë njerëzore të cilat mbeten në rrafshin e nevojave biologjike dhe të cilat si pasojë e mosracionalizimit të besimit të vet, atë (besimin) nuk mund ta sjellin në pozitë të burimit koshient të kulturës, nuk mund që të zhvillojnë aktivitete në fushat intelektuale, të cilat janë të pavarura nga nevojat biologjike. Të këtilla janë shoqëritë e quajtura primitive. Në ato shoqëri veprimtaritë si muzika, vallja, piktura ose vizatimi dhe dekorimi janë shumë larg racionalitetit. Sikur që magjia bëhet me një orientim shpirtëror larg racionalitetit, edhe veprimtaritë me një orientim po të atillë si shumimi i kafshëve të gjuetisë, prishja e sihrit (magjisë) së armikut dhe qetësimi i shpirtërave ose fuqive natyrore janë të të njëjtit karakter. Në fakt, veprimtaritë që antropologët i quajnë rituale, nuk janë kërkesë e tërësisë së adhurimeve (*ibadat*) të një besimi fetar të projektuar në një formë racionale, por reaksione direkte kundrejt natyrës, fuqive të padukshme (misterioze) dhe zotave, me qëllim të rezultateve praktike si furnizimi me ushqim, siguria, pengimi i të këqijave e kështu me radhë. Besimi i shoqërisë primitive nuk është një projektion racional por një reaksion. Mu për këtë arsye besimi dhe veprat e mbërthyer midis vete, paraqesin një strukturë iracional në rrafshin e reaksionit. Bashkësitë njerëzore që mbesin në nivel të nevojave biologjike, krijojnë vepra të kufizuara dhe të thjeshta të po atij niveli. Sepse, besimet e tyre duke mos qenë të pavarura nga niveli biologjik, nuk kanë arritur në pozitë të një burimi të posaçëm kulturë lindës në nivelin racional.

Kurse, qytetërimin që jemi duke e konceptualizuar ne, si një sistem racional të besimit dhe moralit që e kanë pëlqyer individët, shkakton lindjen e fryteve kulturore sipas kërkesave të veta. Në themelin e qytetërimeve qëndron besimi abstrakt dhe racional, i cili *në vetvete është një projektion kognitiv-intelektual*. Veprat nuk kryhen në formë të reaksionit, por sipas logjikës racionale të besimit.

Sistemi i besimit dhe moralit i këtij niveli, nga njëra anë duke e zhvilluar kapacitetin e të menduarit simbolik të njeriut përgatit rrethana të volitshme për lindjen e fryteve kulturore, kurse nga ana tjetër fryteve të kulturës që do të lindin ua tregon qëllimin dhe drejtimin. Qytetërimi, në saje të vetëdijes dhe vlerave që i mbjell në nivelin racional dhuron edhe elan dhe dëshirë për përkushtim ndaj vetvetes, komponentë këta që janë kusht për krijimin e veprave të mëdha kulturore. Çdo qytetërim, sipas parimit që i jep sistem jetës dhe që e rrethon atë, me përpikëri e ruan kufirin midis elementeve kulturore që përputhen dhe që nuk përputhen me të.

Pas një konceptualizimi të këtillë të kulturës dhe të qytetërimit, teoria shkurt, qartë dhe në mënyrë formale mund të shprehet kështu: Ngritja shpirtërore e njerëzve që e kanë pëlqyer një besim të racionalizuar dhe një sistem moral të derivuar nga ai besim, e shkakton organizimin e vetëdijshëm të tyre që do të mundësojë të jetuarit në përputhshmëri me atë sistem të besimit dhe moralit. Një sistem i besimit dhe moralit që ushtron influencë të këtillë mbi njerëzit paraqet "qytetërim". *Qytetërimi siguron energji të shpirtit në përmasa shoqërore dhe nxit në drejtim të krijimit të veprave që e shprehin atë, që përputhen me të dhe që inspironin e marrin nga ai. Çdo gjë që krijohet në kuadër të natyrës dhe jetës shoqërore është "kulturë". Veprat e kulturës, nga njëra anë i plotësojnë nevojat jetësore, kurse nga ana tjetër e reflektojnë sistemin e besimit dhe moralit të qytetërimit ku kanë lindur.*

Siç shihet qartë në këtë teori, qytetërimi është një sistem besimi dhe morali zgjedhës, kufizues, vlerësues dhe përfshirës që shkakton lindjen e veprave të kulturës, që ua cakton atyre qëllimin, drejtimin dhe karakteristikat. Teoria e prezantuar e fshin çështjen e pazgjidhshme, e cila shkakton lloj-lloj konfuzititesh, mbi atë se cilat dukuri dhe vepra të vëzhguara në shoqëri i takojnë kulturës e cilat qytetërimit. Sepse, sipas konceptualizimit të kësaj

teorie kultura dhe qytetërimi nuk janë fenomene të statusit të njëjtë logjik. *Kulturën e përfaqësojnë veprat dhe produktet, kurse qytetërimin sistemi i besimit dhe moralit që qëndron pas tyre.* Sipas teorisë në fjalë, si në trajtë të operacioneve mbi natyrën, ashtu edhe në trajtë të marrëdhënieve shoqërore, qoftë si refleksion i shpirtit të njeriut në veprat individuale të tij, çdo gjë që është produkt i njeriut është kulturë. Në kulturë sikur që bëjnë pjesë gjërat që mund të perceptohen konkretisht dhe me strukturë materiale duke filluar nga vegla më e thjeshtë deri te makina më e komplikuar, nga pusi e deri te kanalet e ujitjes, nga një pjatë e thjeshtë deri te qilimi fascinant, nga kasollja deri te pallatet, elemente këto që njeriu i ka projektuar dhe realizuar jashtë vetvetes, po ashtu bëjnë pjesë edhe formacione relativisht abstrakte si zakonet e mira (urf) dhe traditat, shprehjet, bindjet, idetë dhe qëndrimet, ideologjitë, reçetat e gjellëve, teoritë shkencore, poezitë dhe epopetë etj.

Jashtë kulturës nuk është asnjë kreacion njerëzor me përbërje materiale dhe mendërisht i konceptueshëm. Në esencë, tipologjia material/e-shpirtëror/e bile edhe nëse ka një kuptim nga aspekti i konkretësisë dhe abstraktësisë, mbi të cilin mbështetet grupëzimi i cekur pak më parë, kur kemi parasysh se veprat kulturore lindin nga mendja e njeriut dhe se në mendjen e tij nxitin një ndjenjë dhe kuptim, mund të themi se është e pabazë. Sepse, xhamia Sulejmanije, *si një vepër kulturore* sado që e ka strukturën e vet materiale, prapëseprapë para se të shndërrohet në një strukturë materiale është një projeksion i mendjes së njeriut. Sulejmanija, si një projeksion mendor, është një mendim abstrakt dhe imagjinacion. Ajo paraqet realizimin material të një projeksioni mendor jashtë mendjes, në planin e përkapur. Lidhja e xhamisë Sulejmanije me projektin në mendjen e Mimar (Arkitekt) Sinanit, e nxjerr atë nga të qenët e pavarur nga spiritualiteti ose të qenët vetëm materie. Në këtë kontekst

parashtrahet pyetja: Sa është në rregull të thuhet se kjo xhami është vepër kulturore-materiale? Arsyeja e mos-saktësisë së një pohimi të këtillë qëndron në faktin se ajo është vepër religjioze. Të qenët e Sulejmanijas një vepër arkitektonike religjioze (sakrale), nga një pikëpamje tjetër e forcon faktin se ajo në esencë ka karakter shpirtëror-metafizik. Projektin e saj si një vepër arkitektonike e ka inspiruar ndjenja e madhështisë së besimit. Në ndërtimin e saj ka hyrë kriteri dhe metoda që tek ata që e perceptojnë, e këndell këtë ndjenjë të madhështisë. Por, ndaras nga natyra e saj religjioze, mund të thuhet se, pasi që ka lindur nga projeksioni i mendjes së njeriut, ajo *në esencë e ngërthen karakterin shpirtëror*. Në drejtim të kristalizimit të kësaj pike, kur kemi parasysh se edhe produktet teknologjike lindin nga projeksionet e mendjes njerëzore, vijmë në përfundim se edhe ato kanë një dimension shpirtëror. Mendja duke e projektuar një produkt teknologjik, shfrytëzohet nga njohuria abstrakte e cila është rezultat i përpjekjeve mendore dhe hulumtuese të njeriut. Ajo mendon dhe iluzionon sipas kriterëve të rentabilitetit, ndikueshmërisë dhe të të qenët ekonomik. D.m.th. produkti teknologjik, para se të shndërrohet në strukturë materiale, është veprimtari e mendjes së njeriut. Për këtë arsye teoria e ekspozuar, ndarjen formaliste të veprave kulturore në materiale dhe shpirtërore e sheh si një ndarje që shkakton paqëndrueshmëri dhe paqartësi dhe si ndarje të panevojshme që nuk e reflekton esencën e kulturës. Të gjitha veprat kulturore në bazë janë shpirtërore, por në aspektin teorik një tipologji ose ndarje e drejtë mund të bëhet nëse thuhet se disa prej tyre janë konkrete e disa abstrakte.

Teoria, pasi që realitetin psikologjik e ka konceptuar më mirë se qëndrimet që bien në ndarje të këtilla të panevojshme, është më konsistente në sqarimin e fenomenit të quajtur *ndryshim kulturor*. Në qëndrimet tjera, dukuria kur një shoqëri teknologjinë e cila trajtohet si kulturë

materiale e merr nga një kulturë tjetër, tregohet si ndryshim teknologjik. Më pastaj pohohet se mentalitetet, qëndrimet dhe sjelljet, zakonet e mira dhe adetet si dhe vlerat, për të cilat thuhet se bëjnë pjesë në kulturën shpirtërore, ndryshohen më ngadalë dhe se kanë mbetur pas ndryshimit teknologjik. Në këto raste teknologjia kuptohet si produkt teknologjik në gjendje të materies së përpunuar. Kurse, kultura shpirtërore i përfshin cilësitë në lidhje me stilin jetësor. Shoqëria e cila produktin teknologjik e merr të gatshëm nga një vend tjetër, të njëjtin (produktin teknologjik) si një mjet (vegël të përdorimit) e fut në indin e stilit të vet jetësor. Në këtë aspekt, ndryshimet që i shkakton ai produkt, nëse nuk përzihen faktorë të tjerë që shkaktojnë ndryshime me përmasa më të mëdha, normale është që të mbeten të kufizuara me shprehitë që kanë të bëjnë me përdorimin e atij produkti.

Ndryshimit teknologjik le t'i qasemi edhe nga ky këndvështrim: Pas produktit teknologjik të huazuar nga një vend dhe të vënë në përdorim në një vend tjetër qëndron një kapacitet i padukshëm. Kapaciteti teknologjik është një tipar mendor ose shpirtëror. Pika mbi të cilën duhet të ndalen ata që bëjnë dallim ndërmjet kulturës materiale dhe asaj shpirtërore është fakti se kapaciteti teknologjik nuk mund të merret/huazohet si produkt teknologjik. Hulumtuesit, në vend që ta potencojnë këtë pikë, pohojnë se zakonet e mira dhe adetet, si dhe besytënitë dhe vlerat (të cilat përmenden si kulturë shpirtërore) janë të pandryshueshme, ose se ndryshimet në ato sfera kanë mbetur pas "ndryshimit teknologjik". Kurse e vërteta është se duhet ndalur mbi dy pika me rëndësi.

**1.** Produkti teknologjik si një vepër kulturore, nga aspekti i mundësisë së lindjes, buron nga një kapacitet mendor, i cili sipas kësaj bart një kualitet shpirtëror.

**2.** Produkti teknologjik, me një kundërvlerë, shumë lehtë mund të përvetësohet, por kapaciteti teknologjik

që e ka lindur atë nuk mund të përvetësohet. Kapaciteti teknologjik është një kualitet mendor ose kognitiv në rrafshin abstrakt që lind në fund të një procesi të gjatë dhe kompleks të zhvillimit. Kur të cekën këto dy pika, del në shesh se ndarja kulturë materiale-kulturë shpirtërore, është një ndarje e panevojshme dhe e pakuptimtë që shkakton vetëm çështje të pazgjidhshme.

Një fenomen me rëndësi në çështjen e ndryshimit kulturor është shkrirja ose zbehja e kulturave primitive që vijnë në kontakt me qytetërimin evropian dhe tronditja e disa qytetërimeve. Nga pikëpamja e teorisë, shkrirja e kulturave primitive ka të bëjë me mosekzistimin e një kornize të vetëdijshe dhe racionale e cila do të siguronte rezistencën e tyre. Tronditja e qytetërimeve ka të bëjë me shoqërinë e cila bëhet skeptike lidhur me vlerën e qytetërimit të vet, dhe e cila e ka humbur potencialin zgjedhës dhe refuzues ndaj elementeve të kulturës së huaj.

Teoria në fjalë, kualifikimet në tipologjinë e Zija Gokalpit mbi kulturën dhe qytetërimin ose i nxjerr si jo të qëlluara ose i kushtëzon.

**a.** Pikësëpari, nga pikëpamja e teorisë, pretendimi se kultura është kombëtare, kurse qytetërimi ndërkombëtar, është një çështje që kërkon kushtëzim. Qytetërimi është i përbashkët të kombet që e ndajnë sistemin e besimit dhe moralit që e përfaqëson ai (qytetërimi). Nuk dua që gjerë e gjatë ta kritikoj Gokalpin, i cili përdor shprehje që në mënyrë implicite flasin se qytetërimi perëndimor veç më është shkalla e fundit e të gjitha qytetërimeve, se është një qytetërim botëror i pakundërshtueshëm, sepse koncepti i qytetërimit mbi të cilin bazohet kjo ide është i gabuar. Nga prizmi i teorisë, baza e qytetërimit perëndimor nuk është shkenca dhe teknologjia, por sistemi i besimit dhe moralit, për të cilin do të flasim në ligjëratën e fundit.

**b.** Edhe pohimi se qytetërimi lind me metodë dhe vullnet individual, kurse kultura lind në një proces

shoqëror brenda shoqërisë por jashtë individëve, nuk është i drejtë dhe nuk ka mundësi të mbrohet. Gjatë shpjegimit të teorisë sonë në mes tjerash u cek se çdo produkt njerëzor që shfaqet brenda jetës shoqërore, qoftë i formuar me vullnetin personal ose me metodë, qoftë i lindur në mesin e popullit ose nga vetvetiu, është element i kulturës. Të gjitha këto elemente të kulturës lindin në korniza të qytetërimit të caktuar.

**c.** Pretendimi se kultura lind nga emocionet, kurse qytetërimi nga dituritë ose njohuritë, nga pikëpamja e teorisë sonë, është një rezultat i konceptualizimit të gabuar. Çdo formacion që është produkt njerëzor, qoftë me brendësi emocionale qoftë me brendësi diturore është kulturë. Qytetërimi është sistem i besimit dhe moralit që i lind ato. Kjo tipologji e Gokalpit, si pasojë e të qenët e bazuar në një konceptualizim të gabuar është artificiale dhe shkakton tollovi, paqartësi dhe mosmarrëveshje të pazgjidhshme.

**d.** Ndarja e katërt që e bën Zija Gokalpi është ajo se qytetërimi me anë të imitimit mund të kalojë prej një kombi në komb tjetër, kurse kultura e një kombi nuk mund të përvetësohet (me anë të imitimit) nga një komb tjetër. Kjo ndarje që e bën Gokalpi e shkakton konfuzionin më të madh. Sipas teorisë sonë, shkak i këtij konfuzioni prapë është koncepti i gabuar i tij mbi qytetërimin. Nga aspekti i teorisë që jemi duke e elaboruar, koncepti kulturë e ngërthen në vete edhe qytetërimin e Gokalpit. Të gjitha elementet, të cilat i sheh brenda kulturës dhe qytetërimit, duke mos bërë ndojnë dallim të tipit materiale-shpirtërore, dëshirë individuale-formësim shoqëror, bëjnë pjesë në kulturë. Teoria, me këtë konceptualizim, siç u cek edhe më parë, çështjes së ndryshimit kulturor i jep një ndriçim që eviton çdo mospërkufizim dhe konfuzion. Ndryshimi kulturor në çdo cikël të historisë ka qenë dukuria më natyrore dhe e domosdoshme e të gjitha

shoqërive. Shoqëritë me anë të tregtisë, udhëtimeve, okupimeve dhe luftërave, kontakteve politike, shpërnguljeve, marrëdhënieve në sferën e diturisë etj., ca herë bile edhe pa qenë të vetëdijshme, kanë përjetuar ndryshime në shumë elemente kulturore, kanë pëlqyer disa elemente kulturore të reja dhe i kanë braktisur disa të tjera.

Sipas teorisë sonë, një element kulturor nëse ka një aspekt që nuk bie ndesh me qytetërimin e shoqërisë marrëse (recipiente), pa kurrfarë problemi mund të merret (përvetësohet) nga një kulturë që i takon rrethit qytetërimor tjetër. Në këtë rast, kriter është që elementi kulturor që merret të jetë i dobishëm dhe t'i pëlqejë shoqërisë marrëse. Tërësia kulturore e një qytetërimi të vetëdijsëm dhe të sigurtë në vetvete, mund ta marrë dhe ta homogjenizojë çdo element kulturor për të cilin ka nevojë dhe e pëlqen, me kusht që i njëjti (element kulturor) të mos e kundërshtojë sistemin përkatës të besimit dhe moralit. *Kultura e cila është e vetëdijshme për qytetërimin që i takon dhe e cila tërësinë ia ka borxh sistemit të besimit dhe moralit që e ka lindur atë qytetërim, është kulturë zgjedhëse. Ajo refuzon çdo element kulturor që nuk përputhet me sistemin e vet të besimit dhe moralit. Harmoninë midis elementeve ekzistuese dhe atyre që rishtaz janë pranuar e siguron konform sistemit të vet të besimit dhe moralit. Nëse sistemi i besimit dhe moralit të qytetërimin me të cilin është e lidhur kultura marrëse është i tronditur, atëherë kultura e humb fuqinë e zgjedhjes dhe tërësinë e vet specifike. Elementet e pranuarra kuturu, gjenden në një bashkësi të pakuptimtë me elementet tjera. Në këtë rast lindin disharmoni, çalime dhe fërkime. Kështu humbin kriteret e caktimit se ç'është e saktë e ç'është e gabuar. Jeta shoqërore e humb harmoninë e cila individëve u jep satisfaksion shpirtëror. Përderisa vazhdon ky proces, përfundimi është shkatërrimi i qytetërimin. Rastet historike të ndryshimit të qytetërimin, nuk janë nga ngjarjet normale të*



jetës sikurse këmbimet kulturore. Ndryshimi i qytetërimit ose inkuadrimi në një qytetërim tjetër është një ngjarje e pazakonshme. Qytetërimi e ndryshon tërë jetën e shoqërisë që e pëlqen atë (qytetërim) dhe e riformëson kulturën e saj. Shoqëria riorganizohet sipas një sistemi të ri të besimit dhe moralit. Asnjë veprimtari shoqërorë nuk mund të mbetet jashtë fushës së influencës së qytetërimit të ri. Kështu sistemi jetik, marrëdhëniet shoqërore dhe veprimtaritë mendore riformësohen sipas një synimi të ri.

Teoria, edhe pse në një rrafsh konceptual bën ndarjen e kulturës dhe qytetërimit qartë dhe prerash, me një trajtë që nuk haset në qëndrimet tjera, prapëseprapë e nxjerr në pah lidhshmërinë ose relacionin midis tyre. Teoria, *duke treguar lidhjen strukturore midis tyre* (midis kulturës dhe qytetërimit) bën ndarjen e tyre në një rrafsh konceptual. Përderisa qëndrimet tjera ndalen në faktin se kultura dhe qytetërimi janë elemente të ndryshme të së njëjtit fenomen, teoria jonë, qytetërimin e sheh si burim dhe përcaktues të kulturës. Qytetërimi është një koncept i veçantë nga kultura. Përderisa qytetërimi paraqet një sistem besimi dhe morali që e kupton shpirtin e individëve si themel të strukturës shoqërore, kultura, në korniza të qytetërimit, paraqet çdo gjë që lind si produkt një-rëzor. Të gjitha gjurmët dhe veprat që nuk gjenden në natyrë vetvetiu e përfaqësojnë kulturën. *Teoria, qytetërimin, si një sistem besimi dhe morali, e sheh si përgatitës të rrethanave shoqërore për lindjen e veprave kulturore, si burim që e siguron energjinë shpirtërore të nevojshme për projektimin e atyre veprave dhe që e determinon kualitetin e tyre (veprave kulturore).*

Konceptualizimi i qytetërimit, si në teorinë tonë, e kthjelltëson deri në pikë të fundit faktin se kultura është një tërësi *sui generis*, pikë kjo mbi të cilën me të drjetë ndalen të gjithë sociologët dhe antropologët. Një pikë tjetër të cilën e theksojnë të gjithë hulumtuesit është ajo se të gjitha shoqëritë nga më e thjeshta deri te më e

komplikuara, bartin në vete një kulturë që paraqet tërësi specifike. Sipas teorisë që jemi duke e shpjeguar, edhe pse çdo kulturë ka një sistem të besimit dhe moralit që e siguron tërësinë e vet, të qenët e besimit në një rrafsh të vetëdijsëm, abstrakt dhe racional, kulturën në shumë aspekte e pavarëson nga nevojat biologjike dhe shkakton prodhimin e kulturës në mënyrë të vetëdijshme dhe në shumë fusha. *Besimi i cili krijon qytetërim, nuk është mjet i plotësimit të nevojave biologjike në mënyrë iracionale. Përkundrazi, besimi racional, si një vlerë më vete u jep frymëzim veprave kulturore.* Qytetërimi, me anë të organizimit të vetëdijsëm që e sjell dhe me anë të madhështisë së veprave kulturore të cilave ai u jep frymëzim në kuadër të strukturës shoqërore, i fiton argumentet e madhështisë së vet dhe e forcon identitetin e vet që dallon nga sistemet tjera të besimit dhe moralit. *Kurse, besimi i cili lind në formë të reaksionit emocional të drejtpërdrejtë ndaj natyrës në nivelin e nevojave biologjike, e modelon kulturën dhe shkakton përsëritjen e saj me formën e vet primitive ndër breza.* Besimi krijues i qytetërimit, i cili është i vetëdijsëm dhe racional, *përfaqësohet në mendje dhe rezultatet (përfundimet) e tij nxirren me anë të arsyetimit.* Në këtë mënyrë qytetërimi kulturën e nxit të përparojë. Besimi i cili tregon reaksion direkt ndaj natyrës në një rrafsh kognitiv emocional dhe iracional, *në mendje lind vetvetiu dhe mbetet si një lëmsh ndjenjash.* Kjo është arsyeja pse besimi i cili nuk mund të krijojë qytetërim, kulturën e lë në gjendje primitive. Nëse me kujdes ndalemi pak, do të shohim se *dallimi ndërmjet besimit me kualitet krijues të qytetërimt dhe atij pa kualitet të këtillë, ka të bëjë me “drejtësinë dhe saktësinë” e besimit sipas këtij ose atij kriteri.* Ky është dallimi ndërmjet përfaqësimit të besimit (në formë që të jetë temë e arsyetimit) në mendje si i vetëdijsëm dhe racional dhe lindjes së tij në mendje si një reaksion emocional mbi të cilin nuk mund të logjikohet. Teoria, edhe pse e pranon pohimin e antropologëve se çdo shoqëri njerëzore,

nga më e thjeshta deri te më e komplikuar zotëron një tërësi kulturore, në një trajtë që nuk e kanë bërë antropologët jep sqarim teorik mbi dallimin mes kulturave primitive dhe atyre brenda kornizave të qytetërimit. Kësisoj teoria, në vend që kualifikimet "primitiv"- "i civilizuar" t'i përdorë me një mendësi subjektive dhe diskriminuese, hap rrugët e përdorimit të tyre me një mendësi objektive e cila e thekson mekanizmin e formimit të kulturave.

Që qytetërimi, i cili është një sistem besimi dhe morali i vetëdijshëm dhe racional, të realizohet dhe të jetësohet në kuadër të jetës konkrete shoqërore, aq sa ka nevojë për organizim politik, ka nevojë edhe për strukturë ekonomike. Për këtë arsye, qytetërimet janë krijuar në gjeografi ku mund të krijohet kjo strukturë. Qytetërimi mesopotamian, egjiptian, indian, kinez, grek, romak dhe islam janë krijuar në pellgje të lumenjve të volitshëm për zhvillimin e bujqësisë, rreth udhëkryqeve të rrugëve tregtare tokësore dhe detare. Në humbjen e superioritetit politik dhe shkëlqimit të qytetërimit islam dhe në humbjen e nivelit të krijimit të veprave të mëdha kulturore (islame), rol të madh ka luajtur "rrëshqitja" e rrugëve të tregtisë tokësore dhe detare jashtë gjeografisë ku u krijua qytetërimi (islam). Sipas teorisë sonë, kualiteti i sqaruar dhe sistemi i besimit dhe moralit paraqesin shpirtin lindës të qytetërimit. Teoria e cila thotë se shpirti i qytetërimit është burim i energjisë shpirtërore të njerëzve që krijojnë vepra kulturore, e ka në konsideratë edhe faktin se qytetërimi me organizimin politik dhe strukturën ekonomike fiton një realitet shoqëror. Në këtë kontekst, sipas teorisë, shtylla qendrore e qytetërimit është sistemi i besimit dhe moralit, kurse shtyllat mbështetëse, organizimi politik dhe struktura ekonomike. Krijimi dhe rënia e qytetërimeve ndodh paralel me këto themele. Faktorët, si cenimi i sovranitetit politik dhe çoroditja e strukturës ekonomike, mund të jenë ndikues që më vonë mund të

përmirësohen. Por, nëse për këtë ose atë arsye, sistemi i besimit dhe moralit e humb kuptimin në shpirtin e individit dhe fuqinë e të qenët themel i shoqërisë, vjen deri te shkatërrimi i qytetërimit.

Pas këtyre sqarimeve, kontributin e teorisë në fjalë në drejtim të kuptimit të çështjeve të kulturës dhe qytetërimit mund ta rezymojmë kështu:

**1.** Teoria, me konceptualizimin e vet kulturën dhe qytetërimin i ka ndarë qartë dhe prerat. Përzierja e kulturës me qytetërimin është e pamundur në korniza të kësaj teorie. Teoria i ka dhënë fund konfuzitetit të llojit kulturë materiale dhe kulturë shpirtërore.

**2.** Teoria ka treguar lidhshmërinë strukturore midis qytetërimit dhe kulturës.

**3.** Teoria kulturën primitive dhe kulturën e lidhur me një qytetërim e ka ndarë me një kriter teorik.

**4.** Teoria fenomenin e të qenët e kulturës tërësi, e ka elaboruar duke e lidhur atë me ndikimin formësues dhe zgjedhës të një sistemi përfshirës të besimit dhe moralit.

**5.** Teoria i ka evituar paqartësitë dhe paqëndrueshmëritë në sferën e çështjes së këmbimeve kulturore dhe ndryshimit të qytetërimit, ndërsa fenomeneve nga kjo sferë u ka dhënë një ndriçim konceptual. Ajo i ka kthjellësuar kushtet e të qenët të ndryshimeve kulturore të shëndetshme ose të dëmshme.

**6.** Teoria ka shpjeguar se lindja e qytetërimeve varet nga sistemi i besimit dhe moralit të kualiteteve dhe kushteve të caktuara. Duke mos e determinuar përmbajtjen e atij sistemi, çështjes i ka ofruar një parim abstrakt dhe të përgjithshëm.

**7.** Teoria ka treguar se shkatërrimi i qytetërimeve është i lidhur me disa faktorë, por në pikë të fundit është çështje e tronditjes dhe e çoroditjes së sistemit të besimit dhe moralit.

# KREU IV



## **Qytetërimet e vjetra në dritën e teorisë së elaboruar**

Familja është institucioni themelor i bashkësive njerëzore. Struktura e saj bile edhe nëse merr trajta të ndryshme, është një institucion rrënja e së cilës është në prirjet biologjike. Bashkësia e cila është formuar pastër nga rruga sociale, pa u bazuar në tendencat instiktive dhe afrimet natyrore, është shoqëria e qytetit. Qyteti është një shoqëri njerëzore, e formuar nga individë që duke u "lidhur" midis vete me një lidhje abstrakte që e tejkalon atë të gjakut, duan të jetojnë së bashku në një vend të caktuar. Kontinuiteti i shoqërisë së qytetit varet nga marrja nën kontroll të instikteve dhe pasioneve egoiste. Si përfundim, duhet të lindin norma që me qejf do t'i pranojë dhe respektojë çdokush. Ja pra, ky është themeli mbi të cilin ngritet institucioni i politikës. Shoqëria politike, ndryshe nga bashkësia e personave që janë mbledhur në saje të afërsisë së gjakut ose tendencave natyrore, paraqet shoqërinë e njerëzve, të cilët jetojnë së bashku duke iu përmbajtur normave që i kanë formuar me vullnetin e vet pasi që kanë arritur kompromis. Nga ky aspekt, shumë kuptimplotë është dukuria që qytetërimet e mëdha janë formuar përreth qyteteve.

Vatërzimi i vetëm një shkak në ngjarjet historike, në të shumtën e rasteve është hap i gabuar. Kushtet që e plotësojnë njëri-tjetrin dhe që e forcojnë ndikimin e njëri-

tjetrit e përbëjnë mizansenin e skenës historike. Të kujtuarit se kushtet janë rastësisht dhe se ngjarjet nuk kanë ndonjë domethënie, më së paku nga aspekti i përpjekjes për kuptimin e historisë, është një hipotezë e papërshtatshme. Nëse nuk postulohet ekzistenca e një strukture që e bën të duhur studimin e ngjarjeve dhe të marrurit mësim nga ato studime, humbet arsyeja e ekzistencës (*raison d'être*- A.P.) së shkencës së historisë. Edhe pse thuhet se "historia është identiteti i përsëritjes", si pasojë e faktit që njeriu i përsërit gabimet e njëjta, prapëseprapë mund të thuhet se është e vërtetë se evenimentet historike me kushtet, hapësirën dhe kohën janë specifike vetëm një herë. Por, nga fakti se historia nuk përsëritet, s'mund të nxirret pohimi se ngjarjet historike paraqesin vetëm rastësi. Sikur të ishte ashtu, historia do të ishte një kronologji e zhveshur, kuptimi i së cilës nuk do të nxirrej në pah. Për këtë arsye, shkencën e historisë edhe pse në lidhje me proceset në kushte të komplikuar nuk e kërkon vetëm një shkak, prapëseprapë mundohet ta caktojë faktorin kritik i cili së bashku me kushtet, procesin e bie në pozitë të një tërësie kuptimplote. Në ligjëratën e javës së kaluar, u shpreha se faktori kritik në formimin e qytetërimeve është sistemi i besimit dhe sistemi moral, i cili është i lidhur dhe varet nga i pari (sistemi i besimit). Ja pra sonte, duke i studiuar qytetërimet e Mesopotamisë, Egjiptit, Greqisë dhe Romës nga prizmi i këtij faktori kritik, do të mundohem që ta nxjerr në shesh themelin historik të hipotezës së prezentuar.

Qyteti, i cili paraqet boshtin e qytetërimit, nga aspekti i procesit historik, në jetën e njeriut përfaqëson një tjetërsim shpirtëror dhe social. Edhe pse gjaku dhe lidhja familjare në kornizat e veta kanë një funksion të caktuar, jeta civile në kuadër të shoqërisë së gjerë, përmbi këtë lidhje konkrete dhe natyrore, e bën të duhur lidhshmërinë



abstrakte dhe racionale. Për të vazhduar një jetë shoqërore qytetëruese dhe stabile, lidhshmëria në “kornizën” e qytetit duhet të realizohet në një rrafsh abstrakt dhe racional. Individidi për hir të stabilitetit të shoqërisë duhet që me sinqeritet t’i lidhet asaj. Por, duhet ditur se “shoqëria” nuk paraqet vetëm shumën e individëve që e përbëjnë atë. Individidi në kohë dhe rrethana të ndryshme hyn në marrëdhënie me individët tjerë, ndërsa individët dhe marrëdhëniet e tyre mund të vëzhgohen në mënyrë konkrete. “Shoqëria” nuk është një qenie konkrete, por është një sistem ku individët marrin pjesë me vetëdijen e vet. Individidi, derisa të arrijë në fazën e pjekurisë, në kuadër të përvojave të veta nga karakteri i relacioneve që i percepton, duke e abstrahuar sistemin që i udhëheq ato relacione, të njëjtin (sistem) e mbjell në shpirtin e vet. Atëherë pra, kuptimi i besnikërisë ndaj shoqërisë është të kuptuarit dhe pjesëmarrja në sistemin që i udhëheq ato marrëdhënie. Individidi, për të ndjerë besnikëri ndaj shoqërisë, duhet ta kuptojë dhe ta çmojë sistemin në fuqi. Përfitimi i individit nga rezultatet e aktiviteteve shoqërore varet nga pjesëmarrja në sistemin i cili drejt dhe sigurt u prin aktiviteteve në fjalë. Për individin që e ka kuptuar këtë, respekti i tij dhe i të tjerëve ndaj sistemit është një moment shumë i rëndësishëm. Gjëja e quajtur sistem, në aspektin sociologjik nënkupton normat, kurse në atë psikologjik moralin e individëve. Përputhshmëria ndërmjet normave të shoqërisë dhe moralit, që individët shpirtërisht e kanë parapëlqyer, siguron funksionimin harmonik të shoqërisë dhe rehatinë e paqen tek individët. Teoria e qytetërimit e elaboruar në këtë rast pyetjes “Ç’është burimi i sistemit që e siguron harmoninë dhe qetësinë?”, i përgjigjet me: “Burimi i sistemit është besimi i përbashkët”. *Besimi, individët i bashkon në një “të vërtetë” shpirtërore që i tejkalon ata dhe i lidh me sistemin i cili është*

*rezultat i asaj të vërtete shpirtërore. Parafytyrimi i asaj të vërtete shpirtërore e bën vetëdijësimin e individëve. Individët, duke u lidhur me të vërtetën shpirtërore, me atë të vërtetë, e cila lë mbresa të thella në shpirtin e tyre, lidhen ndërmjet vete me ndjenjën unifikuese. **Besimi i përbashkët** është burimi i njëjtë, i cili individëve ua jep frymëzimin e fuqisë shpirtërore, solidaritetin shoqëror dhe krijimin e veprave të mëdha kulturore.*

## Qytetërimi i Mesopotamisë

Bujqësia është zbuluar në pllajat/rrafshnaltat e Lindjes së Afërme. Bujqit e parë duke u frikuar nga katastrofat natyrore, kanë qëndruar larg fushave të shtrira buzë lumenjve. Pas përparimit të mjaftueshëm në sferë të teknologjisë dhe pas mësimit të bashkimit të mundit të vet në një formë frytdhënëse vendosën që të zbresin në pellgjet e lumenjve. Vendosja në këto vise kërkonte që ekipe të mëdha me një aktivitet koshient të ndërtojnë penda dhe të gërryejnë kanale. Uji i Eufratit mund të shfrytëzohej vetëm në këtë mënyrë. Në Mesopotaminë e poshtme aty kah vitet 3500-3000 (para Isait a.s.) filluan të formohen bërthamat e qyteteve-shtete të para. Këto nuk ishin vetëm vendbanimet e para më të mëdha se fshatrat. Në to, për një kohë të shkurtër u paraqit organizimi politik dhe profesionalizimi në veprimtaritë prodhuese. Historianët e antikitetit termin *cité* e përdorin në kuptim të procesit të formimit të qytetit. Në këto qytete të antikitetit, në të cilat ka filluar qytetërimi, 90 %-shi i popullatës merrej me bujqësi. Por bujqit nuk jetonin të vetmuar. Bujqit që jetonin në qytet zotëronin ara në tokat buzë qytetit. Popullata e qytetit ishte e lidhur me qytetin me një ndjenjë të ngjashme me atë të vetëdijes qytetare.

Në Mesopotami, kushtet natyrore ishin të volitshme për krijimin e lehtë të qytetërimit. Me të reshurat e bollshme të shiut, që fillonin papritur, rritej niveli i lumenjve. Në parahistori, si pasojë e vërshimeve, erozioneve

dhe përmbytjeve vinte deri te shkatërrimi i fshatrave, e pastaj sipas pozicioneve të reja të ujit dhe tokës, formoheshin vendbanime të reja. Por, qytetet e mëdha dhe konstantë, që ishin të lidhura me kanalizimet dhe sistemet e ujitjes, kishin nevojë për shtretër të pandryshueshëm të lumenjve. Te njerëzit, që në këtë fushë të ndryshueshme e jostabile duke derdhur djersë të madhe krijonin qendra vendbanimi, lindte ndjenja e pesimizmit. Trimëria dhe frika ndaj dukurive natyrore, që nuk mund të mbaheshin nën kontroll ekuilibroheshin në kornizat e një besimi që e determinonte edhe organizimin shoqëror. Kështu u projektua ideja se qyteti udhëhiqet nga një Zot dhe u përhap bindja se zotëruesi i njerëzve nga brendia e qytetit dhe jashtë tij është Zoti. Qyteti ishte pronë e Zotit dhe shoqëria duke punuar, i shërbente Atij. Edhe pse ekzistonte një Zot që ishte pronar i qytetit, ekzistonin edhe zotëra të shkallës së dytë. Në ndërkohë u ndërtua edhe një tempull, i cili u quajt “Shtëpia e Zotit”. Tempulli i ngritur në tokë të rrafshët dhe në një lartësi ose maje artificiale, ishte një ndërtesë e ngritur kah qielli që të jepte përshtypjen se është synuar që ajo të mbajë kontakt me qiellin. Tempulli jo vetëm që e përfaqësonte madhësitë e zotave, por në të njëjtën kohë e përfaqësonte edhe fuqinë e shoqërisë që kishte arritur ta ndërtojë atë. Tempulli i cili është ndërtuar me qëllim të mbrojtjes dhe marrjes në siguri të qytetit të Zotit, në të njëjtën kohë sa ishte simbol i lidhshmërisë ndaj Zotit, aq ishte edhe simbol i krenarisë së të qenët qytetar. Tempulli e forconte unitetin politik të qytetit. Themeluesit e qytetit inspirimin për përballimin e mundimeve në “luftën” përballë dy lumenjve e merrnin nga besimi që kishin në mbështetjen e Zotit.

Besimi i sumerasve që kishin krijuar qytete-shtete në jug të Mesopotamisë, nuk e kishte karakterin e fesë individuale. Ai nuk i përmbante konceptet e lutjes (duasë)

dhe shpëtimit individual. Zotat sumeras ishin zota të shoqërisë, zota të qyteteve. Sipas besimit që mbisundonte në shoqërinë sumerese, njeriu qëllimit të ekzistencës mund t'ia arrinte vetëm në saje të shërbimit ndaj zotave. Në këtë besim nuk ekzistonte koncepti për jetën e pasvdekjes. Njerëzit që mundoheshin të mbijetojnë duke "luftuar" me kushtet e ashpra natyrore, frikoheshin nga zotat, i madhëronin ata dhe tërë jetën punonin që t'ua shuajnë hidhërimin dhe ta fitojnë mbështetjen e tyre.

Pjesëtarët e shoqërisë qytetare, pasi që sovranitetin shoqëror e shihnin te Zoti, në të shërbyerit ndaj Zotit ishin në pozitë të njëjtë. Ky shërbim, në fushën reale të jetës paraqiste një bashkëpunim të organizuar deri në pikë të fundit. Qendra e organizimit ishte tempulli. Sistemi i tillë ngërthente njëfarë planifikimi shoqëror. Aty aplikoheshin programe të punës kolektive, punët ishin të ndara, kurse produktet e punës kolektive tuboheshin, dorëzoheshin dhe vendoseshin në depon e tempullit e pastaj çdokujt i jepej pjesa e merituar (drith, lesh etj.). Parimisht të gjithë pjesëtarët e shoqërisë ishin të barabartë. Nuk ekzistonte klasë që jetonte pa punuar. Nuk ekzistonin as serfë (bujkrobë) vendas. Edhe pse disa të huaj dhe skllëvër lufte shfrytëzoheshin si robër, i paktë ishte numri i atyre që i kishin robërit e vet personal. Robërit së bashku me qytetarët brenda pronës së tempullit punonin si hamallë ose kopshtarë. Robëreshat zakonisht shfrytëzoheshin si ndihmëse në punët e tjerjes së leshit dhe të kuzhinës. Nëpunësit dhe priftërit, barinjte dhe peshkatarët, kopshtarët, zejtarët, tregtarët, po bile edhe robërit, ishin nga bashkësia e tempullit dhe emërtoheshin sipas Zotit që e besonin, p.sh. "pjesëtar i besimtarëve të filan Zotit". Një pjesë e tokës së arave ishte shpallur si tokë kolektive. Pasi që në depo hynte një sasi shumë e madhe e produkteve, ishte zhvilluar një sistem preciz i regjistrimit.

Shfrytëzohej një sistem i shkrimit që ishte përzierje e shkrimit me vizatime dhe atij fonetik primitiv. Tubimi i prodhimeve në një qendër të këtillë ofronte mundësitë për ndihmën e nevojtarëve dhe formimin e një sistemi të sigurimit. Pjesa tjetër e tokave punuese u ishte ndarë familjeve. Pasi që mbisundonte monogamia dhe nuk ekzistonte institucioni i robërisë, çdo familje mund të merrte vetëm një sasi të caktuar të tokës. Sistemi, edhe pse mbështetej në planifikimin qendror, kishte një fleksibilitet që e mundësonte ekzistencën e ndërmarrjes (iniciativës) individuale. Ekzistonte edhe prona private dhe këmbimi. Tempulli ishte një institucion fetar që e rregullonte jetën ekonomiko-shoqërore. Edhe pse dimensionin ekonomiko-shoqëror konceptualisht mund të ndahej nga ai fetar, në spiritualitetin dhe jetën e shoqërisë që e ka themeluar tempullin, këto dy dimensione përbënin një tërësi identike dhe të pandashme.

Sumerasit jetën qytetare në Mesopotami e kishin krijuar me përpjekje të mëdha. Ashpërsia e klimës, rreziku nga përmbytjet, kushtet e rënda për mbrojtjen e tokës dhe tmerrri i sëmundjeve që përnjëherë lindnin dhe përhapeshin, nga vetvetiu e gjeneronin ndjenjën e strehimit në ndihmën e zotave. Te sumerasit feja edhe pse ishte mitologjike, trajta e projeksionimit të saj në mendje nuk e pengonte të menduarit racional. Bota e besimit përmbante një sistem racional. Pasi që zotat ishin zota të vetë qytetit, tregohej pedanteri që të veprohet me ndjenjën e solidaritetit dhe që produktet t'u dorëzohen zotave. Shkenca, e cila është fryt i të menduarit racional, në qytetërimin e Mesopotamisë më tepër bëhej me një orientim praktik sesa teorik. Stili i të menduarit shkencor i ndarë nga besimi dhe filozofia është një zhvillim mendor i kohërave të afërta. Por, nuk duhet harruar se bile edhe mitologjitë paraqesin rezultate të kërkimit të mendjes së

njeriut të shkaqeve dhe sqarimeve rreth enigmave të ekzistencës së vetë njeriut dhe enigmave që i përmbajnë dukuritë natyrore. Për këtë arsye, fenomeni kur mendja e njeriut (në aventurën para shumë mijë vjetëve) e braktisi fazën e emocionit natyror dhe reaksionit instiktiv dhe filloi të dalë në skenë me projeksione në nivel racional, paraqet një zhvillim me rezultate shumë të rëndësishme. Përpyekjet e njeriut - duke qenë të vetëdijshme për mendjen dhe mendimin e vet - për të bërë sqarime racionale në planin abstrakt mendor, mbi rrafshin e reaksionit direkt, bile edhe nëse në brendinë e tyre (përpyekjeve) përzihen elemente mitologjike, paraqesin kushtin themelor të të qytetëruarit të tij. Në këtë kontekst, të qytetëruarit paraqet vajtjen në burimin mendor i cili i lind elementet kulturore. Pikënisja e zhvillimit shumëdimensional të mendimit njerëzor që daton para mijëra vjetëve, paraqet operacionet mendore të përziera me elemente mitologjike por që kanë hapëruar në nivel racional. Sot dihet mirë se astrologjia paraqet bestytin, por më vonë, në kohën e babilonasve të ri, të cilët e morën në duar të veta sovranitetin politik në Mesopotami, relacioni ndërmjet fenomeneve qiellore dhe atyre tokësore, studioheshte me një shpirt të atillë hulumtues, sa që në atë kohë kur nuk ekzistonte një thesar i këtillë i diturisë, nga aspekti i trajtimit, qasjes, veprimtarisë e këtilla (për atë kohë) lirisht mund të atribuohen si *shkencore*. Regjistrimi i produkteve që hynin dhe që dilnin nga tempulli, në pikëpamje të kategorisë, sasisë, kohës, personit dhe caktit, nga ana e sumerasve paraqet provën e një organizimi të vetëdijshëm dhe racional. Tempulli ishte me dimensione aq madhështore sa që paramendohet të jetë ndërtuar brenda pesë viteve me mundin e 1500 punëtorëve që kanë punuar nga 10 orë në ditë pa ndërprerje. Kur kemi parasysh se është ndërtuar me tulla të bëra nga delina (glina) e

thatë, mund të thuhet se tempulli ka përjetuar restaurime të shpeshta të përmasave të mëdha dhe se ndërtimi i tij në realitet asnjëherë nuk ka mbaruar. Pasi që te sumerasit nuk ka ekzistuar ekonomia monetare dhe deponimi me qëllim të fitimit në kohë të liga, mund të thuhet se kjo vepër është ngritur me punën e vullnetarëve në formë të ndërrimeve/turneve. Jeta buronte nga zotat dhe njerëzit. Me ndjenjën e adhurimit duke dhënë një mund mbi normalen, ata e ndërtonin tempullin i cili do t'i afroonte te Zoti. Tempulli i ndërtuar për ta merituar mbrojtjen e Perëndi, në të njëjtën kohë ishte dhe simbol i ndjenjës së të qenët anëtarë i shoqërisë së qytetit.

Elementi i besimit të rrafshit të mendimit racional i ka bashkuar njerëzit njëri me tjetrin me një vegzë abstrakte. Në shoqërinë e qytetit, njerëzit të cilët veprat e tyre reciproke i programojnë konform disa normave që burojnë nga besimi kolektiv, kanë krijuar *dimensionin politik* të jetës. Kufizimi i këtij dimensionit universal, që lind në një rrafsh mendor dhe në kushte të caktuara jetësore dhe me një regjim të caktuar, nuk përputhet me pikëpamjen tonë të hulumtimit. Faktori që shoqërinë e qytetit e ka sjellë në gjendje të qytet-shtetit është vetëdija politike e cila e ka zhvilluar projeksionin abstrakt të "qytetit" dhe e cila e ka siguruar besnikërinë ndaj tij (qytetit). Qyteti nuk njihte ndonjë autoritet të jashtëm. Ai mund të merrej nën hegjemoninë e një fqiu, por besnikëria e tij nuk mund të fitohej me forcë. Vetëdija e përkatësisë së një qyteti, nuk mbetet vetëm me lindjen e ndjenjës së besnikërisë ndaj qytetit dhe të krenarisë me sukseset e tij, por po ashtu e lind edhe kapacitetin e projektimit - në planin racional- të organizimit shoqëror dhe politik. Te sumerasit, autoritetin politik edhe pse në esencë e kishin vetë qytetarët, sovraniteti politik, të cilin e përfaqëson Zoti i qytetit, gjendej në duart e parlamentit, i cili



udhëhiqej nga një koncil i pleqve. Ata nuk dinin për konceptin mazhorancë votash. Parlamenti i vazhdonte sesionet e veta derisa të arrihej konsenzusi. Në gjendje të jashtëzakonshme kur kishte nevojë për vendime dhe akcione emergjente, i jepej autorizim një diktatori, i cili në gjuhën sumerese quhej *lugal*, që në përkthim do të thotë "njeri i madh". Te sumerasit nuk ekzistonte koncepti i mbretit të hyjnizuar. Nga aspekti i pikëpamjes sonë, me rëndësi është e vërteta se organizimi politik sumeras mbështetej në projeksionin e njeriut në planin racional dhe se paraqiste një strukturë shoqërore që i tejkalonte grupimet e stilit klanor që nuk mund të krijojnë qytetërim.

Një strukturë shoqërore në nivelin e cekur më lartë, në mënyrë të domosdoshme me vete e sjell ndarjen e mundit, shtresimin (ang. *stratification-A.P.*) etj. Sipas besimit kolektiv, nga aspekti i të qenët në shërbim të zotave çdokush është i barabartë. Përskaj kësaj, në mesin e njerëzve që kryejnë funksione të ndryshme lindin ndryshime edhe në statusin social. Bujqit që në jetën fisnore fshatare janë me status të njëjtë dhe si anëtarë të njësisë qytetare pjesën më të madhe të prodhimeve të veta ia dorëzonin tempullit, pjesën tjetër e shitnin në tregun ku dominonin shtresat tjera shoqërore. Në këtë mënyrë, kalimi nga ekonomia familjare në ekonominë shtetërore dhe tregtare gjeneroi marrëdhënie të reja shoqërore. Kështu lindi mundësia për eksploatim midis grupeve me status të ndryshëm të cilat mbanin marrëdhënie midis vete. Dobësitë njerëzore si atraksioni (tërheqshmëria) e fuqisë së ndikimit shoqëror, pasioni për pushtet dhe tendenca e vrapimit pas profitit egoist, gjetën platformën ku në fushën e marrëdhënieve të reja do ta tregonin vetveten. Prijësit, tregtarët dhe zejtarët, të cilët ishin specialistë të organizimit tempullor edhe pse kishin kushte të mira jetësore, ishin të lidhur dhe vareshin nga priftërinjtë.

Përveç këtyre shtresave, bujqit të cilët kishin mbetur në pozitë të fshatarëve, për të çuar jetë, dita-ditës hynin në borxh të tempulli. Pasioni i priftërinjëve dhe tendenca e tyre për eksploatim, bujqit i detyronte që të dorëzojnë sa më tepër prodhime. Aty ku ekziston forcë, qoftë ajo materiale ose shpirtërore, ekziston edhe mundësia e keq-përdorimit të saj. Kjo tendencë që buron nga dobësia e natyrës së njeriut, me kalimin e kohës e tregoi veten edhe në shoqërinë sumerese, e cila në esencë ishte egalitariste. Eksploatimi dhe presioni, filluan ta copëtojnë sistemin moral dhe solidaritetin shoqëror, të cilët ushqehen nga besimi. Përpos kësaj, kripa të cilën e sillnin ujërat e lumenjve, në vendet me klimë të nxehtë me avullimin e ujit mbetej mbi tokë dhe akumulohet. Në këtë mënyrë toka shkonte duke e humbur pjellshmërinë e vet. Lidhur me këta dy faktorë, qytetet sumerese, veç më nuk mund ta ofronin mbështetjen që e pritnin priftërinjtë. Përderisa shtresimi social dhe ekonomik përmes punës produktive dhe bashkëpunimit ishin mjet për shtimin e solidaritetit, me daljen në plan të parë të dobësive të njeriut u bë shkak i krijimit të autoritetit social dhe eksploatimit ekonomik. Kjo gjendje shkaktoi degradim shpirtëror.

Padrejtësia dhe pandërgjegjshmëria që u paraqitën në shoqëritë qytetare sumerese të Mesopotamisë (e cila konsiderohet djep i qytetërimit), janë faktorë shkatërrues të të gjitha qytetërimeve deri në ditë të sodit. Qytetërimi si jetë e organizuar shoqërore, paraqet një tërësi harmonike ku çdo komponentë e plotëson tjetrën. Për këtë arsye, pa marrë parasysh se ku ka filluar kalbja, apo prishja, duke u shkatërruar qytetërimi, edhe ekonomia ka ardhur në pozitë të falimentimit. Padrejtësia dhe eksploatimi kanë dalur mbi ujë, është tronditur besimi dhe është zbehur solidariteti shoqëror. Kështu mund të diagnostifikohet panorama e shkatërrimit të qytetërimit sumeras.

*Ensi*, i cili (në shoqërinë sumerese) ka qenë koka e udhëheqësisë së qytetit në emër të parlamentit, ka pasur statusin e të besuarit të Zotit të qytetit, sovranit të vërtetë. Besimi sumer, te ai nuk shihte as zgjedhshmëri hyjnore e as epërsi ose privilegj të lindur. Firma ose vula hyjnore gjithmonë mund të merrej prapë. Është e vërtetë se froni nga baba te djali kaloi përafërsisht 3000 vjet para Isait (a.s.) në periudhën e Dinastisë së Parë, por në doktrinën mbretërore një gjë e tillë nuk ka baza, andaj push-teti (froni) konsiderohej dhunti nga zotat. Në këtë aspekt lidhshmëria ndaj qytetit kishte një rol kufizues ndaj monarkisë. Por, te sumerasit lidhja ndaj qytetit si një njësi politike, ishte barrierë për bashkimin e qyteteve nën patronazhin e një mbretërie.

Në qytet, nën komandën e drejtpërsëdrejtë të liderit politik të quajtur *ensi* kishte ushtarë profesionistë, të cilët paraqitnin një burim të rëndësishëm të fuqisë. *Ensi*, sikurse edhe çdo qytetar merrte hise me të cilën e siguronte ekzistencën. Por arat e tij i përkisnin tokës kolektive dhe përpunoheshin në kuadër të obligimeve publike të popullatës. Në festivalet e përgatitura për zotat, prezantimi i dhuratave *ensit*, paraqiste gjestin e shprehjes së epërsisë së statusit të tij. *Ensi* caktonte disa tagra dhe merrte një sasi materiale si kundërvlerë për vendimin që binte në lidhje me divorcin e ndonjë personi. *Ensi*, i cili e kishte statusin e prijësit të tempullit, anëtarët e familjes së vet i caktonte në poste nëpër tempujt tjerë. Në këtë mënyrë, bile edhe nëse autorizimi i parlamentit nuk zhvleftësohej në tërësi, *ensi* de facto ishte në pozitë të sovranit. Kompaktësia e shoqërisë sumerese me organizimin tempullor ishte themeli i solidaritetit dhe fuqisë shoqërore. Por, shoqëria e cila shkonte duke u bërë më komplekse kishte nevojë për prijësi (liderizëm). Kur liderët e organizimit tempullor e përdorën këtë nevojë për t'i

bërë presion popullit, organizimi i cili e homogjenizonte shoqërinë, u transformua në një rend i cili e shtypte dhe e eksploatonte atë (shoqërinë).

Në periudhën e Dinastisë së Parë, në qytet-shtetin e Lagashit kundër këtij transformacioni u organizua një lëvizje reformiste që nuk dha rezultate. Një ensi i quajtur Urukagina, u orvat që shoqërinë sumerese ta kthejë në gjendjen primordiale teokratike. Në një fjalim të tij të shkruar në pllaka mes tjerash thotë se "me qëllim të mbrojtjes së jetimit dhe vejushave karshi njerëzve të fortë, ka bërë kontratë me zotin Ningirsu (Zoti i qytetit Lagash)". Më tutje shton se ai i ka fshirë privilegjet e nëpunësve dhe specialistëve, se e ka kthyer të drejtën e qytetarit modest ndaj pronës së vet dhe se ka bërë zbritje në çmimet e shërbimeve të varrosjes dhe lutjes. Aty shpall se u ka dhënë fund keqpërdorimeve të pararendësve të vet, se veç më "qetë e Zotit nuk do ta lëvrojnë dhe punojnë arën e qepëve të ensit". Nga kjo që u cek kuptohet se Urukagina, synon që nga njëra anë komunitetin e tempullit ta kthejë në pastërtinë e mëparshme, e nga ana tjetër ta fitojë mbështetjen e popullit për "pushtetin" e organizuar nga vetë ai. Por, u bë ç'u bë, planet e tij shkuan huq. Urukagina u sulmua dhe u shkatërrua nga prijësi i qytetit fqj i quajtur Umma.

Korrupsionet të cilat deshi t'i evitojë Urukagina, ishin ligësi që e degjeronin çdo ideal politik. Një dobësi specifike për Mesopotaminë ishte mosbashkimi i qyteteve-shtete dhe lufta e tyre permanente për ta shkatërruar njëri-tjetrin. Mbreti akadas Sargon, ngadhënjëu në luftë me Lugalzagesin i cili e kishte shkatërruar Urukaginën, dhe me prijësit e qyteteve tjera arriti ta bashkojë tërë vendin. Sargoni I, i cili e themeloi qytetin Akad, popullin e vet me prejardhje semite dhe qytetet-shtete sumerese i bashkoi nën flamurin e një perandorie. Por ç'e do

që midis sumerasve nuk u zhvillua ndjenja e të qenët i lidhur me një shtet qendror dhe nuk u shlye vetëdija për veçantinë dhe privilegjin e qyteteve të veta.

Më vonë, një komunitet i egër nga majat e Elamit, Guti, i dha fund perandorisë së parë mesopotamiane. Në ndërkohë sumerasit në periudhën e Dinastisë së Tretë, në Ur, për nja 150 vjet, luajtën një rol mjaft të rëndësishëm. Në vitin 2025 para Isait (a.s.), me pushtimet e elamasve dhe amoritasve mbaroi edhe periudha e Dinastisë së Tretë. Përafërsisht në vitin 2000 para Isait (a.s.), Hamurabi e çliroi atdheun sumeras dhe më vonë nën pushtetin e vet e mori edhe pjesën tjetër të Mesopotamisë deri në Siri. Në këtë periudhë kur ishte përhapur gjuha semite, gjuha sumerese ishte një gjuhë e shenjtë të cilën e mësonin dhe e ruanin priftërinjtë. Thesari i diturisë së sumerasve si arti dhe legjendat e përbëjnë themelin e kulturës. Hamurabi i përpiloi kanunet e njohura me emrin e tij. Këto zakone në një aspekt janë tregues të rrënujave shoqërore dhe ekonomike, të cilat e bënin të domosdoshme një gjë të tillë (përpilimin dhe aplikimin e kanuneve të lartpërmendura- A.P.). Kanunet e Hamurabit nuk bazohen në parimin e "barazisë para ligjit". Në këtë mënyrë nga orientimi shoqëror egalitarist i sumerasve, u arrit në një pikë kur u legalizua pabarazia. Robërit të cilët si pasojë e luftërave imperialiste përbënin një pjesë të madhe të shoqërisë zaten nuk kishin kurrfarë të drejte. Te ata edhe për gabimin më të vogël aplikohesh ndëshkimi me prerje të organeve të ndryshme të trupit. Përveç robërve, ekzistonin edhe dy klasa zyrtare. E para, klasa e "njerëzve", e cila i përfshinte aristokratët, ndërsa klasa tjetër nuk ishin as robër e as nuk bënin pjesë në kategorinë e "njerëzve". Edhe pse kanuni nuk sillej mirë ndaj tyre sikur ndaj pjesëtarëve të klasës së parë ("njerëzve"), ata prapsepapë gëzonin ca të drejta. Fakti se ndëshkimet kanë qenë

të ashpra dhe të menjëhershme, pa hulumtuar nëse ka pasur ose jo qëllim në gabimin e bërë, sipas parimit "syri për sy, dhëmbi për dhëmb", kuptohet se në plan të parë ka qenë pengimi i të këqijave. Rregullimi zyrtar në shitblerje, që bazohej në parimin "blerësi le ta ruajë vetveten", kishte për qëllim pengimin e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve. Ishte paramenduar se nëse blerësi e di se duhet të jetë i kujdesshëm dhe se nuk do të mund të kërkojë hak, nuk do të lindin probleme.

Në këtë periudhë paralel me këto zhvillime juridike janë shtuar edhe botëkuptimet se në këtë botë i miri çdoherë nuk është rehat dhe se të keqit, nëse më me sukses e kryen punën, edhe përskaj asaj që e bën, i mbetet përfitim. Ndryshe nga sumerasit, është zhvilluar bindja se çdo njeri mund ta ketë Zotin e vet personal tek i cili do të strehohet. Në këtë mënyrë feja fitoi një dimension individual. Por te babilonasit ideja për botën e ardhshme nuk ka pasur kurrfarë kuptimi. Feja ka qenë e lidhur me forma praktike të kësaj bote. Në lutjet e bëra nuk është kërkuar shpërblimi qiellor, por të mirat e kësaj bote. Sipas besimit në fjalë, edhe i miri edhe i keqi, edhe i mençuri edhe mendjelehti kur vdesin hyjnë në errësirën e tokës dhe fytyra e tyre nuk sheh më dritë. Në tempuj, si shenjë e kryerjes së obligimit ndaj zotave, bëheshin fljime dhe lexoheshin lutje. Për këtë arsye pasuria e tempujve prej brezi në brez vinte duke u shtuar. Priftërinjtë kishin fituar autoritet edhe mbi popullin, kurse nga ana tjetër ishin bërë faktor kufizues i fuqisë së mbretit. Feja e atëbotshme, përskaj pamjaftueshmërisë së dukshme dhe bestytnive që i përmbante, ishte një burim të cilin mbretërit e përdornin për ruajtjen e stabilitetit në jetën shoqërore dhe për ndikimin mbi popullatën që ata të sillen sipas normave qytetare. Zaten mbretërit kanë vazhduar t'i përmbajnë priftërinjtë, ndërsa tempullit i kanë dhuruar

toka, pjesë nga të ardhurat shtetërore dhe nga preja luftarake.

Priftërinjtë pasurinë që vinte duke u shtuar pasi që nuk arrinin ta harxhojnë vetë, e shndërruan në pronë investuese dhe në këtë mënyrë erdhën në pozitë të bujqëve, prodhuesve dhe investuesve më të mëdhenj të vendit. Një faktor tjetër që ndikoi në rritjen e fuqisë së priftërinjve ishte autoriteti i tyre i cili shkonte në rritje të vazhdueshme. Mbretërit vdisnin, kurse zotat vazhdonin të jetojnë. Koncili i priftërinjve, i cili nuk i nënshtrohej atentateve, nuk merrte pjesë në luftëra dhe nuk ndikohej nga sëmundjet dhe zgjedhjet, me anë të politikave afatgjate dhe të durimshme, vazhdimisht e rriste fuqinë e vet.

Te babilonasit, tregtia e ka shkaktuar matematikën, ndërsa matematika duke u bashkuar me fenë e kanë shkaktuar lindjen e astronomisë. Priftërit që kanë zhvilluar aktivitete jo vetëm si gjykatës, burokratë, agronomë dhe ndërmarrës prodhues por edhe si profetizues të zellshëm në sferën e hulumtimit të yjeve, në Mesopotami i vunë themelet e mendimit shkencor i cili më vonë do të përfitojë në përshpejtim me grekët antikë.

Babilonasit kishin zhvilluar disa teknika për pengimin e akumulimit të kripës në tokë. Tregtia veç më ishte zhvilluar bukur mirë. Për këtë arsye, mund të thuhet se në shkatërrimin e Babilonisë shkaku kryesor nuk ka qenë dobësia ekonomike, por okupimi nga ana e hititasve dhe kasitasve, të cilët përdornin teknika të reja luftarake. Në kohën e këtyre lëkundjeve, në vitin 1595 para Isait (a.s.) përfundoi edhe perandoria e gjenezës së Hamurabit. Një zbrazëtirë sovraniteti u paraqit kur hititasit pushtetin e vet vendosën ta përhapin jo nga Mesopotamia, por nga Anadulli. Kasitasit, me plotkuptimin e fjalës, nuk arritën ta shfrytëzojnë këtë rast të mungesës së pushtetit. Kjo

ndodhi për arsye se njerëzve të identitetit politik dhe kulturor u mungonte kualiteti i lidhshmërisë dhe se nga mesi i tyre nuk u paraqit ndonjë lider me influencë. Për një kohë të caktuar në Mezopotami nuk u vendos një pushtet i përbashkët e as që u shënuar një zhvillim kulturor. Kasitasit i pëlqyen dhe përvetësuan teknikat pushtetare të sumerasve dhe babilonasve dhe u besuan zotave sumero-babilonas.

Aty kah viti 1300 para Isait (a.s.) asirianët krijuan një perandori të fortë që e përfshinte edhe Mesopotaminë. Pas vitit 700 para Isait (a.s.), Senasheribi, në bregun e Tigris të epërm e themeloi qytetin Nineveh (Ninova) dhe e shpalli kryeqytet. Në bibliotekën e pallatit të Senasheribit kishte tabela që përmbanin njohuri praktike dhe që i përshkruanin besimet fetare. Këto njohuri ishin me origjinë nga Mesopotamia jugore. Jeta mendore-intelektuale e asirianëve në tërësi bazohej në kulturën sumero-babilonase. Udhëheqësit, për ta drejtuar jetën politike dhe ekonomike bënë përpjekje për përdorimin e çdo njohurie dhe ranë dakord që t'u besojnë zotave të Babilonisë së vjetër. Klasa udhëheqëse nuk i dha rëndësi vetëm fuqisë dhe teknologjisë por edhe zhvillimit intelektual. Por, cilësia dalluese e asirianëve ishte të qenët e tyre të dhënur pas zullumit dhe mbjelljes frikë te të tjerët. Politikat e tyre tmerruese, me të cilat ata mburrehin, reflektohen edhe në veprat e tyre artistike. Reliefet që e zbukurojnë qytetin e Ninevehit e përshkruajnë luftën dhe gjakderdhjet në to. Në to, në detaje përshkruhet gjuajta e luanëve dhe dhënia shpirt e luanëve të zënë. Edhe njerëzit griheshin me një pandërgjegjshmëri të këtillë. Senasheribi, i cili në vitin 689 para Isait (a.s.) e shuajti kryengritjen e Babilonisë, mburrjen e vet e shpreh në këtë formë: "Babiloninë e bëra rrafsh me tokë më keq sesa që do ta shkatërronte një katastrofë e vërshimit". Politika e



ashpërsisë, të cilën e zbatonin asirianët kishte për qëllim mbjelljen e frikës te popujt kundërshtarë. Në këtë drejtim arritën sukses dhe u bënë populli më i urrejtur në Azinë perëndimore. Nipi i Senasheribit, Asurbanipali, në vitin 648 e rrethoi Babiloninë dhe e detyroi qytetin që të dorëzohet. Suksesin e vet e shpallte me këto fjalë: "Shumë njerëzve që vepruan kundër meje ua preva gjuhët dhe më pas urdhërova të ekzekutohen. Të tjerëve kokat ua shtypa për statujat e zotave vendas. Pastaj trupat ua griva dhe ua dhashë qenve, derrave, pretarëve (larashëve) dhe të gjitha shpezëve të qiellit... Duke i arritur këto suksese i kënaqa zemrat e zotave të mëdhenj". Reliefet e Ninevehit e përshkruajnë rrjepjen e lëkurës së njeriut, këputjen e gjuhëve, madje në njërin nga to, mbreti, kokën e robit e drejton me perin që atij (robit) i kalon nëpër gjuhë dhe me një shufër ia nxjerr sytë.

Siç shihet, feja tek asirianët nuk paska bërë gjë në drejtim të zbutjes së ndjenjavepër zullum dhe gjakderdhje. Zoti kombëtar, Asuri, ishte një zot solar (i diellit), por ishte luftëtar i pamëshirshëm ndaj armiqve të vet. Ithtarët e këtij zoti, besonin se zoti i tyre ndjen kënaqësi nga ekzekutimi i robërve para tempullit të vet. Funkcioni themelor i fesë asiriane ishte përgatitja e qytetarëve të rinj me ndjenjën patriotike dhe mësimi i artit se si përmes sakrificës dhe magjisë fitohet afërsia dhe kënaqësia e zotave. Në një atmosferë të këtille shkenca e parë e zhvilluar është arti luftarak. Mjekësia ishte identiteti i mjekësisë babilonase, kurse astronomia nuk ishte gjë përtej astrologjisë babilonase. Me sa duket do të jetë nga merakut e mbretërve për regjistrimin e sukseseve të veta dhe ruajtjes për të ardhmen, që kontributi i asirianëve në sferën e kulturës është identiteti i bibliotekave që ata i kanë rregulluar dhe ruajtur. Në bibliotekën e Asurbanipalit ka pasur 30 mijë tabela të katalogjizuara dhe të

klasifikuara, çdonjëra nga të cilat ku bartur etiketë sipas specifikës determinante. Regjistrimet, në fillim e kanë pasur funksionin e kronologjisë së fitoreve të mbretit (disfatat nuk janë regjistruar). Më vonë, në përbërjen e tyre kanë hyrë narracionet zbukuruese dhe letrare të ngjarjeve të rëndësishme gjatë sundimit të akëcilit mbret, observimet, profetizimet astrologjike, reçetat mjekësore, dëbimi i shpirtërave të këqinj, lutjet, gjeneza e mbretërve dhe zotave etj.

Mesopotamasit e jugut në vitin 614 para Isait (a.s.) duke u bashkuar me medasit arritën që të shpëtojnë nga zgjedha e asirianëve. Pas dy vite luftë, Babilonia u dorëzua. Medasit këtë fitore e bënë shkallë për të kaluar në Anadoli. Në këtë mënyrë kaldejasit arritën të dominojnë me të tërë Mesopotaminë. Pasi që për kryeqytet e zgjodhën Babiloninë, ata u quajtën "babilonasit e ri". Sundimtari më i njohur nga mesi i babilonasve të ri është Nebushadnezar, i cili ndërmjet viteve 604-562 para Isait (a.s.) ka sunduar 42 vjet. Ai është i njohur me atë se ka urdhëruar ndërtimin e "Kopshteve të asmave" që paraqesin njërin nga "Shtatë mrekullitë botërore". Sipas një transmetimi, gruaja e tij, princesha medase, ishte bezdisur nga rrafshësia e Mesopotamisë, e kishte kapluar indisponimi dhe kishte ardhur deri te çekuilibri i saj shëndetësor si pasojë e mallit që kishte për majat e gjelbërta të vendit (atdheut) të saj. Nebushadnezar, për t'ia kthyer shëndetin gruas së vet, urdhëroi ndërtimin e kopshteve kate-kate në formë të terracave, lartësia e të cilave arrinte deri më 25 metra. Terraca më e lartë u mbush me tokë të rrasur dhe të pjellshme dhe në të u mbollën lule të ndryshme dhe drunj me rrënjë të thella. Me anë të sistemit hidrolik të fshehur në brendinë e shtyllave, i lënë në përgjegjësi të robërve, uji i lumit Euftrat shpihej deri në kopshtin më të lartë.

Përderisa zonjat e pallatit mbretëror shëtisnin larg syve të njerëzve, nëpër ato kopshte që lëshonin aroma fantastike, në fushën e poshtme dhe nëpër rrugë burra e gra lëvronin, endnin, ndërtonin dhe bënë hamallëk. Njerëzit të cilët mundoheshin të shpëtojnë nga paqartësia, t'u bëjnë ballë dhimbjeve dhe mundimeve, të cilët mundoheshin të gjejnë një xixë të shpresës, njerëz të cilët brez pas brezi me besim dhe elan kishin krijuar një sistem jetësor, duke u frikësuar nga marrëdhëniet e errëta dhe konfuze të strukturës shoqërore filluan të dyshojnë në zotat. Kështu filluan t'i ndërpresin orvatjet e tyre për gjetjen e së vërtetës dhe t'u dorëzohen kënaqësive kalimtare.

Sipas asaj që shkruan në njërën nga tabelat, Gubarru, i cili e kishte marrë hisen e vet nga tronditjet e shërbimit publik, me një manir prej skeptiku i drejtohet një plaku me fjalë sikur e gjykon:

“O njeri zotërues urtësie, lëre zemrën le të kërcëllojë!

Zemra e Zotit është larg deri në pjesën e brendshme të qiejve.

Urtësia nuk arrihet lehtë, kuptoje mendimin tim.”

Përgjigjja e plakut nuk ofron ndonjë ngushëllim.

“Kujdes, mik, kuptoje mendimin tim.

Njerëzit, punët e njeriut të madh e “të zellshëm në krime” i madhërojnë, të vobektin të virgjër e nënçmojnë.

Njeriun e keq, kriminel, e nxjerrin të drejtë!

Njeriun e vërtetë që kërkon pëlqimin e Zotit e dëbojnë.

E lënë të fortin ta merr ushqimin e të varfërit!

Forcë i japin të fuqishmit!

E shtypin të dobëtin!”

Përskaj kësaj, plaku e këshillon Gubarrun që ta respektojë dëshirën e zotave. Por, Gubarru thotë se nuk ka punë me zotat dhe priftërit, të cilët gjithmonë anojnë andej kah është pasuria më e madhe:

“Ata gënjejnë dhe e fshehin të vërtetën.

Me fjalë të ndershme e mbrojnë të pasurin.

Thua pakësohet pasuria e tij? Me vrap i vijnë në ndihmë.

Me të dobëtin sillen keq sikur të ishte vjedhës.

E përbuzin atë; e shuajnë sikur shuajnë zjarr.”

Populli prapëseprapë me qëllim të sigurimit të ndihmës së zotave i mbushte tempujt dhe me vullnet i dëgjonte priftërinjtë. Priftërinjtë pohonin se është e pamundur të dihet diç jashtë frymëzimit hyjnor dhe se frymëzimi u vjen vetëm atyre. Njeriu mund të dijë vetëm me ndërmjetësimin e priftërinjve. Është çudi e madhe besnikëria shumëshekullore e popullit ndaj një feje e cila pretendonte se shpirti i njeriut, i mirë ose i keq vendin e ka në një terr të mundimshëm, e cila nuk ngushëllonte, nuk ofronte optimizëm etj. Dhe erdhi një kohë kur shtresa aristokrate ra në luks, zdërrhallje, zbavitje të pakufishme dhe devijim. Në mesin e popullit hyri dyshimi. Çdokush shikonte se si të dëfrehet sa më shumë. Thuhet se Nebushadnezarin, pasi që vite të tëra sundoi në fitore dhe bollëk, pasi që qytetin e zbukuroi me rrugë dhe sara-je, pasi që ndërtoi 54 tempuj që ua kushtoi zotave, e kaploi një çmenduri e çuditshme. Nebushadnezari kishte çdo gjë, por nuk mundte t'i japë kuptim jetës dhe frikohej nga çdo gjë.

Tridhjetë vjet pas vdekjes së tij, perandoria u shkatërrua nga ana e persianëve. Mbreti Nabonidus, më tepër e simpatizonte arkeologjinë sesa të udhëhequrit me shtetin. Kështu derisa vendi i tij shkatërrohej, ai bënte mihjen e veprave të vjetra të sumerasve. Në ushtri mbretëronte mosdisiplina. Afaristët ishin magjepsur nga financat ndërkombëtare dhe kështu e kishin harruar atdhedashurinë. Populli i cili ishte dhënë pas tregtisë dhe epsheve, e kishte harruar artin e luftës. Priftërinjtë kishin arritur që

të forcohen më tepër se mbretëria dhe në ndërkohë e kishin shtuar shumë pasurinë e vet. Kjo i bënte ftesë okupimit. Në vitin 539 para Isait (a.s.) Sirusi dhe ushtria e tij persiane e disiplinuar kur arriti para portës së qytetit nuk e pati rëndë të hyjë në të. Persianët duke ia shtuar Babiloninë perandorisë më të madhe të asaj kohe, e sunduan atë 200 vjet. Më vonë edhe Aleksandri (Leka) e pushtoi kryeqytetin i cili nuk tregoi kurrfarë rezistence. Pas kësaj, në Mesopotami nuk arriti më që të sundojë ndonjë popull vendas.

Egjiptasit nuk i kanë shikuar babilonasit me një sy qytetërues. Karakteri dhe subtiliteti i artit egjiptas nuk mund të gjendej në Babiloni. Pas fillimit të shkatërrimit, subtiliteti mori një pamje të degjenerimit me karakter femëror: burrat e rinj i ngjyroshnin flokët dhe i bënëin dredha-dredha, “i përmblytnin” trupat e vet në parfume, i lyenin faqet me të bardhë, bartnin gjerdanë, bilezikë, vathë etj. Pas pushtimit të qytetit nga ana e persianëve, te njerëzit u humb dinjiteti. Kjo ishte shkak që ata pa kurrfarë ngurrimi të jepen pas plotësimit të dëshirave të veta. Sjelljet e lavireve të pallatit në mënyrë suksese u përhapën te gratë e të gjitha shtresave. Babilonia, duke e lëshuar veten pas kënaqësive dhe epsheve, përgjithmonë e harroi qytetërimin dhe pavarësinë. Qytetërimi i cili në Mesopotami u krijua në saje të punës së bazuar në besim dhe solidaritet shoqëror, iu nënshtrua hegjemonisë së një grupi i cili mbështetej në eksploatimin e brendshëm dhe në pushtimet imperialiste. Pengjet e luftës ranë në status të robërve, ndërsa vendin e besimit dhe punës e zunë letargjia, papunësia, luksi, pompoziteti dhe azgënlleku seksual, gjëra këto që bazoheshin në kapitalin dhe robërit. Pasuria e tepërt e një grupi dhe robëria dhe vobektësia të cilat përhapeshin dita-ditës e shkatërruan solidaritetin shoqëror. Kështu erdhi deri te tronditja e

sistemit të besimit dhe moralit, e cila si rezultat e pati shkatërrimin ose fundin e një qytetërimi.

## Qytetërimi i Egjiptit

Në vitin 3100 para Isait (a.s.) mbreti Menes, në Vendin Jugor të quajtur Egjipti i Epërm dhe në Vendin Verior të quajtur Egjipti i Poshtëm e siguroi një unitet politik. Paralel me bashkimin politik edhe zotat lokalë u bashkuan në zotin Ra. Por mbreti, edhe zotat lokalë si ndihmës të Rasë, i bashkoi në tempullin e njëjtë. Në këtë mënyrë u penguan lëvizjet secesioniste që potencialisht mund të lindnin nga lidhshmëria ndaj besimeve lokale. Besimi në diellin, i cili veten e shfaqte në adhurimin e Rasë, arriti statusin e fesë zyrtare. Funkzioni i kësaj feje ishte dhurimi i pavdekshmërisë shtetit dhe popullit në tërësi. Autorizimi i zotit-mbret, faraonit, për të cilin besohej se ishte i biri i zotit të diellit, ishte i pakufishëm. Qytetërimi egjiptas me bashkimin e dy vendeve dhe krijimin e monarkisë, çështjen e politikës e zgjodhi ndryshe nga Mesopotamia. Në Egjiptin e vjetër qytetet nuk ishin njësi politike. Madje ky vend i unifikuar nuk e kishte as kryeqytetin e vet. Vendi ku faraoni e ndërtonte piramidën, respektivisht varrin e vet, përnjëherë u bë qendër. Bashkimi i dy vendeve perceptohej si lindje e një sistemi të determinuar në parakohë (*ezer*). Besimi në faraonin zot-mbret, mbi të cilin bazohej ky sistem, ndikonte jo vetëm në politikë, por edhe në letërsi, arkitekturë, art si dhe në punët tjera të ndryshme të përditshmërisë.

Piramidat, të cilat konsiderohen si njëra nga shtatë çudirat botërore, janë realizuar në korniza të një besimi

që është pasqyruar në jetën shoqërore të Egjiptit. Supozohet se në ndërtimin e një piramide kanë marrë pjesë 70 mijë punëtorë. Në muajt verorë, kur Nili dilte prej shtratit të vet, bujqit meqë nuk kishin shumë punë, inkadroheshin si punëtorë në ndërtimin e piramidave. Por, një projekt gjigant siç është piramida, me mundësitë teknike të asaj kohe ishte e pamundur të ndërtohej për një ose dy vera. Kështu para se të vdiste faraoni që ishte në pushtet, fillohej ndërtimi i një piramidës së re. Kur kemi parasysh se gjatë një shekulli 25 milionë tonelata gurë janë shndërruar në piramida, vijmë në përfundim se duhet të jetë dhënë një mund shumë shumë i madh. Parashtrahet pyetja: Pse këta punëtorë e kanë dhënë gjithë këtë mund? Për ta nuk mund të thuhet se janë detyruar që të punojnë me dhunë, pa vullnetin e vet. Madje, në atë kohë në Egjipt nuk ekzistonte fenomeni i robërisë. Nuk mund të paramendohet që një grusht udhëheqësish t'i detyrojnë me mijëra veta të punojnë me vite të tëra pa dëshirën e vet. Shumë arkeologë dhe historianë janë të mendimit se këta njerëz në këtë punë i ka tubuar besimi. Punëtorët, të cilët janë munduar t'i ndërtojnë këto monumente gjigante në rërën e nxehtë, besonin se dhuntitë në jetën e tyre varen nga qetësia dhe kënaqësia e zotmbretërve. Nëse faraoni shkon në përjetësi në një formë të bukur dhe me grandiozitet, edhe jetët e tyre do të kalonin në paqe dhe bollëk. Sipas të gjitha gjasave ky është ai besim i cili te njerëzit e ka mbjellur sensin e bashkëpunimit mahnitës, ndjenjën e bashkësisë dhe suksesit të përbashkët. Zaten në gurë të ndryshëm të piramidave hasim në shenja që lexohen ose deshifrohen në trajtën "ekipi i fortë", "ekipi i qëndrueshëm". Besimi se zoti Osiris, i cili është përfytyruar si formë e personalizuar e fuqisë gjelbëruese të natyrës ose karakteristike jetëdhënëse e Nilit, në çdo vjeshtë vdes dhe në çdo pranverë ringjallet,



simbolizonte tharjen dhe ngritjen e nivelit të Nilit dhe vërshimin. Përtej kësaj, vdekja dhe ringjallja e Osirisit, llogaritej për shenjë që premtonte pavdekshmëri personale. Besimi naiv i cili jetën e ardhshme e paramendonte si vazhdimësi të jetës së njëjtë trupore të kësaj bote, më vonë përjetoj një evolucion. U shndërrua në besimin se i vdekuri do të gjykohej nga Osirisi sipas veprave që i ka bërë në këtë botë. Lindi koncepti i shpëtimit personal. Në fe, në vend të ritualeve të bazuara në pronë u theksua jeta morale. Veprat artistike si pikturat dhe reliefet, të cilat i njohim si “arti egjiptian”, nuk përgatiteshin për t’u ekspozuar, por konsideroheshin si pjesë përbërëse e jetës dhe besimit. Vizatimet dhe reliefet e bëra në muret e varrezave i përshkruanin veprat e mira të njeriut të vdekur dhe i dërgoheshin atij si dëshmitarë në gjykimin pas vdekjes. Skulpturat e faraonëve ishin me dimensione titanike, ndërsa madhështia e skulpturave, që rritej paralel me zgjerimin e perandorisë, ishte simbol i fuqisë absolute të faraonit.

Pas okupimit të Hiksosit [përafërsisht viti 1750 para Isait (a.s.)], në vitin 1560 me një kryengritje të suksesshme erdhi deri te pastrimi i pushtuesve dhe sovranitetin e morën sundimtarët egjiptas. Ushtria e madhe e formuar për dëbimin e hiksosëve u bë një pjesë e pandashme e fuqisë së faraonit. Ndjenja e atdhedashurisë e cila filloi me revoltë, si dhe lëvizjet ekspansioniste që u zhvilluan si masë mbrojtëse, në skenën shoqërore sollën disa ndryshime. Në Egjipt, banorët e të cilit në një tokë të pjellshme bashkëpunonin sikur bënin adhurim dhe të cilët me qëllim të jetës së rehatshme në tokën e vet pjellore ndiqnin një politikë pacifiste dhe izolacioniste, u shtua oreksi për fitore të reja. Shteti filloi të marrë një qëndrim imperialist. Edhe pse fusha e dominimit u zgjerua nga Siria dhe Palestina deri në jug të Nilit, prapëseprapë te

popullata nën hijen e këtij shteti nuk u zhvillua ndjenja e besnikërisë ndaj perandorisë në fjalë. Pasuria që rrodhi në Egjipt nga vendet e çliruara e minoi zellin për punë të popullatës dhe në udhëheqjen shtetërore u paraqit një degradim moral. Në ndërkohë faraonët me kujdes të madh ndërtonin ndërtesa të shenjta madhështore. Tempulli i madh i Karnaktutit në Tebes, si dhe gurët e mëdhenj të ngjitur në tokë - që sot gjenden në Stamboll, Romë, Londër dhe Nju Jork - ishin shenja që e shenjtëronin këtë jetë pompoze.

Amonhotepi IV, i cili njihet si i butë dhe emocional, kur erdhi në pushtet [viti 1380 para Isait (a.s.)] akoma ishte në fazën e adoleshencës. Amonhotepi IV, që erdhi në pushtet pas të jatit të vet (Amonhotepit III, i cili ishte i dhënë pas kënaqësive të kësaj bote), zgjodhi një stil jetësor të thjeshtë. Ishte tepër i revoltuar nga fakti se feja ishte shndërruar në magji, priftërinjtë në magjistarë, kurse jetën shoqërore-politike e kishte kapluar konfuzioni. Ai dëshironte ta thejë autoritetin e priftërinjve, ta evitojë eksploatimin në sferë të fesë dhe të krijojë një stil jetësor të rëndomtë që do të bazohej në punë me drejtësi. Kështu nga tempujt i dëboi priftërinjtë, ndërsa emrat e zotave tradicionalë i fshiu nga përmendoret dhe shpalli se do adhurohet vetëm një zot, Atoni. Pastaj e ndërroi edhe emrin e vet nga Amonhotep IV në Akhenaton. Në art solli realizëm, andaj bustet e veta i ndërtoi me madhësi reale. Duke theksuar se Atoni është themelues i sistemit moral të botës dhe se për pastërtinë e zemrës do të jepen shpërblime, në plan të parë prapë e nxori dimensionin moral të fesë egjiptase. Proklamoi se Atoni, të cilin e përfytyronte se gjendet në burimin e jetës dhe dritës - në diell, në mënyrë të barabartë është zoti i të gjithë popujve dhe se mirësinë e shpague me mirësi. Akhenatoni, ishte aq i ri dhe i papërvojë, saqë nuk kishte

durim që vizioni i tij bashkues i njerëzimit dhe i rëndomtë/pastrues i fesë dalëngadalë të depërtojë dhe të vendoset në zemrat e njerëzve. Kështu dëshiroi që gjithçka të ndryshojë menjëherë; e përçmoi fuqinë e priftërinjve dhe besoi tepër se populli e ka aftësinë për ta kuptuar fenë abstrakte. Përderisa priftërinjtë në prapaskenë përgatisnin planet e veta, populli vazhdoi që në shtëpitë e veta t'i adhurojë edhe më tutje zotat e mëparshëm, por shumë zanatçinj, puna e të cilëve ishte e lidhur me tempujt, filluan që fshehtaz të folin kundër faraonit i cili kishte devijuar nga feja. Bile edhe funksionarët dhe gjeneralët e pallatit të vet filluan ta urrejnë atë nën pretekstin se e ka çuar në shkatërrim vendin. Nga Siria filluan të vijnë mesazhe alarmante. Hititët dhe etnitetet tjera fqinje filluan që t'i pushtojnë kolonitë egjiptase në Lindjen e Afërme. Akhanetoni ishte i pavendosur nëse këto shtete duhet të mbahen të lidhura me Egjiptin ose jo. Për të plotësuar kërkesën e guvernatorëve egjiptas, nuk dëshironte që egjiptasit t'i dërgojë në troje të largëta si ato. Kolonitë, kur kuptuan se nuk kanë përballë ndonjë perandor por shenjtor, i spostuan guvernatorët, e ndërprejnë dërgimin e tagrave dhe *de facto* u pavarësuan. Kështu një perandori aq e madhe përnjëherë u tkurr dhe u shndërrua në një shtet të vogël. Financat shtetërore, si pasojë e mosdërgimit të haraçeve me të cilat ishin ushqyer më tepër se 100 vite, falimentuan. Në brendi administrata zaten ishte zhbërë. Të gjithë ishin bashkuar kundër Akhenatonit dhe e prisnin rënien e tij. Akhanetoi vdiq në vitin 1362 para Isait (a.s.) kur akoma nuk i kishte mbushur as tridhjetë vjet.

Kryengritjet e njëpasnjëshme e kishin konsumuar fuqinë e shtetit dhe në fillim të shekullit XII para Isait (a.s.) të gjitha vendet e pushtuara dolën dorësh. Në fund të shekullit, Egjipti u bë shënjestër e sulmeve të popujve barbarë. U humb potenciali që sukseseve të mëparshme

të qytetërimit egjiptas në sferën e astronomisë, matematikës, teknologjisë dhe artit, t'u shtohen suksese të reja. Tani pavdekshmëria nuk fitohej me punë dhe vepra të mira. Për të arritur një gjë të tillë (pavdekshmërinë) të gjithë u referoheshin operacioneve të magjisë. Në kushte të këtilla forcimi i pozitive të priftërinjëve ishte gjë e pashmangshme. Priftërit e forcuar, grabitën shumë nga autorizimet e mbretit dhe duke përdorë forcë filluan t'i detyrojnë njerëzit t'i aplikojnë fermanet e faraonit. Shkatërrimi u përshpejtua. Okupimet vinin një pas një. Egjipti, i cili pas dominimit të asirianëve (të cilët e kishin pushtuar këtë vend në vitin 671) një kohë të caktuar mbeti si i pavarur, hyri në një periudhë të ringjalljes tradicionale. Por ç'e do që nuk arriti t'i bëjë ballë okupimit nga ana e persianëve [viti 525 para Isait (a.s.)]. Në vitin 332 para Isait (a.s.) Aleksandri, Egjiptin e bëri pjesë të Maqedonisë. Në vitin 48 para Isait (a.s.) erdhi Cezari dhe e pushtoi kryeqytetin e ri të Egjiptit, Aleksandrinë. Në vitin 30 para Isait (a.s.) Egjipti u bë pjesë e Perandorisë Romake dhe u humb nga skena e historisë.

## Qytetërimi grek

Në Mesopotami dhe Egjipt populli ishte në shërbimin e zotave, kurse në Greqi njerëzit i imitonin zotat. Zotat, përfytyroheshin si forca në formë të njeriut që udhëhiqnin me dukuritë natyrore dhe ndërhnin në punët e njerëzve. Zotat mund t'u ndihmonin njerëzve në kapërcimin e problemeve lidhur me ngjarjet natyrore dhe të kryenin me sukses punë të caktuara. Për këtë arsye njerëzit duhej të kishin marrëdhënie të mira me ta (zotat). Besohej se njeriu mund t'i bënte për vete ose t'i afronte zotat me anë të ritualeve, lutjeve dhe sakrificave. Zotat ishin qenie madhështore sikur njerëzit, por shumë më superiorë se ata. Ishin të përsosur në aspekt të fuqisë, bukurisë, mendjes, utrisë, shkathtësisë dhe trimërisë. Përderisa njerëzit ishin të vdekshëm, zotat as plakeshin e as vdisnin. Rrëfimet mitologjike nga kohët më të vjetra në lidhje me jetën e zotave i gjejmë në epet e Homerit [shek. VIII para Isait (a.s.)] me tituj *Iliada* dhe *Odiseja*. Zotat ishin sikur njerëzit jo vetëm në formë por edhe në ndjenja dhe sjellje. Gëzoheshin, kënaqeshin, xhelozonin, hidhëroheshin, hakmirreshin, bënin hile, luftonin, përjetonin aventura heroike etj. Grekët e parë as i donin e as u frikoheshin zotave. Ata e ndjenin madhësinë e tyre, fascinoheshin, mahniteshin nga ta, por nuk ndjenin frikë prej tyre. Madje dëshironin "të jenë si Zoti", t'i përngjajnë atij. E dinin se një gjë e tillë është e pamundshme, por besonin se në këtë rrugë duhet dhënë mund. Ishin

zotat ata që njerëzve u jepnin aftësi dhe kapacitete. Njeriu duhet të bënte çmos që deri në pikë të fundit t'i zhvillojë kapacitetet e veta. Sipas tyre, njeriu duke u përpjekur mund të lartësohej dhe t'u afrohej zotave. Për këtë arsye duke u orvatur në mënyrë heroike, me vepra duhej ta tregojë veten dhe të fitojë nder. Duhej që duke i përdorë deri në fund kapacitetet e veta trupore dhe mendore ta arrijë nderin. Në këtë kontekst, kryerja e punës në formën më të mirë ishte një dëshirë e flaktë. Në fenë greke nuk ekzistonte koncepti "mirësi". Grekët antikë nuk dinin se ç'është favori, mëshira dhe falja. Zotat gjithë atë që e bënin, e bënin për hir të nderit, dinjitetit dhe demonstrimit të fuqisë. Ishin të fortë në përputhshmëri me funksionet, d.m.th. ishin "të mirë" në punët e veta. Mirësia, tek grekët të cilët i imitonin zotat, kuptohej si kualitet, superioritet dhe përsosmëri në kryerjen e një pune të caktuar. Të thënë një njeriu "i mirë", e kishte kuptimin se i njëjti këtë ose atë punë e kryente mirë ose me sukses. Te grekët njeriu ishte luftëtar i mirë, mbret i mirë, vrapues (atlet) i mirë, artist i mirë etj. Te Homeri nuk haset ideja për të qenët e njeriut i mirë si "njeri". Në syrin e tij njeri i mirë ishte ai i cili i kishte këto cilësi: trimërinë, fuqinë, qëndrueshmërinë, bukurinë, skathtësinë, mençurinë etj.

Grekët nuk merreshin me çështjen e jetës së pasvdekjes. Edhe pse tek ata ekzistonte mendimi se pas vdekjes së trupit mbetet një gjë si fantazmë (ang. *ghost*, tr. *hayalet*) dhe se ajo gjë hyn nën errësirën e nëntokës, pra-pëseprapë nuk ekzistonte mendimi për parajsën ose ferrin. Te ata nuk ekzistonte as koncepti i sevapit ose gjynahut, e as i shpërblimit ose ndëshkimit pas vdekjes. I tërë interesi ishte i orientuar kah jeta e kësaj bote. Synimi ishte ky: kryerja e veprave heroike me anë të aftësive që zotat ia kanë dhënë njeriut me lindjen. Vlera e jetës nuk shikohej në arritjen e lumturisë dhe kënaqësisë, por në

fitimin e nderit. Për këtë arsye grekët antikë nuk iknin nga rreziqet, por përkundrazi kërkonin rreziqe. Kjo ndodhte për arsye se heroizmi mund të tregohej vetëm në raste të rreziqeve. Vdekja ishte pika kulmore ku trimi e realizonte vetveten. Individidi duke e përçmuar vdekjen dhe duke e flijuar vetveten, e argumentonte vlerën e vet dhe lartësohej në sytë e njerëzve përreth. Esenca e këtij botëkuptimi ishte në të menduarit jo të vetvetes, por të të tjerëve. Sepse, kur njeriu e flijon vetveten duke bërë një vepër trimërore, nuk mund t'i mbledhë frytet e saj (veprës trimërore). Dobia e veprës së trimit/heroit është për familjen, shokët dhe atdheun. Forca e vërtetë shtytëse pas veprës ose aksionit është tregimi i vetvetes dhe dëshira për të qenë më i lartë se të tjerët. Si përfundim, e njëjta kishte funksion shoqëror. Në shekullin e trimërisë, për të cilin flet Homeri, vlera e individit nuk mund të paramendohej e ndarë nga shërbimi shoqërisë.

Në shek. VIII para Isait (a.s.) jashtë shoqërive fshatare filluan të paraqiten vendbanimet qytetare dhe qytetet-shtete. Pas kësaj, morali i periudhës heroike filloi t'i përshtatet moralit qytetar-civilizues të qytetet-shtet. Në sferë të udhëheqjes me qytetin-shtet të quajtur *polis* në plan të parë doli jeta politike. Qytet-shtetet më të rëndësishme ishin Athina, Sparta, Tebesi dhe Korinti, në bregdetin e Anadollisë - Miletin dhe në ishujt e detit Egje - Naksosi dhe Samosi. Lindjen e qyteteve e shoqëruan dy ngjarje. Përderisa jeta shoqërore në rrëfimet e Homerit në tërësi sillej rreth bujqësisë dhe blegtorisë, një çik më vonë u ngjall tregtia dhe erdhi deri te zbulimi i alfabetit grek. Alfabeti grek pasi që bazohej në fonetikën fenikase dhe përpos kësaj përmbante edhe zanore që nuk i ka alfabeti fenikas ishte shumë i lehtë për t'u mësuar. Për pasojë i njëjti nuk mbeti në monopolin e priftërinjve në korniza të tempujve, siç kishte ndodhur më parë në

Mesopotami dhe në Egjipt. Përhapja e shkrim-leximit si rezultat pati përdorimin e shkrimit si mjet regjistruar, përdorimin e tij në tregti dhe në sistemet bujqësore. E gjithë kjo ndikoi që punët e ekonomisë të rregullohen dhe të përparojnë. Prosperiteti dhe numri i popullatës në rritje shkaktuan lindjen e lëvizjeve kolonizuese. Besimi i grekëve në aftësitë dhe dëshira e tyre për liri patën për pasojë pavarësimin e kolonive si njësi politike. Grekët antikë polisit e kanë konsideruar si njësi më të madhe dhe ideale. Për këtë arsye, ndërmjet poliseve të ndryshme edhe pse kishte lidhshmëri reciproke në aspekt të gjuhës, kulturës dhe zotave, nuk mungonin luftërat.

Athina ndërmjet viteve 750-600 para Isait (a.s.) është sunduar nga aristokracia, e cila bazohej në trashëgimi. Aristokratët pretendonin se pozicionet që i kishin ishin dhuratë e Zotit dhe për këtë arsye ishin "të mirë". Siç u cek edhe më parë, të qenët "i mirë" nuk ishte një koncept i moralit, por një cilësi e cila potenconte të drejtën e aristokratëve për të qenë në postet udhëheqëse. Të qenët "i mirë" nuk ishte një virtyt moral, por social. Njeriu dinjitoz duhej t'i përdorë aftësitë e veta dhe ta fitojë lavdërimin e popullit.

Me zhvillimin e tregtisë rrushi dhe ullinjte filluan të fitojnë vlerë më të madhe sesa drithërat dhe si rezultat i kësaj ishte formimi i një burimi të ri të pasurisë. Personat që nuk investonin në sferën e vreshtave dhe kopshëve, ranë në statusin e varfanjakëve. Bujqit që nuk arrinin t'i paguanin borxhet e veta, binin në pozitë të gjysmërobërisë, për ç'arsye erdhën deri në pikën e shprehjes së revoltit. Aristokratët udhëheqës, të cilët "e nuhatën" këtë, me qëllim të parandalimit të një lufte të klasave, Solonit, një tregtari të njohur me pjekurinë dhe drejtësinë e vet, i dhanë autorizime të jashtëzakonshme dhe kërkuan prej tij që të gjente rrugëdalje. Soloni i shpëtoi



bujqit duke ua fshirë borxhet. Me një akt të ri që e inauguroi në sistemin e ri të qeverisë, ai bëri zbutjen e pasanikëve. Në vend të sistemit pushtetar të bazuar në trashëgimi, ai e aprovoi sistemin e bazuar në pasuri. Ai e shpalli ligjin me të cilin e pengonte vënien hipotekë mbi trupin e të varfërit që nuk ka arritur ta paguajë borxhin dhe shitjen e tij si rob. Përveç kësaj, e shpalli edhe një rregull demokratik: Prej atij momenti madje edhe të varfërit kanë të drejtë të vetos në kuvendin e përgjithshëm të qytetarëve. Themelimi i sistemit demokratik ndodhi pas disa çekuilibre me politike dhe përvojave nga pushtetet despotike, gjegjësisht në kohën e Klistenesit, një aristokrati dhelpërak, i cili erdhi në pushtet në vitin 507 para Isait (a.s.) duke e siguruar mbështetjen e shtresave të ulëta shoqërore. Klistenesi e promovoi sistemin zgjedhor sipas rajoneve gjeografike dhe dha mundësinë që për postet më të rëndësishme shtetërore të kandidohen njerëz nga masat popullore. Në këtë mënyrë ai arriti të krijojë një atmosferë ku çdo qytetar do të jetë pjesëmarrës në pushtetin e Athinës. Në trajtën e mëvonshme të zhvillimit të sistemit, të gjithë qytetarët ishin anëtarë të kuvendit. Nga aspekti i të qenët praktik dhe frytdhënësisë, një këshill prej 400 anëtarëve, të cilët janë ndryshuar sipas radhës, i ka përgatitur projektet dhe planet ekzekutive dhe të njëjtat ia ka ofruar votimit në kuvendin e përgjithshëm. Në kohën e Periklit vetëdija qytetare dhe kultura e demokracisë aq shumë ishin zhvilluar, sa që me përjashtim të disa posteve që kërkonin profesionalizëm si komanda ushtarake dhe marina (ku postet fitoheshin me zgjedhje), në të gjitha postet tjera shtetërore njerëzit caktoheshin me short. Parimisht të gjithë qytetarët konsideroheshin të aftë për të kryer funksione publike.

Por, qëndrimet dominante të asaj kohe, demokracisë së Athinës i jepnin një pamje që dallon nga të kuptuarit e

demokracisë në kohën aktuale. Kështu gratë, qytetarët prindërit e të cilëve nuk ishin athinas dhe robërit, nuk kishin të drejtë pjesëmarrjeje në pushtet. D.m.th. 3/4 e popullatës së moshës madhore mbeteshin jashtë demokracisë. Grekët antikë të cilët i imitonin zotat dhe si individë kishin besuar në vlerën e vet, popujt tjerë i konsideronin barbarë dhe nuk i vlerësonin si njerëz me plotkuptimin e fjalës, ndërsa pengjet e luftës i shfrytëzonin si robër. Në shoqërinë greke institucioni i robërisë ishte shumë i përhapur dhe ishte bërë pjesë e pandashme e strukturës shoqërore. Punët e shtëpisë, punët e rënda në sferë të bujqësisë dhe prodhimit "industrial" në përgjithësi i kryenin robërit. Për këtë arsye, qytetarët e lirë me lehtësi participonin në jetën shoqëro-politike. Konform një qëndrimi të kohës së trimërisë kur forca trupore dhe trimëria llogariteshin virtyte më të larta, gratë nuk kishin vend në jetën shoqërore dhe gruaja nuk çmohej përtej rolit të saj në familje. Për këtë arsye mund të shprehemi se thuajse nuk kishte jetë familjare ku merrte pjesë edhe burri. Burri athinas tërë kohën e kalonte në shoqëri me shokët, kurse shtëpinë e shfrytëzonte si një hotel ku ai vinte të flejë. Fëmija pas kryerjes së shkollës, edukatën esenciale e merrte duke marrë pjesë nëpër aktivitetet e ndryshme të jetës së qytetit. Si një i ri, i dëgjonte polemikat në kuvend, shihte interpretimin dhe aplikimin e ligjeve nga ana e jurive, shikonte tragjedi dhe komedi nëpër teatre etj. Në lojërat olimpike ishte dëshmitar i zbatimit të sporteve të ndryshme, i ekspozimit të kulturës greke, merrte pjesë nëpër festivale të ndryshme e kështu me radhë. I riu athinas pra, mësonte duke jetuar. Individidi pasi që e provonte veten para zyrtarëve shtetërorë se fizikisht dhe shpirtërisht e meriton të jetë qytetar i polisit, jepte betimin e besnikërisë në këtë formë: "Armëve tona të shenjta nuk do t'u vë njollë, shokun afër meje, pa marrë

parasysh se kush është ai, nuk do ta braktis. Për hir të tempujve dhe ligjeve tona do të luftoj individualisht dhe kolektivisht. Vëndin tim do ta lë në një gjendje më të mirë e jo më të keqe. Çdoherë do t'u nënshtrohem gjykatësve dhe sistemit dhe nuk do të jem i kënaqur nëse dikush tjetër ngrihet kundër tyre. Do ta mbroj dinjitetin e fesë sonë. Le të jenë zotat dëshmitarë!" Më pastaj individi dy vjet e kryente ushtrinë dhe në rajonet kufitare kalonte nëpër disiplinën më të ashpër ushtarake. Kur vinte në moshën njëzetvjeçare, merrte poste të caktuara në parlament nëpër juri dhe me plotkuptimin e fjalës merrte pjesë në jetën qytetare. Pjesën më të madhe të kohës e kalonte nën qiell të hapur në marrëdhënie shoqërore edhe shumë rrallë vinte në shtëpi.

Bindja se aftësitë njerëzore vijnë nga zotat dhe imitimi i tyre (zotave), në Athinë ishin burimi i idesë për vlerën dhe lirinë e individit. Athinasi i cili u besonte aftësisë të veta dhe mundësisë për zhvillimin e tyre nuk mund të paramendonte që t'i nënshtrohej një despoti. Ai merrte pjesë në udhëheqjen e qytetit dhe mburrej me të (qytetin). Lirinë nuk e shihte jashtë ligjeve, por përkundrazi ligjet i shihte si garancë të lirisë. Nuk kanë qenë grekët të parët ata që e kanë dhënë idenë për ligjet dhe që i kanë përpiluar ligjet e para, por nënshttrimi ligjeve të përpiluara vetë, e jo atyre të përpiluara nga populli, zotat ose despoti (siç ndodhte në Mesopotami ose Egjipt), është një fenomen që për herë të parë vërehet në Athinë. Perikli shprehej kështu: "Jeta jonë private është përplot tolerancë, kurse në jetën publike dominon respekti ndaj ligjit. Ne e ndjekim udhëheqjen (udhëheqësinë) që vetë e kemi zgjedhur". Besimi në përsosurinë e zotave, grekëve, të cilët i imitonin ata (zotat), ua siguronte energjinë e arritjes së përsosurisë. Skulpturat e zotave, fuqinë e zotave, bukurinë dhe madhështinë e tyre e shndërronin në

konkretshmëri, kurse artisti që u jepte formë atyre, simbolizonte arritjen e idealit të përsosurisë. Tempujt e Athinës, nga të cilët më i madhi ka qenë Parthenoni, si dhe veprat tjera arkitektonike, mund të vlerësohen në këtë kontekst. Arritja e përkryerjes dhe provimi (tregimi) i vetvetes ka qenë një pasion i atillë, saqë bile edhe forma e një gjëje të thjeshtë si vazoja e përdorur në jetën e përditshme dhe vizatimet mbi të dhe reliefet mbi monedhat i shfaqnin frytet fantastike të këtij pasioni. Njeriu, në tragjeditë greke, të cilat tregojnë marrëdhënie midis njerëzve dhe zotave, fatin të cilin ia kanë përgatitur zotat e realizon me veprat dhe aksionet e veta. Tragjedia nuk është një "katastrofë" që i vjen njeriut, por një përfundim i dhimbshëm të cilin njeriu "e ka zgjedhur me veprën, apo aksionin e vet". Njeriu ishte i lirë, por përtej fuqive të dukshme ekzistonin edhe fuqi të padukshme.

Një lidhshmëri e fortë ndjehej ndërmjet besimit në zota dhe idesë se gjithësia nuk është një kaos por rend. Përpjekja për ta kuptuar këtë rend donte të thoshte përpjekje për t'i kuptuar sekretet e zotave. Mitologjitë e periudhave kohore të vjetra e shpjegonin botën brenda së cilës jetonin njerëzit, kurse tash me të njëjtin qëllim bëheshin vrojtime dhe arsyetime në një nivel më racional. Filozofia e natyrës e cila konsiderohet zanafillë e mendimit shkencor, ashtu si ne sot e kuptojmë atë (mendimin shkencor), lindi nga një orientim i këtillë shpirtëror.

Megjithatë sukseset kulturore të qytetërimit grek nuk e shuajtën shpirtin militar. Edhe më parë u cek se në konceptin e virtytit të trashëguar nga periudha heroike parahomeriane në plan të parë kanë qenë fuqia dhe trimëria. Ky koncept i virtytit bashkohej me një lidhshmëri të vetëdijshme ndaj qytetërimit të polisit dhe kështu pasioni për ta mbrojtur polisën bëhej cilësia më specifike e qytetarit të Athinës. Instikti i kohës së vjetër

për vërtetimin e vlerës me anë të heroizmave të mëdha ishte shndërruar në pasionin për "të luftuarit për Athinën". Ky pasion, ashtu e kaplonte vetëdijen e qytetarisë, saqë shkrimtari i njohur i tragjeditë, Eskili (Aiskhylosi), në epitafin e vet (sipas të gjitha gjasave të shkruar nga vetë ai), asgjë nuk ka përmendur për tragjeditë dhe ka potencuar se ai që pushon në atë varr është një person që ka marrë pjesë në Luftën e Persisë.

Lufta e Persisë, me të cilën Eskili krenohet se ka qenë pjesëmarrës dhe të cilën e sheh si një ngjarje historike të cilën ua përkujton brezave të ardhshëm, për Athinën dhe qytetërimin grek, të cilin ajo e përfaqëson, paraqet një pikë kthese. Persianët pasi që në vitin 539 para Isait (a.s.) e pushtuan Babiloninë, arritën të dominojnë edhe me tërë Azinë e Vogël. Persianëve iu bashkuan edhe poliset e Jonisë të cilët kanë dhënë kontribut të çmuar në sferën e matematikës dhe filozofisë së natyrës. Duke filluar me vitin 500 para Isait (a.s.), jonasve të cilët kohë pas kohe kanë bërë kryengritje, Athina u ka dërguar ndihmë nga deti, e më vonë pasi që pa se nuk u arrit sukses, (jonasit) ia la fatit. Por, kur u kuptua se mbreti persian mëtonte ta pushtojë tërë Greqinë, Athina e siguroi mbështetjen e poliseve të Greqisë kontinentale dhe ishujve të Egjeut dhe lidhi kontratë me Spartën. E para nga dy fushatat e Luftës së Persisë ndodhi nga deti, në vitin 490 para Isait (a.s.). Në përleshjen e Maratonit ushtria persiane pësoi disfatë. Kur mbreti i Persisë duke menduar se do të jetë e nevojshme një fushatë më e madhe ushtarake, në vitin 480 me këmbësinë e vet iu afrua Athinës, athinasit duke u tërhequr prapa u detyruan ta shikojnë qytetin e tyre se si digjej. Por me ndihmën e Spartës dhe aleatëve tjerë, athinasit së pari në ballafaqimin detar në Salamis (viti 480) e më vonë në atë këmbësinë në Platea, treguan rezistencë heroike kundër persianëve

dhe si përfundim persianët nuk gjetën rrugëdalje tjetër pos që të tërhiqen dhe t'ua mbathin këmbëve.

Ja pra, kjo fitore e cila paraqet pikën vendimtare të qytetërimit grek, në një trajtë paradoksale i gjeneroi ndryshimet që e shuan këtë qytetërim të shkëlqyer. Athina, me qëllim të mbrojtjes së idealit helen për liri kundër despotizmit persian dhe shpëtimit të qyteteve të Azisë së Vogël, projektoi një konfederatë të forcave detare.

Por, Sparta e cila ishte një fuqi tokësore (e këmbësorisë), nuk tregoi interes për konfederatën në fjalë. Megjithatë polisët tjera greke treguan gatishmëri participimi në të dhe në vitin 478 para Isait (a.s.) konfederata u themelua. Secili shtet premtoi se çdo vjet do ta japë kontributin e vet në favor të konfederatës me numër të caktuar të anijeve dhe me sasi të parave. Ishulli Naksos, si pasojë e shumësisë së harxhimeve, në vitin 467 deshi të ndahet nga unioni, por Athina nuk i dha leje për një gjë të tillë dhe përmes një aksioni ushtarak e dënoi atë (Naksosin). Aty kah mesi i shekullit, kur shtetet e Azisë së vogël e fituan pavarësinë, konfederata e humbi qëllimin ose *raison d'être*-në e vet. Mu në atë kohë Athina, arkën e konfederatës, që gjendej në ishullin Delos, e transferoi në Athinë dhe me këtë dha sinjal se konfederata veç më ishte shndërruar në Perandorinë e Athinës.

Sparta, e cila me droje i ndiqte veprimet e Athinës, u frikua nga përhapja e hegjemonisë athinase në tërë Greqinë antike, për çka si pasojë midis këtyre dy fuqive filloi Lufta e Peloponezitetit e cila zgjati midis viteve 431-404 para Isait (a.s.). Në ndërkohë në jetën ekonomike dhe shoqërore të Athinës kishin ndodhur ndryshime të shumta. Athina, e cila duke u nisur nga krenaria e fitores kundër Persisë deshi të krijojë një hegjemoni, në kohën e konfederatës e zgjeroi horizontin e vet financiar dhe tregtar dhe filloi të marrë një karakter kozmopolit. Ndërmarrjet

e reja afariste sollën prosperitet dhe mundësi të pa-paramenduar deri në atë kohë për arritjen e kapitalit privat. Pasuria, shkaktoi shumëfishimin e interesave dhe dhënien pas kënaqësive të kësaj bote, ndërsa mbrojtja e kulturës dhe artit u trajtua si mjet i arritjes së prestigjit. Prej aty e këndeje kriter i madhështisë së personave nuk ishin vlerat e shërbimeve të bëra në favor të shtetit, por pasuria dhe fuqia. Shkathtësia politike veç më nuk mbetej e kufizuar me punët e kuvendit lokal, por gjente një fushë të re ku do ta shprehte veten në diplomacinë imperiale. Të rinjtë e pasionuar bënë gara në shfrytëzimin e çdo rasti për fitimin e fuqisë dhe famës personale.

Ideali i vjetër qytetar që e nxiste sakrifikimin e individit në sferën e shërbimeve publike kishte filluar të dobësohet. Kështu në plan të parë kishin filluar të dalin kërkimet e satisfaksionit personal në saje të pasurisë, famës dhe fuqisë. Idetë fetare dhe morale, të cilat e determinonin kuptimin dhe cakun e jetës, shikoheshin me dyshim. Të rinjtë athinas arritjen e superioritetit individual e shihnin përmes suksesit individual. Për ta plotësuar këtë dëshirë, nga kolonitë filluan të vijnë mësues-filozofë të quajtur *sofistë*. Sofistët e refuzonin autoritetin të cilin tradita e siguronte nga jashtë përmes familjes, zotave dhe shtetit, por veprave të njeriut u sillnin një autoritet të ri. Ky autoritet ishte vetë individi.

Protagora, njëri nga sofistët më të mirë, me thënien e vet "njeriu është kriteri i çdo gjëje" e shprehte thelbin e këtij ideali të ri. Veç më nuk pranohej ekzistenca e së vërtetës absolute dhe të pandryshueshme, ngase të vërtetës iu atribuua relativiteti që d.m.th. e vërteta ndryshonte sipas individit. Çdo individ duhej që qëndrimet dhe sjelljet e veta përballë shokëve, shoqërisë, shtetit etj. t'i determinonte sipas dëshirave dhe shpresave të veta. Sofistët, mendimtarët e parë profesionalë, të cilët diturinë dhe

urtësinë për kundërvlerë materiale (pará) ua mësonin atyre që dëshironin një gjë të tillë, nxënësit e vet i përgatitnin për një jetë aktive dhe të suksesshme, në veçanti në sferën e jetës politike dhe publike. Për këtë arsye çështja mbi të cilën më së tepërmi ndaleshin sofistët ishte zhvillimi i aftësisë së gojëtarisë dhe bindjes së njerëzve. Kësisoj, njerëzit filluan që më tepër t'i japin rëndësi bindjes së njerëzve se mendimi i një personi të caktuar është i saktë sesa studimit të së vërtetës së një çështjeje. Sipas pretendimit të Aristotelit, Protagora ishte bërë i famshëm me të garantuarit se "teza më e dobët mund ta ngadhënjë mbi më të fortën". Ky qëndrim, shkaktoi që sofistët - të cilët nuk ishin të vlefshëm sa Protagora, nxënësve të vet në vend të edukatës së demokracisë t'ua servojnë edukatën e demagogjisë. Sofistët, të cilët nga nxënësit e vet merrnin kundërvlerë materiale, ndërmjet vete nuk kishin marrëdhënie të kolegëve (siç ndodh te dijetarët), por ishin në pozicion të konkurrentëve. Kuptohet se, sofistët, të cilët në hapësirën e sundimit të demokracisë athinase me qëllim të arritjes së suksesit përmes rrugës më të shkurtë, të rinjve në vend të urtësisë ua mësonin shkathtësinë e polemikës dhe përdorimit të të tjerëve, e plotësonin një kërkesë të caktuar. Në politikën e Athinës, në konfuzionin ku vendin e idealit të shërbimit të shtetit e kishte marrë pasioni i ngritjes personale, shërbimi që e bënin sofistët ishte me vlerë të madhe. Gradualisht do të shihej se nëse nuk ekziston një e vërtetë e cila e lidh çdokënd dhe se nëse vendin e drejtësisë e marrin kapriçiot personale, është e pamundur të ruhet uniteti shoqëror dhe të mbahet në këmbë institucioni i shtetit.

Në periudhën prej vitit 445 deri në vitin 431 ka sunduar Perikli. Historianët këtë periudhë e cilësojnë si "shekulli i artë i qytetërimit grek". Por, shekulli i artë paraqet pikën kulmore të qytetërimit grek pas së cilës



vijon teposhtëza e tij. Energjia e ngjitjes në atë pikë (kulmore) burimin e kishte në inspirimin që vinte nga periudha e mëhershme kur besimi dhe morali publik ishin tepër të fortë. Perikli shprehej kështu: "Shenjat dhe dëshmitë që i lëmë pas nesh janë madhështore". Arkitektura, letërsia, filozofia dhe arti i periudhës së Periklit, për një kohë të caktuar e mbuluan dobësinë e karakterit, që ishte pasojë e ndryshimeve shoqërore dhe morale të fazës pas Luftës së Persisë. Por ç'e do që këto suksese kulturore nuk e ruajtën vazhdimësinë e vet. Athina, si pasojë e luftës së Peloponezit, e cila filloi në vitin 431 para Isait (a.s.) dhe rrethimit të këtij qyteti në vitin 404 nga ana spartanëve, që shkaktoi uri te qytetarët, u detyrua të dorëzohet. Sparta, duke u frikuar nga forcimi i shteteve të Tebesit dhe Korintit, të cilët do ta pengonin liderizmin e saj (Spartës), nuk e shkatërroi Athinën dhe nuk i keqtrajtoi qytetarët e saj. Kështu vetëm limani i Piresë u çarmatos, u bë përvetësimi i anijeve, ndërsa anijet, ndërtimi i të cilave nuk kishte mbaruar, u dogjën, kurse pozicionet militare mbrojtëse u shkatërruan. Tani Athina edhe në det edhe në tokë duhej të sillej sipas urdhërave të Spartë. Me këtë luftë mori fund hegjemonia e polisit imperial të Athinës. Athina në vitin 338 hyri nën ombrellën e pushtetit të Maqedonisë, kurse në vitin 146 nën atë të Romës.

Perikli, në fjalimin që e mbajti mbi varret e dëshmorëve të Luftës së Peloponezit një vit pas kësaj ngjarjeje pohoi se nuk kanë vdekur kot ata që kanë luftuar për idealin e lirisë dhe demokracisë. Por, për afërsisht pesëmbëdhjetë vjet pas vdekjes së Periklit (vdiq një vit pas luftës) si pasojë e kaplimit nga një sëmundje ngjitëse, lideri i ri i demosit të Athinës, i cili kishte luajtur rol të rëndësishëm gjatë luftës, Alkibiadesi, demokracinë e kishte cilësuar si "çmenduri të qartë". Athina ishte e gatshme ta

dëgjojë, edhe pse më vonë do ta zbresë nga fronti. Athina, në vend të fesë dhe moralit të vjetër kishte zhvilluar bindjen se "i forti është i drejtë - ka të drejtë". Qysh nga periudha e heroizmit ekzistonte ideali i të qenët i fortë. Por, esenciale ishte arritja deri te ai ideal në mënyrë të ndershme. Kurse tash, ata që i kishin zgurdulluar sytë për ta arritur fuqinë me çfarëdo metodash, nuk luftonin si paraardhësit për dinjitet dhe nder, por për status dhe post. Kur nuk synohej dinjiteti dhe nderi, njerëzit në vend që të sillen si dinjitozë dhe ndershmërisht, sjelljet e veta i maskonin me fjalë të bukura. Në kohërat e mëparshme me rëndësi ishte gjetja e së drejtës përmes diskutimeve serioze, kurse tash shkathtësi llogaritej tregimi i punëve më të poshtra (me anë të diskutimeve emocionale) si suksese të jashtëzakonshme. Në një ambient të këtillë politik lufta me Spartën zhvillohej paralel me një aventurë imperialiste. Athina, duke "vjellur" kanosje, i detyronte shtetet e paanshme që t'i bashkohen asaj. Athinën, e cila e kishte humbur misionin politik dhe ishte dobësuar nga ndasitë interne, brenda luftës së gjatë aleatët e braktisën dhe në vitin 404 para Isait (a.s.) ky qytet-shtet i famshëm e hëngri grushtin mbytës.

Mosardhja e Athinës në vete edhe një herë, lidhet me një faktor më me ndikim sesa disfata ushtarake, tronditja në besim dhe degradimi moral. Sokrati i cili në kohën kur filloi Lufta e Peloponezitet ishte në moshën 38 vjeçare, filozofinë e vet e mbështeste mbi moralin. Këtë e bënte për arsye se shoqëria kishte nevojë për një orientim të ri moral. Ky filozof, i cili përkundër mësimëve turpëruese të sofistëve, mendohej të gjejë parime të preara që do të jenë bazë e moralit. Meqë e pa se shoqëria ishte në degradim e sipër, burimin e moralit e kërkoi në ndërgjegje. Me anë të hulumtimeve të mundimshme përpiquej t'ua gjejë njerëzve të vërtetën ekzakte, për të cilën

ishite i bindur se ekziston te çdo individ. Duke lënë mënjane pyetjen se a është e mundur ose jo që ndërgjegjja, e cila është e hapur për ndikimet e ndryshme të çdokujt, të bëhet mbështetja e strukturës shoqërore, politikanët demokratë që ishin të pakënaqur nga hulumtimet dhe përpjekjet e tij, pesë vjet pas disfatës së Peloponezit, në vitin 399, Sokratin e gjykuan me vdekje.

Filozofia e moralit të nxënësit të Sokratit, Platonit, është mësimi mbi "idetë". Jeta e kësaj bote e cila varet nga ndjenjat është mashtruese. Për këtë arsye, Platoni, i cili nuk arriti të gjejë përgjigje ekzakte në subjektin e moralit, ishte i mendimit se ato që përkapen në këtë botë janë vetëm shembuj të mangët të "ideve", që janë esenciale dhe të vërteta. Atëherë pra, si arrijmë t'u japim kuptim koncepteve "drejtësi", "mirësi", "bukuri" etj? Kjo çështje Platonin e shpuri në përfytyrimin se shembulli i drejtësisë së pandotur me paqartësi duhet të gjendet jo në këtë botë, por në ndonjë botë tjetër. Një kohë kemi qenë të njohur me kuptimin thelbësor të asaj që Platoni e quan "forma e drejtësisë". Në këtë botë kemi lindur me një njohuri të caktuar të papërkufizuar të kësaj forme. Ja pra, ky është shkaku pse edhe pasi që ta zotërojmë konceptin e drejtësisë prapëseprapë nuk mund ta arrijmë njohurinë e mjaftueshme të tij. Për këtë arsye, kur me metodën e Sokratit e parashtrojmë pyetjen "Ç'është drejtësia?", përgjigje nuk mund të japim. Por, jeta e virtytshme, në jetën e ardhshme shpirtin do ta takojë me Idenë. Platoni, pasi që vërejti se jeta e virtytshme në shoqërinë e atëhershme konfuzë ishte një gjë shumë e zorshme, në dialogun me titull *Republika*, ku e trajton politikën, projektonte një sistem që bazohet në harmoninë dhe produktivitetin shoqëror, e jo në konceptet e lirisë dhe barazisë. Kuptohet se në këtë sistem shoqëror, bujku, zejтари, tregtari dhe natyrisht robërit do të merreshin me punët e

veta, kurse një grup mbrojtës prej elitës, nën kryeparësinë e filozofit-mbret do ta udhëhiqte shtetin. Pasi që filozofët do ta caktojnë vetëm atë që është më e drejtë, detyrë e çdo qytetari është respekti i vendimeve të marra nga ta. Kur Sokrati u dënua me vdekje, Platoni, e braktisi aspiratën për karrierë politike dhe i dëshpruar doli në udhëtim. Pasi që u kthye nga udhëtimi, të vërtetat që më parë i kishte perceptuar filloi t'i konsiderojë mashtruese dhe në planin e mendjes "krijoi" utopinë të cilën e konsideronte zgjidhje. Por ai nuk tha ndonjë fjalë rreth asaj se kush do t'i mbronte filozofët nga instiktet dhe pasionet e veta, gjëra këto nga të cilat nuk mund të shpëtojë asnjë njeri.

Këto filozofi aspak nuk ndikuan te populli. Filozofitë e formulara me anë të arsyes abstrakte nuk mund ta zinin vendin e sistemit të besimit dhe atij moral, të cilët e bashkonin shoqërinë, e caktonin synimin e saj dhe e jepnin energjinë shpirtërore për realizimin e atyre synimeve. Në çdo shoqëri mund të filozofohet, por struktura shoqërore nuk mund të formohet me filozofi.

## Qytetërimi romak

Sipas të dhënave arkeologjike, qyteti i Romës është themeluar aty kah viti 750 para Isait (a.s.), nga një bashkësi njerëzore që fliste latinisht, pjesëtarët e së cilës pas themelimit të qytetit në fjalë njihen me emrin *romakë*. Roma e cila shtrihet rreth lumit Tiber dhe ka një pozitë strategjike, pas një kohe të shkurtër arriti të dominojë me qytetet fqinje. Në shekullin VI para Isait (a.s.). Roma veç e kishte shpallur superioritetin e vet. Në fillim pushteti i Romës ishte monarkik. Ky pushtet nuk e synonte lirinë, por stabilitetin dhe eficiencën ushtarake. Sistemi politik i Romës mund të rezymohet si zbatim në përmasa shoqërore i sistemit familjar patriarkal. Mbreti në krye të masës, ishte në pozitë të kryetarit të familjes. Senati, i përbërë nga kryeparët e klaneve që formonin shoqërinë, në raste specifike mund të vinte veto në vendimet e mbretit. Aty rreth vitit 500 para Isait (a.s.) mbretëria u shndërrua në republikë. Në vend të mbretit u zgjodhën dy konsuj\* të cilët kishin të drejtë t'i bëjnë veto njëri-tjetrit. Me dhënien e kontrollit të financave Senatit, këtij institucioni iu shtua hapësira e autorizimit. Senati përbëhej prej aristokratëve. Më vonë, kundër aristokratëve të cilët emërtoheshin me nocionin *patriçinj* filluan ta ngrejnë zërin *plebët* shumicën e të cilëve e përbënin bujqit. Në këtë mënyrë plebët fituan shumë të drejta që nuk i kishin

---

\* it. *consul*: njëri nga dy kryetarët e shtetit të Romës që zgjedheshin çdo vit. (A.P.)

gëzuar më parë. Kuvendit ku depërtuan ata iu dha e drejta për shpikjen e ligjeve. Por, një gjë është më se e vërtetë - fuqinë e vërtetë në duart e veta gjithmonë e mbante Senati. Tendenca e romakëve për nënshtrim ndaj autoritetit aq ishte e fortë, sa që anëtarët e ri u shkrinë në konservatorizmin e anëtarëve të vjetër. Pos kësaj, fakti se udhëheqësit shtetërorë nuk merrnin paga, ishte barrierë që qytetarët e varfër të kërkojnë poste në byrokracinë shtetërore.

Pasi që edukata bazohej në përcjelljen e afiniteteve praktike nga i ati te fëmija përmes metodës së imitimit, shumica dërrmuese e popullatës nuk dinte shkrim-lexim. Zaten, në këtë shoqëri, preokupimet kryesore ishin bujqësia dhe arti luftarak. Fakti se deri në vitin 269 para Isait (a.s.) në administrimin e republikës nuk ka ekzistuar sistem monetar standard, është tregues i mirë se në jetën e romakëve të asaj periudhe tregtia nuk ka luajtur rol të rëndësishëm.

Në jetën shoqërore të Romës feja ka zënë një vend të çmuar. Zotat romakë, ndryshe nga ata grekë, nuk ishin në formë të njeriut edhe nuk zhvillonin një jetë shkel e shko të ngjashme me atë të njerëzve. Roli i fesë më tepër ishte politik. Zotat nuk përziheshin në marrëdhëniet ndërnjerëzore, por e mbronin shtetin nga armiq-të dhe e shtonin fuqinë dhe prosperitetin e shoqërisë. Romakët, për veprat e tyre të virtytshme nuk kërkonin shpërblime nga zotat e vet, por u luteshin atyre që t'u japin dhunti, furnizim të bollshëm familjes dhe shoqërisë në përgjithësi. Feja dhe atdhedashuria ishin pothuajse gjëra të njëjta. Virtytet kryesore që i njihnin romakët ishin trimëria, nderi, disiplina, respekti ndaj etërve (paraardhësve) dhe besnikëria ndaj atdheut dhe familjes. Qytetarët duhej të ishin të gatshëm që për të mirën e Republikës ta flijojnë jo vetëm jetën e vet por edhe anëtarët e familjes dhe shokët e tyre. Mahnitje të madhe te njerëzit

shkaktonte rasti kur ca konsuj i vritnin bijtë e vet për shkak të mosdisiplinës së tyre ushtarake. Rrënja e fjalëve latine *virtus* dhe *virtutis*, të çmuara nga sistemin moral i Romës, të cilat e përfaqësonin konceptin e virtytit, është fjala *vir* që do të thotë njeri ose mashkull i rritur ose i pjekur. Fjala *virtus*, në esencë kishte kuptimin e "nderit" dhe "fuqisë" dhe këto cilësi, virtyt në plotkuptimin e fjalës bëheshin vetëm atëherë kur formësoheshin në shërbimin shtetëror. Si pasojë e rëndësisë që i kushtohej shtetit dhe jetës publike, përveç fuqisë së pushtetit, bie në sy edhe përparimi që ishte shënuar në sferën e urbanizimit dhe shërbimeve komunale, në arkitekturë, inxhinieri dhe në sistemin e infrastrukturës.

Në vitin 264 para Isait (a.s.) Roma iu qas pushtimeve përmes rrugëve detare, gjegjësisht filloi të zhvillojë një politikë imperialiste. Në vitin 146 para Isait (a.s.) u pushtuan Kartagjena, Spanja, Maqedonia dhe me djegien e Korintit, poliset greke, përfshirë këtu edhe Athinën, iu nënshtruan Romës. Hegjemonia mesdhetare me vete solli një mori të ndryshimeve shoqëro-ekonomike. Si pasojë e ekspansionit, në Romë u sollën shumë njerëz me status të robërve. Me themelimin e sistemit të plantacioneve, në çifligjet e mëdha u punësuan më tepër se një milion robër. Rezultat i kësaj ishte rënia e çmimeve të drithit dhe fillimi i "përmbytjes" së bujqëve të vegjël.

Hapja detare ndikoi në zhvillimin e tregtisë dhe jetës financiare. Roma u ndikua nga stili jetësor i Greqisë dhe idetë e filozofëve. Mësuesit e ardhur nga Greqia në Romë themeluan shkolla ku u jepnin mësim special fëmijëve të familjeve të caktuara (që dëshironin një gjë të tillë). Pasuria që rrodhi nga vendet e pushtuara, shtresën e lartë e sollu në status të hiperpaskanikëve, gjë kjo që shkaktoi dhënien pas pasioneve. Pasojë e pashmangshme e kësaj të fundit ishte fleksibiliteti në fushën e disiplinës dhe rënia e

dëshirës për të punuar. Të rinjtë të ndikuar nga afetarizmi i mësuesve grekë dhe ideve të tyre individualiste filluan që familjen dhe shtetin t'i shohin si pengesa para kënaqjes së pasioneve të veta egoiste.

Populli duke u dhënë pas ritualeve të kulteve fetare pretencioze dhe misterioze filloi të kërkojë shpëtim individual, kurse shtesa e lartë filloi të zbavitet me filozofinë e Epikurit e cila në praktikë e ka kuptimin i indiferencës ndaj kësaj bote. Filozofia nuk e lindte mendimin filozofik, por duke mbjellë fara të skepsës vetëm e dobësonte besimin. Artdashuria e shtresës së lartë, e cila i kishte stolitur shtëpitë e veta me veprat artistike të transferuara nga Greqia, nuk kishte domethënie tjetër përtej snobizmit. Veprat artistike kishin ardhur, por pasi që nuk kishte ardhur shpirti i cili në kohën gjegjëse i kishte krijuar ato, merakun për art kishte marrë vetëm trajtë të afektit dhe nazeve.

Me shtimin e pasurisë dhe pakësimin e punës, vendin e gjellëve të rëndomta e morrën gjellët e rënda. Kështu para të majme harxhoheshin për blerjen e ushqimeve ekzotike. U krijua një gjendje e atillë që e detyroi Senatin të sjellë një ligj në lidhje me reduktimin e sasisë së parave që harxhoheshin nëpër gosti dhe për veshmbathje. Por, ç'e do kur ligjin të cilin nuk e respektuan vetë senatorët, nuk e respektoi as masa e gjerë popullore. Në ndërkohë u paraqit pasioni pas gjërave luksoze, pas margaritarëve dhe stolive të ndryshme dhe u shtua sasia e konsumimit të pijeve alkoolike. Kur u dëshirua që sjelljet e ashpra dhe të vrazhda të edukatës romake të zëvendësohen me subtilitet, ky subtilitet nuk shkoj përtej xhentilitetit efemin (të feminizuar). Pos kësaj, në Romë filloi të përhapet edhe tallasi i homoseksualizmit që kishte ardhur nga Greqia, si dhe u shtua prostitucioni. Në ndërkohë aspak nuk u pakësua elementi tiranian (zullumqaresk) i kulturës romake, por përkundrazi u ashpërsua.



Nëpër arena, që luftërat midis gladiatorëve të ishin sa më gjakatare, publiku jepte duartrokitje aq më emocionale dhe bërtiste si i tërbuar. Kur ndonjëri nga gladiatorët binte i lënduar përtokë, tjetri i cili ishte në pozitë të favorshme, e pyeste publikun t'ia falë jetën kundërshtarit ose t'ia ngulë armën në zemër. Në disa raste organizohehin përleshje midis kafshës së egër dhe gladiatorit, epilogu i së cilave ishte copëtimi i këtij të dytit. Kur arena bëhej tërë gjak, dyshemeja mbulohej me rërë dhe "shfaqja" vazhdonte. Në vendet e pushtuara nuk mungonte tirania. Historiani romak Takitus, me një ironi *sui generis*, në gojë të kryeparit të një fisi barbar, lidhur me *Pax Romana*-n (Paqen Romake-A.P.), e cila prezantohet si sukses për t'u krenuar, që është realizuar me anë të dhunës dhe presionit, i shpreh këto fjalë: "Krijojnë egërsi, e emrin ia vënë paqe".

Perandoria e romakëve, paraqet adaptacion të konceptit qytet-shtet në një regjion të gjerë ndërkontinental. Vendet e pushtuara me popullatën vendase nuk u bënë pjesë përbërëse e perandorisë. Romakët ato toka kaherë i kanë tratjuar si koloni të vetat dhe popullatën e tyre e kanë shikuar me sy prej të huaji. Nga ana tjetër, brenda shtetit romak numri i robërve sa vinte e rritej, andaj kohë pas kohe janë shënuar rebelime të tyre (të robërve). Pastaj u shtua numri i bujqve të patokë. Edhe pse u morën disa iniciativa për reforma agrare, të njëjtat u penguan nga intrigat politike dhe nga lufta e klasave. Në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të punës nuk bëhehin përpjekje tjera pos shtypjes së tyre duke përdorur forcë. Në vitin 44 para Isait (a.s.) kur vdiq Cezari, kufijtë e perandorisë përfshinin Francën e sotme, perëndimin e Azisë së Vogël, bregdetin perëndimor të Detit të Zi, Sirinë, Egjiptin dhe Afrikën verilindore. Por, tanimë kishte filluar kalbja prej brenda. Procesi i shkatërrimit të kësaj

perandorie si pasojë e themelit jo të shëndoshë të mekanizmit shtetëror do të zgjaste më shumë se jeta e plotë e shumë shteteve, por fundi tragjik gjithsesi se do të vinte.

Disa historianë, si shkaqe të shkatërrimit të perandorisë romake i tregojnë sulmet barbare nga veriu dhe kristianizmin. Kurse, e vërteta thotë se shoqërinë e pashkatërruar nga brenda faktorët e jashtëm nuk mund ta shkatërrojnë lehtë. Popujt barbarë, i kaploi dëshira për pushtimin e Romës vetëm pasi që u bindën se ky qytet-shtet është dobësuar në brendësi. Tani në skenë doli kristianizmi si ilaç kundër dukurive negative që kishin mbretëruar në Perandorinë Romake si varfëria, tirania, padrejtësia dhe amoraliteti.

Populli i lodhur nga luftërat që nuk kishin të sosur dhe i lëkundur nga tagrat që i merreshin me dhunë, nuk dëshironte ta sakrifikojë më veten për idealet e perandorisë. Në shekullin III pas Isait (a.s.) të gjithë njerëzit ishte shuar mendimi për të punuar në favor të popullit. Dallimet rajonale, paarsimimi dhe diferenca midis klasave shoqërore, që vinte duke u rritur, paraqisnin barriera përballë shpirtit të unitetit. Me të vërtetë pandjeshmëria dhe indolenca kishin arritur shkallën e kulminacionit, sa që kur erdh faza përfundimtare e zhdukjes së perandorisë nuk u dëgjua as një “tëk”.

Na duket se mirë u kuptua se në rrëfimet për themelimin dhe shkatërrimin e qytetërimit të Mesopotamisë, Egjiptit, Greqisë dhe Romës skenari është i njëjtë. Qytetërimet krijohen mbi një themel të sistemit të besimit dhe moralit, me një jetë të thjeshtë dhe punë permanente në kuadër të unitetit shoqëror dhe shkatërrohen si pasojë e ngritjes së instikteve dhe pasioneve individuale në kuadër të ekspansionit dhe shtimit të kapitalit dhe si pasojë e këputjes së lidhjes shoqërore midis shtresave me ndikim në qeveri dhe masave popullore që jetojnë në

varfëri. Në fazën kalimtare kah shkatërrimi dhe gjatë vetë shkatërrimit, ndikojnë shumë faktorë si ata politikë, ushtarakë dhe ekonomikë. Shkaku i mosevitimit të këtyre faktorëve dhe mosndërprerjes së destruksionit, por përkundrazi përshpejtimit të tij, është degradimi në sferë të sistemit të besimit dhe moralit. Shoqërisë i ka munguar energjia shpirtërore dhe uniteti shoqëror, elemente këto të duhura për evitimin e influencës së faktorëve negativë. Këtu qartë vërehet lidhshmëria ndërmjet qytetërimit, i cili është një sistem i besimit, moralit dhe kulturës: kur humbet qytetërimi, përëndojnë edhe veprat e mëdha kulturore, njerëzit hanë, pinë, shumohen, zbaviten dhe shkojnë prapa kah një primitivizëm i afërt me kufirin e jetës biologjike.



# KREU V



## Panorama e sotme dhe pamja e ardhmërisë

Shumica e qytetërimeve të vjetra e kanë humbur kompaktësinë dhe ndikueshmërinë e vet dhe ashtu janë shkatërruar dhe zhdukur. Disa pjesë nga trashëgimia e tyre përmes rrugëve indirekte, kanë depërtuar në strukturën e qytetërimeve të mëvonshme. Nga ana tjetër, disa qytetërime me rrënjë të moçme, si qytetërimi hindus, ai kinez dhe ai japonez, vazhdojnë ta ruajnë vitalitetin e vet. Por, këto qytetërime në botën e ndryshimeve të shkaktuara nga kushtet e reja politike dhe ekonomike, nuk tregojnë ndikim përtej të qenët mjete të satisfaksionit shpirtëror dhe të qenët shprehi sociale të pashmangshme. Qytetërimet e lartpërmendura janë të ngushtuara në rajone të caktuara gjeografike dhe në panoramën aktuale zënë vend si sisteme të besimit dhe mënyra jetese pa pretendime universale (gjithbotërore). Në panoramën aktuale në sy na bien dy qytetërime që shënojnë ngritje: qytetërimi islam dhe ai perëndimor.

Struktura politike dhe ekonomike e qytetërimit islam ka përjetuar një tronditje. Përskaj kësaj, fuqia e Islamit për të ndikuar te besimtarët edhe në kohën aktuale është shumë e madhe. Kurse, refleksioni i besimit në jetën shoqërore është dallgëzues. Por, burimin e këtij qytetërimi, Kur'anin Famëlart, e kemi para nesh pa humbur aspak dhe asgjë nga shenjtëria dhe vërtetësia e vet primordiale, ndërsa tradita (sunneti) e Muhammedit (a.s), si interpretim i moralit kur'anor dhe shembull konkret i tij, e

ruan statusin e vet të të qenët udhërrëfyes për të gjithë besimtarët. Aplikimi i vendimeve të Kur'anit Famëlart dhe traditës së Muhammedit (a.s.), është një çështje që ka të bëjë me presionin nga kushtet e ndryshuara politike, ekonomike dhe shoqërore si dhe me dobësinë e muslimanëve në vrullin dhe vullnetin e tyre. Muslimanët, brendapërbrenda lëkundjeve që i ka sjellë rendi i ri botëror kanë rënë në pozitë të injorantit të fesë së vet dhe janë dhënë pas pamjeve që janë të largëta nga thelbi i fesë. Përsikaj të gjitha këtyre negativiteteve rrënja e Islamit është e gjallë. Kjo rrënjë në vete bart potencialin që në kushte të përshtatshme jep një trung fascinant, gjethe jeshile, lule të bukura dhe fruta tepër të lezetshme. Ja pra, edhe pse struktura politike dhe ekonomike e tij është e tronditur, fenomeni që Islamin e bën një qytetërim të gjallë, vital dhe që e sjellë atë në pozitë të konkurrentit më të madh të qytetërimt perëndimor, është gjallëria e kësaj rrënje dhe potenciali që e bart ajo. Qytetërimi islam, shumica e pjesëtarëve të të cilit jetojnë në Azi dhe Afrikë, është një qytetërim madhështor që përbën 1/6 e popullatës botërore.

Edhe pse të gjitha vendet që i përkasin qytetërimt perëndimor janë kristiane, ekzistojnë shkaqe racionale pse ky qytetërim nuk emërtohet me apelativin "qytetërimi kristian". Me të vërtetë, qytetërimi perëndimor nuk është qytetërim i pastër kristian. Përkatësit ose pjesëtarët e këtij qytetërimi, duke filluar me specialistët e ndryshëm, inteligjencia dhe udhëheqësit politikë, rrënjët e qytetërimt perëndimor i shohin në qytetërimin grek dhe në atë romak. Unë do të mundohem të tregoj se në këtë pikë kanë të drejtë. Qytetërimi perëndimor është aliazh ose përzierje me elemente tjera dhe sisteme të besimit dhe moralit të formuara gjatë një periudhe të gjatë kohore. Ky aliazh është një kompozicion i ri në plotkuptimin



e fjalës. Në këtë aliazh pas qytetërimit grek dhe atij romak është inkuadruar edhe kristianizmi. Kristianizmi i ka ngjeshur institucionet e shoqërive evropiane. Spiritualeteti i kësaj feje, i mbyllur nëpër manastire, në saje të zbulimeve gjeografike, përnjëherë ka shpërthyer në tërë botën me një sjellje arrogante dhe grykëse. Evenimentet si përvetësimi i resurseve të reja të lëndëve të para, eksploatimi i kolonive, fillimi i tregtisë me robër dhe hapja e rrugëve të reja tregtare jashtë hapësirës sunduese të Islamit, në Evropë e kanë shkaktuar ndryshimin e jetës së mbështetur në bujqësi dhe në artet manuale duke e dobësuar feudalizmin, ndërsa në qytet e kanë shkaktuar lindjen e një klase të re shoqërore të përbërë nga tregtarët, industrialistët, bankierët dhe zejtarët. Në ndërkohë, lëvizjet e Renesansës dhe Reformacionit i fshinë gjurmët e vulës së kristianizmit, aliazhit të qytetërimit të Evropës iu inkuadrua elementi i Humanizmit. Më vonë, Revolucioni Industrial duke e ndryshuar në mënyrë radikale strukturën ekonomike dhe shoqërore, e forcoi klasën borgjeze dhe përveç kësaj në skenë e nxori klasën punëtore. Në fazat që e pasuan Revolucionin Industrial në Evropë, duke i detyruar punëtorët të punojnë në kushte të dhimbshme, në Amerikë duke u shfrytëzuar robërit e sjellur nga Afrika (të cilët nuk konsideroheshin për një-rëz), bëheshin përpjekje për prodhimin e produkteve industriale maksimale me harxhime minimale. Me shitjen e këtyre mallrave në tregun e brendshëm dhe të jashtëm u arrit që vazhdimisht të shtohet kapitali investues. Në kolonitë e Azisë, Amerikës Jugore dhe të Afrikës ku popullata vendase përdorej si shërbëtore, sjellja e pamëshirshme dhe mendjemadhësia e njeriut të bardhë (rrënjët e të dyjave i gjejmë në Greqinë dhe Romën politeiste), torturat dhe trajtimi që nuk përputhet me dinjitetin njerëzor, konsideroheshin si gjëra normale. Çdo gjë e çmuar që ka

qenë nën tokën mbi të cilën këmbëzbathur ka ecur vendasi, si ari, argjendi, bakri, hekuri, kobalti etj., është nxjerrë dhe është transferuar në vendet eksploatuese dhe më vonë, produktet industriale të prodhuara nga lëndët e para, vendasve u janë shitur për një çmim që ua grabiste atyre furnizimin ditor. Në Meksikë dhe Peru, me dhjetëra mijë pjesëtarë të qytetërimeve të vjetra rrënja e të cilave sot është tharë, janë thurë në emër të kristianizmit dhe në tokat e tyre janë krijuar baza tregtare, industriale dhe ushtarake. Në Amerikën Veriore lëkurëkuqtë (indianët) me një politikë shfarosëse të vetëdijshme dhe me vendosmëri janë vrarë derisa janë sjellë në gjendje të ekzemplarëve të muzeumeve, janë zhdukur duke u lënë të uritur, ndërsa pjesa tjetër e tyre është burgosur nëpër "rezervate" të ngjashme me kopshtet zoologjike dhe janë degjeneruar duke iu nënshtuar alkoolit, bixhozit dhe prostitucionit. Me këto hapa, mbretërit, piratët (kusarët) dhe Kisha lidhën aleancë dhe të gjithë i mbushën arkat e veta të veçanta.

Inkuadrimi i Romës (së ndikuar nga qytetërimi grek), pas pranimit të kristianizmit, në strukturën politike, administrative dhe juridike të shteteve kristiane të mesjetës, lëvizjet e Renesansës dhe të Reformacionit të nxitura nga Humanizmi, fillimi i zhvillimit të metodës së shkencës moderne, Revolucioni Francez i vitit 1789, Revolucioni Industrial, Revolucioni i vitit 1848, Lufta e Parë Botërore, zhbërja e perandorive dhe lindja e shteteve nacionale, Revolucioni komunist i vitit 1918 (Revolucioni i Tetorit) dhe themelimi i Ruisë Sovjetike (BRSS-së), vazhdimi i konkurrencës midis shteteve të Evropës, Aleanca e Natos dhe ajo e Varshavës, Kombet e Bashkuara, lufta e ftohtë midis bllokut të Perëndimit dhe atij të Lindjes, zhbërja e Bashkimit Sovjetik, dhe ardhja e SHBA-ve në pozitë të liderit botëror paraqesin pikat kyç

të historisë së Perëndimit, duke filluar me qytetërimin grek dhe atë romak e deri në kohën aktuale. Pra, kemi të bëjmë me një qytetërim (qytetërimin perëndimor), i cili është formuar në mesin e këtyre ngjarjeve dhe i cili akoma e ruan ndikimin vet.

Sipas teorisë sime të qytetërimit të elaboruar në një-rën nga ligjëratat e mia pararendëse, sikur çdo qytetërim, ashtu edhe qytetërimi perëndimor duhet të ketë një besim dhe një sistem morali që është i lidhur me të (besimin). Teoria e zënë ngoje, në këtë pikë mu ashtu si duhet të jetë çdo teori shkencore, është abstrakte, e përgjithshme dhe formale, është purifikuar nga subjektivizmat personale dhe relativizmat shoqërore. Në korniza të kësaj teorie, besimi është me origjinë hyjnore ose njerëzore, i vërtetë ose i rremë, i cili i drejtohet shpirtit të individëve dhe i cili e lind një sistem të moralit. Atëherë pra për ta kuptuar qytetërimin perëndimor duhet ta fiksojmë mirë sistemin e besimit dhe të moralit mbi të cilin mbështetet i njëjti (qytetërim). Në syrin dhe mendjen e shumë njerëzve qytetërimi perëndimor bazohet në shkencë dhe në teknologji. Sipas relacionit të kulturës dhe qytetërimit të sqaruar në teorinë tonë, shkenca dhe teknologjia paraqesin elemente kulturore që janë produkt i kapacitetit të të menduarit simbolik. Në kulturën perëndimore ky element luan një rol shumë të rëndësishëm. Por, shkenca dhe teknologjia, janë një element në kulturën e shoqërive brenda rrethit të qytetërimit perëndimor, por megjithatë nuk janë themel i qytetërimit. Sepse, shkenca dhe teknologjia nuk janë as sistem i besimit e as i moralit. Ato janë një lloj i dijes dhe teknikës së ndreqjes, që janë produkt i intelektit të njeriut. Shkenca dhe teknologjia janë produkte kulturore dhe vazhdimisht pësojnë ndryshime. Pas këtij lloji të dijes dhe teknikës së ndreqjes qëndron një sistem i besimit dhe moralit. Sistemi

i besimit dhe moralit që është bazë e qytetërimit perëndimor, jo vetëm që e përbën themelin e strukturës shoqërore, por edhe siguron energji shpirtërore të njerëzve që "prodhojnë" shkencë dhe teknologji. Atëherë shtrohet kjo pyetje: Kush është ai sistem i besimit dhe moralit që është bazë e qytetërimit perëndimor?

Burimi nga ka lindur vetëdija e Evropës së sotme ose e qytetërimit perëndimor është besimi kristian. Kristianizmi është një faktor shumë i rëndësishëm historik që e ka qytetëruar Evropën. Është kristianizmi ai që Evropës në vend të tiranisë dhe pamëshirës i ka sjellë butësinë dhe mëshirën, në vend të mashtrimit të njerëzve dhe shfrytëzimit të tyre, drejtësinë dhe mirësinë, në vend të së drejtës së fuqisë, fuqinë e së drejtës, në vend të mendjemadhësisë, modestinë, në vend të famës dhe autoritetit të fituar duke i shtypur njerëzit, paqen, rehatinë që arrihen duke ju shërbyer njerëzve dhe duke e adhuruar Zotin. Kristianizmi - i cili ka lindur si reaksion karshi varfërisë së shtresave të gjera popullore në kuadër të pompozitetit të Perandorisë Romake, karshi gjakderdhjeve të shkaktuara nga fisnikët dhe degradimit moral si rezultat i moskontrollit të instiktit seksual - vuri theks të posaçëm mbi vlerën e çdo individi si rob i Zotit dhe ia mbajti anën të varfërit dhe të shtypurit. Kristianizmi në fillet e veta në mënyrë sekrete është përhapur në mes popullatës së varfër dhe të shtypur. Kristianët bile edhe tre shekuj pas lindjes së Isait (a.s.) ndiqeshin dhe shtypeshin. Në vitin 313 pas Isait (a.s.) mbreti Konstantin me Fermanin e Milanos kristianizmin e pranoi për fe zyrtare e cila mund të aplikohet lirshëm. Por, populli nuk e kuptoi plotësisht shpirtin e kristianizmit, andaj nuk i braktisi plotësisht specifikat spirituale dhe ritualet e fesë së vjetër. Pamëshirshmëria, adhurimi i fuqisë dhe moszgjedhja e metodave në drejtim të arritjes së suksesit nuk u shkulën

nga thellësitë e shpirtërave. Organizata e Kishës, me qëllim të tërheqjes së popullit kah vetja, për t'ia "ngjyrosur pak sytë" dhe për të ndikuar mbi të (popullin), shumë rituale të fesë së vjetër i futi në kristianizëm.

Me kalimin e kohës, Kisha u shndërrua në institucion hierarkik. Me anë të tagrave dhe dhuratave të tubuara nga populli, ajo arriti të bëhet pronare e tokave që shtriheshin deri në vendet tejdetare dhe fitoi të drejta dhe privilegje tregtare, si dhe uzina industriale. Në këtë mënyrë Kisha u shndërrua në një forcë ekonomike. Ajo, sovranitetin shpirtëror mbi njerëzit dhe ndikimin politik mbi mbretërit që e përdorte me mjeshhtëri, duke e shfrytëzuar gradualisht presionin, i shndërroi në një fuqi politike të shquar.

Kisha, me qëllim të mbrojtjes së fuqisë së vet shpirtërore, ekonomike dhe politike nga lëkundjet e ndryshme, mori iniciativë që ta ketë nën kontroll edhe botën e mendimit. Pasi që revelata e kristianizmit nuk është mbrojtur, klasa e priftërve i përgatiti ungjijt zyrtarë dhe besimin kristian e përcaktoi në trajtë të një doktrine. Kisha me qëllim të ruajtjes së dominancës së vet dhe mbajtjes së njerëzve në varshmëri ndaj saj, ndjeu nevojën për shprehjen e mendimit të vet në çdo çështje të kësaj bote dhe të botës së ardhshme. Kjo ndodhi për arsye se nëse në çfarëdo çështje, shprehet mendim i lirë jashtë Kishës, krijohet një nebulozë e mendimeve epilogu i së cilave nuk dihet. Nëse dikush, edhe përsikaj faktit se Kisha e ka caktuar të vërtetën në çdo temë, merr guxim dhe del me një mendim të tij personal, meritonte të quhej mëkatar dhe mosbesimtar, të shpallej heretik ose të lidhej për druri dhe të digjej. Shpirti i Romës për dominim me çdo kusht, që bazohej në fuqi, kishte depërtuar në Kishë bile edhe në ato etapa kohore kur akoma ishin të freskëta kujtimet nga periudhat kur besimtarët kristianë ndiqeshin,

torturoheshin dhe shfaroseshin (nga pushteti romak). Kristianët, bile edhe për mendimet dhe veprat më të virgjëra torturoheshin nën kthetrat e Kishës. Ja pra, në një ambient të këtillë mendimi skolastik, shekuj me radhë ka dominuar me botën e mendimit evropian. Idetë e Aristotelit, i cili ka shprehur mendime pothuajse lidhur me çdo çështje që të bie ndër mend, janë revizionuar nga Kisha dhe duke iu adaptuar kristianizmit të trajtës si e kuptonte ky institucion, janë shpallur për qëndrime zyrtare të firmosura (nga Kisha). Mendimtarëve që nuk donin t'u dalin probleme me Kishën mesjetare u mbetej që këto ide, të cilat konsideroheshin si të vërteta të pakontestueshme, t'i bëjnë premisa të arsyetimit dhe të nxjerrin përfundime logjike të tyre. Ja pra, mendimtarët e periudhës skolastike, në vend që të arsyetojnë mbi fenomenet e vrojtuar, ishin të detyruar që duke i lënë pas shpine vrojtimet, t'u japin përgjigje pyetjeve dhe çështjeve të çdo sferë duke i nxjerrë përfundimet e "aksiomave" kishtarë me anë të logjikës analoge deduktive. Kësisoj çështjet lidhur me planin e vrojtimit, zgjidheshin me një logjikë të mbyllur në vetvete, duke u nisur nga premisat e shpallura *a priori* si aksioma. Personat me bonsens që ishin kuriozë për të menduar rreth observimeve dhe që në bazë të tyre mundoheshin të jepnin sqarime të ndryshme nga sqarimet zyrtare, përnjëherë mallkoheshin. Kur e kemi parasysh faktin se jeta e Isait (a.s.) ishte legjendarizuar, se nuk ekzistonte një kopje e Ungjillit besnike ndaj burimit të revelacionit dhe se ungjijt ekzistues nuk ishin përkthyer në gjuhët kombëtare, mund të thuhet se kristianët nuk kishin njohuri rreth thelbit të fesë së vet. Kjo situatë, i pengonte besimtarët që ta shohin qartë të vërtetën se kërkesat joracionale të institucionit të Kishës nuk paraqesin fetarësi por despotizëm të bazuar në kuazireligjion.

Për ta kuptuar tabllon e zezë, lebetinë e Kishës mesjetare, mjafton të përkujtojmë disa gjëra, si p.sh. pretendimi i Kishës se besimtarët për të arritur shpëtim shpirtëror kanë nevojë për ndërmjetësimin e këtij institucioni, pastaj përmbytja e mendimit të lirë me pohimin se përgjigjet e të gjitha çështjeve i ka dhënë oligarkia kishtare, pohimi se mëkatshmëria është e ngjitur për njeriun qysh prej lindjes së tij, ide kjo që i nxin shpirtërat dhe e mbyt optimizmin jetësor, se bile edhe kristiani me më pak mëkate duhet të jetojë me bindjen se vetëm pse është njeri prej kohës së pafillim është mëkatar, domosdoshmëria për pranimin e mëkateve (rrëfimin) para priftit me qëllim të faljes së tyre, shndërrimi i frikës prej devijimit nga feja në terror, e pastaj përhapja e spiunazhit, rënia e njerëzve në një gjendje të dyshimit ndaj çdokujt, mbjellja e një spiritualiteti patologjik te njerëzit (si pasojë e shikimit me sy të keq në këtë botë dhe në mirësitë e saj), pagesa me para e faljes së mëkateve, jeta e njerëzve në presionin e daljes nga feja dhe shpalljes heretike, shpallja e grave për sihirbaze dhe djegia e tyre etj.

Ja pra, Rilindja (Renesansa) evropiane kuptimin e vet e ka fituar në kuadër të një perspektive të këtillë historike. Evropa me anë të Rilindjes ka dashur të zgjohet nga ankthi i Kishës mesjetare, e cila përmes bestytnisë, ekstremizmit dogmatik, terrorit, jotolerancës, eksploatimit fetar, internimit, djegies së njerëzve për së gjalli, kanosjes inkuizitore, mbytjes së mendimit etj., e kishte bërë jetën të padurueshme. Por, kundër Kishës e cila besimit i kishte dhënë formë të monstruoze, mund të luftohej vetëm me një besim tjetër. Realizuesit e Rilindjes, për të gjetur një burim të besimit, zbritën deri në traditën ideore greke dhe romake. Në rrafshin e mendimit dhe ndjenjave ata u endën nëpër veprat greke dhe romake dhe aty i gjetën dritat e një jete të njerëzve para

dekorit me zota të cilët kishin jetuar sipas dëshirave të veta. Njeriu ekzistonte edhe në letërsinë, filozofinë, pikturën, si dhe skulpturën greke dhe romake. Aty ekzistonte një botë që mund të vrojtohej dhe shijohej me anë të ndjenjave. Vërehej se shpirti i njeriut në ato vepra lirisht e ka shprehur veten. Njeriu nuk ishte identitet i shpirtit. Ekzistonte trupi i tij së bashku me bukurinë dhe shijet e veta. Mbi të gjitha këto ekzistonte racioja njerëzore që nuk varej nga një autoritet tjetër. Njeriu me anë të ndjenjave të veta mund ta përkapte botën e jashtme duke menduar të jepte gjykime. Kisha e kishte mohuar trupin, i kishte shtypur ndjenjat dhe e kishte mbytur mendjen. Në veprat greke dhe romake në plan të parë ishin natyra dhe njeriu, ndërsa zotat ishin si njëfarë dekori interesant i ngjarjeve që njeriu i formësonte përmes mendjes dhe pasioneve të veta. Zotat njerëzve u kishin dhuruar potenciale trupore dhe intelektuale dhe njeriu ishte i lirë që duke i përdorë ato kapacitete ta vërtetojë veten.

Ja pra, në një atmosferë të errësirës nga bota e ardhshme e legjendarizuar dhe të hegjemonisë absolute të Kishës, kristianët me një sy të ri në veprat greke dhe romake, e zbuluan imazhin e njeriut natyror dhe të lirë dhe shkaktuan lindjen e një orientimi ideor të quajtur *humanizëm*. Kjo mendësi bartte një shpirt që kish dallime të rëndësishme nga ai i veprave klasike. Grekët dhe romakët veprat e tyre i kishin krijuar konform asaj se si e kanë shikuar dhe ndjerë vetveten në kuadër të besimeve të veta. Ata nuk kishin tendenca për t'u çliruar nga ndonjëfarë presioni, andaj veten e shprehnin me një besim dhe bindje ku nuk tregonin reaksion ndaj organizimit hierarkik të një besimi. Nga ana tjetër, humanistët krijuan vepra duke u nisur nga reaksioni i tyre kundër Kishës. Lexuesit dhe studiuesit e pasionuar të veprave klasike ishte e pamundur të mos ndikohen nga autorët agnostikë ose



adhurues të zotave që nuk kanë vend në doktrinën kristiane. Për këtë arsye, reaksioni kundër Kishës, te shumica e humanistëve u shndërrua në reaksion kundër kristianizmit. Humanistët zhvilluan një politikë edukative që mbështetej në gjuhën greke e latine dhe në veprat klasike. Lëvizja humaniste që filloi në Itali, influencën e vet së pari e tregoi në artet plastike (si piktura dhe skulptura) dhe në letërsi e më vonë në shkencë dhe filozofi. Humanizmi, kah fundi i shekullit XVI, i përfshiu pothuajse të gjitha vendet e Evropës dhe u bë forcë shtytëse e konceptit të ri të njohurisë e cila nuk njihte burim tjetër pos arsyes, ndjenjave dhe shijeve të njeriut.

Edhe pse ndikimi i humanizmit në edukatën shkollore të Evropës përfundoi me një formalizëm dhe snobizëm intelektual, ndikimi i tij në shoqëri që i gjerë dhe i thellë. Reformacioni lindi në atmosferën e orientimit humanist. Ishte lëvizja humaniste ajo që Kishën e vuri në shënjestër të kritikave dhe që insistoi në studimin e Ungjillit me një kokë të lirë. Reformistët, të cilët me qëllim të shpëtimit nga qëndrimet e Kishës që e kishin shtrembëruar kristianizmin, iu kthyen shërbëtorëve të parë kishtarë dhe Ungjillit, me të përmbajturit e idesë se kjo botë është fazë përgatitore për botën e ardhshme, u ndanë nga humanistët. Humanizmi nuk arriti të bëhet lëvizje që do të përqafohet nga masat e gjera popullore për arsye se humanistët kishin mendësi aristokratësh, e cila ishte individualiste dhe egocentriste, andaj tepër e theksonin të kaluarën klasike. Por mendimi humanist, pasi që kishte depërtuar në botën e mendimeve të inteligjencisë, njerëzve të profesionit, shkrimtarëve, artistëve, mendimtarëve, pedagogëve, politikanëve, madje edhe të njerëzve të fesë (teologëve), grupacione këto me potencial për ta udhëhequr shoqërinë ose për t'i kahëzuar veprimtaritë shoqërore dhe për të ndikuar mbi botëkuptimin e shoqërisë,

u bë një faktor i rëndësishëm në formimin e botëkuptimit evropian "modernist".

Humanizmi, nuk ka qenë asnjëherë një lëvizje - siç mendojnë disa duke u nisur nga etimologjia e fjalës - e njerëzshmërisë, dashurisë ndaj njeriut dhe e ndihmës ndaj kësaj qenieje. Humanizmi e ka kuptimin e mosnjohjes së diturisë dhe vullnetit absolut të Zotit, e ka kuptimin e të besuarit se burimi i vetëm i autoritetit është mendja dhe vullneti/dëshira e njeriut. Nuk mund të thuhet se të gjithë humanistët kanë qenë (ose janë) ateistë. Por, në terminologjinë e gjuhëve evropiane qëndrimi i tyre ndaj Zotit, emërtohet me nocionin *deizëm*. Deistët edhe pse e pranojnë ekzistencën e një Zoti, e mohojnë fenë e bazuar në revelatë dhe moralin e mbështesin në natyrë dhe në dritën e mendjes së njeriut. Për këtë arsye deizmi paraqet njëfarë opoence ndaj kristianizmit. Doktrinat që e mohojnë Zotin si darvinizmi, bihejviorizmi, psikoanaliza frojdiane, marksizmi, materializmi dhe pozitivizmi, të cilat kanë ndikuar në strukturën mendore të botës moderne, në thelb janë sisteme metafizike. Pra, këto doktrina, edhe pse pohojnë se pasi që janë kundër metafizikës në të njëjtën kohë janë edhe kundër fesë, për nga cilësia e pretendimeve paraqesin sisteme metafizike, domethënë çdonjëra prej tyre është besim në vete. Por një gjë dihet - të gjitha shkencën e kanë përdorë si mburojë. Kurse e vërteta thotë se shkenca është metodologji, e jo sistem besimi. Shkenca e kuptuar drejt nuk është mburojë e asnjë sistemi metafizik. Doktrinat e përmendura më parë, si sisteme të besimit, e mohojnë Zotin e Lartmadhëruar. Ky mohim mund të bëhet vetëm mbi një platformë metafizike, e assesi mbi platformë shkencore. Por mbrojtësit e këtyre doktrinave, e kanë mohuar Zotin jo si shkencëtarë por si mendimtarë që kanë besuar në doktrinën e *scientizmit*. Sepse, shkenca për tema studimi i

merr vetëm fenomenet e observueshme, ndërsa subjektet që s'mund të vrojtohen i lë jashtë fokusit të hulumtimit dhe nuk shpreh mendim rreth tyre. Pranimi ose refuzimi në sferën e subjekteve të paobservueshme, nga pikëpamja shkencore paraqet besim metafizik. Shkenca përgjigjen në sferë të atyre subjekteve e sheh si një gjë jashtë detyrës dhe përgjegjësisë së vet. Shkenca paraqet zhvillim të mendimit që i sqaron fenomenet e observuara dhe verifikim të mendimit të njëjtë duke i marrë për argument observimet tjera. Shkenca, parimisht, asnjë mendim sqarues në asnjë shkallë ose fazë nuk e pranon për të vërtetë ekzakte. Ato pranohen për "të sakta" derisa mbështeten nga argumentet e vrojtimit dhe derisa të mos përgënjeshtrohen. Kurse, sistemet metafizike të përmendura më parë, edhe pse bëjnë vrojtme sikurse edhe shkenca, pretendimet e veta i prezentojnë si të preara dhe kanë shprehur qëndrime bile edhe në temat të cilat shkenca i ka shpallur si sfera jashtë instancave të veta. Përderisa shkenca është metodë hulumtuese, doktrina scientiste paraqet një qëndrim metafizik i cili ngërthen pretendime lidhur me temat përtej vrojtimit, që mbeten jashta fushës së shkencës. Scientizmi paraqet doktrinë të përkufizimit të botës së ekzistencës dhe mendimit me botën e vrojtueshme dhe mohimit të botës së pastudiueshme me metodat shkencore dhe shpalljes së saj si të pakuptimtë. Themeli mbi të cilin bashkohen të gjitha sistemet mendimore që nuk bazohen në shkencë, por në scientizëm, të cilat e kanë dhënë kontributin e vet në formimin e modernizmit evropian, është refuzimi i fesë me burim nga revelata dhe i urdhëresave dhe ndalesave të Zotit.

Shkenca e studion natyrën, por vetëm natyrën e vrojtueshme. Askush nuk duhet të mendojë se me anë të aftësive të veta ndiesore dhe mendjes së tij të kufizuar do të arrijë t'i zbulojë të gjitha sekretet e gjithësisë. Por,

me fillim të formimit të botës moderne, ideologjia progresiviste u bë element i pandashëm i botëkuptimit modern. Te njeriu u mboll bindja se potenciali i njeriut për të kuptuar dhe përparimi në njohuritë e tij nuk kanë kufi. Shkenca e bazuar në kolaboracionin midis ndjenjave dhe arsyes brendapërbrenda një metodologjie specifike, e zuri vendin kryesor në kokat intelektuale të Evropës.

Por, influenca shoqërore dhe intelektuale e shkencës e tejkaloi funksionin e saj. Humanizmi me pamje të shkencës dhe influenca mashtruese e sistemeve metafizike scientiste, religjionin e zbritën nga fronti shpirtëror i njeriut. Kjo gjendje hapi një vrimë në shpirtin e njeriut. Ai e humbi tërësinë e vet të personalitetit dhe kështu lindi arena e konfliktit të panevojshëm midis arsyes (racios) dhe besimit. Ky konflikt ishte i panevojshëm për arsye se pasi që shkenca e ka kufizuar veten me fenomenet e vrojtueshme të kësaj bote, njeriu pavarësisht nga shkenca, mund t'i besojë Zotit ose të mbetet mosbesimtar. Shkenca në çështjet që nuk mund të vrojtohen është neutrale, pa obligim dhe nuk shpreh mendim të vetin. Atëherë pra mund të thuhet se çështja e ekzistencës ose mosekzistencës së Zotit nuk mund të zgjidhet me anë të metodave shkencore. Në çështjet e këtilla njeriu vendos pavarësisht nga shkenca. Ky vendim, pa marrë parasysh se a është pozitiv ose negativ, duhet të ketë trajtë të besimit. Me metodat shkencore, nuk mund të fiksohet as ekzistenca, e as mosekzistenca e Zotit. Ndërmjet shkencës dhe fesë, midis racios dhe besimit, nuk ekziston fërkim ose konflikt, por përkundrazi, mund të bëhet fjalë vetëm për bashkëpunim. Vetëm parimet morale janë ato që i ka parapëlqyer njeriu, që njohuritë shkencore në lidhje me botën e vrojtueshme mund t'i përdorim për të mirën e njerëzisë. Humanizmi nuk arriti që ta bëjë dallimin midis dritës në thelbin e fesë dhe territ të hierarkisë së Kishës.

Për këtë arsye, humanizmi, në luftën kundër kësaj hierarchie, në vend që t'i përveshë mëngët për ta pastruar kristianizmin nga legjendat dhe bestytnitë, iu qas shkatërrimit të kësaj feje, ndërkaq reformacioni njerën rrënjë e ka në humanizëm, ndërsa rrënjën tjetër në luftën e perandorisë antipapiste dhe papëve që e mbronin pushtetin romak. Perandorët gjermanë, para Reformacionit insistonin që asnjë gjerman të mos gjykohet në gjyqin romak para se të dalë në gjyqin gjerman. Në këtë kontekst, Luteri (Luther) u gjykua në vendin e vet. Në shekullin XV, papët lidhën kontratë me monarki të ndryshme me qëllim të shtypjes së tendencave ose rrymave të ndryshme demokratike dhe lokale në kuadër të Kishës. Edhe pse qëllimi i papëve ishte në këtë drejtim, këto kontrata ndikuan që institucionet fetare të hyjnë nën ndikimin e pushteteve botërore (shekullare). Kjo rrugë e re çonte në drejtim të themelimit të kishave nacionale. Për këtë arsye duhet ditur se kishat e para nacionale datojnë qysh prej kohës para Reformacionit. Fillimi i themelimit të kishave nacionale në mesjetë, reformacionit i ka siguruar përkrahje institucionale.

Kultura e zhvilluar nga hulumtuesit humanistë dhe piktorët e Renesansës duke e marrë për epiqendër shpirtin pagan të antikitetit, njeriun e vende në plan të parë dhe në një pozicion qendror. Orientimi i tyre mendimor dhe intelektual ndikoi mbi ideologjinë dhe programin e Reformacionit. Lindja e besimeve të ndryshme fetare në kuadër të kualitetit neutral dhe objektiv të botëkuptimit shkencor në zhvillim e sipër u trajtua si një proces natyror. Luteri, duke e shfrytëzuar nacionalizmin gjerman i siguroi mbështetje kryengritjes së vet. Ai, në gjyqin e Worms Dietit, e mbrojti idenë për lirinë e ndërgjegjes së çdo individi përballë autoriteteve njerëzore. Sipas tij, çdo besimtar është rob i Zotit dhe është nën mbikqyrjen e Tij. Besimtari është përgjegjës para Tij, andaj duhet që

sjelljet e veta t'i orientojë sipas dritës së Zotit, e cila e ndriçon zemrën dhe ndërgjegjen e njeriut. Përkundër theksimit të disahershëm të Luterit se liria e ndërgjegjes duhet të funksionojë në korniza të së vërtetës së Ungjillit, zhvillimet e mëvonshme të cilat nuk mund të parashikoheshin, morën kahjen e lirisë së pakushtëzueshme të besimit madje edhe të reaksionit kundër idesë së fesë. Ekspansioni i shpejtë i lëvizjes së Reformacionit në Gjermani - edhe pse në fillim shikohej si përhapje e një tallasi të ri emocional të besimit që buron nga ndërgjegjja e individit - brenda 15-20 viteve lëshoi rrënjë dhe u forcua aq shumë, sa që devijimet fetare arritën ta mposhtin perandorin i cili luftonte për çrrënjosjen e këtyre devijimeve. Reformacioni në Zvicër u forcua në lidhshmëri me mendimet e Kalvinit, i cili edukatën humaniste e bashkoi me entuziazmin e thellë fetar dhe moral. Lëvizja e Kalvinit, e cila më tepër ishte e orientuar kah formimi i një komuniteti adhurues dhe asket, sesa kah pengimi i malverzimeve të Kishës dhe hegjemonisë së saj, përkrahjen dhe ndihmën kryesore e mori nga klasa tregtare, ndërsa fshatrat dhe qytezat i mbetën besnike katolicizmit. Kalvini më tepër u përpoq në drejtim të organizimit të protestantizmit, sesa në drejtim të shkatërrimit të katolicizmit. Në strukturën e lëvizjes kalviniste, e cila i jepte rëndësi pjesëmarrjes së popullit në instancat qeveritare, në përgjithësi dominonte disiplina autoritare. Kjo udhëheqje e bazuar në parime të vrazhdëta, nën mbikqyrjen e vet e mori edhe jetën ekonomike. Ajo e kundërshtoi luksozitetin dhe harxhimet e tepërta, kërkoi entuziazëm dhe punë të palodhshme, si dhe potencoi se punët e kësaj bote në të cilat arrihet sukses duke dhënë mund kanë domethënie hyjnore. Kalvini, edhe pse pa dëshirën e vet, duke e njohur fajden u desh të tregojë se e mbron interesin e qarkut tregtar-afarist të Gjenevës, i

cili lëvizjes ia kishte dhënë mbështetjen bazë. Në vendet e inkuadruara në protestantizëm si Holanda dhe Anglia, insistimi në përkthimin e Ungjillit në gjuhët amtare, i lidhi ngushtë ndërmjet vete lëvizjen e reformacionit fetar me lëvizjen për ngritjen e kulturave kombëtare. Njëri nga rezultatet e Reformacionit është edhe ky: pushteti nga duart e aristokracisë feudale dhe hierarkisë klerike që ishte në aleancë me të (aristokracinë), kaloi në duart e monarkisë dhe borgjezisë. Pos kësaj, Reformacioni në çështjen e udhëheqjes me popullin përmes doktrinės së besnikërisë ndaj parimeve të shkruara në Ungjill, organizimet dhe formacionet politike dhe fetare i kahëzoi në drejtim të kushtetutshmërisë. Në këtë mënyrë, ia hapi rrugën praktikës që komponentë e pashmangshme e autoritetit të jetë mendja e njeriut e bazuar në përvoja individuale të njeriut. Rindarja e pasurisë me anë të përvetësimit të pronës kishtare nga ana e njërezve të pallatit dhe anëtarët e klasës së mesme, zbutja e kufizimeve të bankierisë që kishin dominuar në Mesjetë dhe doktrina protestane që thoshte se me anë të punës në këtë botë arrihet shpëtimi në botën tjetër, ndikuan që kapitalizmi të bëhet fuqi e re e kohës moderne. Në këtë kontekst mund të thuhet se reformacioni në Evropë ka ndikuar në formimin e kulturave kombëtare, demokratike dhe kapitaliste.

Në thelbin e lëvizjes së humanizmit dhe reformacionit qëndron *individualizmi*. Edhe pse burimet thonë se termi *individualizëm* nuk është hasur deri në botimin e veprës së Tocqueville-it *De la démocratie en Amérique*, esenca e individualizmit si ide dhe shpirt ka ekzistuar edhe në lëvizjen humaniste dhe në kryengritjen e reformacionit. Në epikurizëm, nga i cili është ushqyer Humanizmi, thuhet se shoqëria nuk është asgjë tjetër pos shumë e individëve, se shteti dhe ligji janë belaja të domosdoshme të cilat duhet duruar dhe se njeriu është shumë

e ndjenjave dhe reaksioneve që mund të rezymohen si anim kah pasionet dhe ikje nga dhimbjet. Filozofia stoike, edhe pse duket si oponente e epikurizmit, nga aspekti i pohimit se duke qëndruar indiferent ndaj stimuluesve të jashtëm që shkaktojnë kënaqësi ose dhimbje mund të arrihet rehatia shpirtërore, njeriun e izolonte nga shoqëria dhe e mbyllte në vetvete. Sipas stoikëve, njeriu duhet të shpëtojë prej epsheve dhe duhet t'i marrë nën kontroll ndjenjat e veta deri në atë shkallë, sa që të mos mbetet më nën ndikimin e dhimbjes dhe kënaqësisë, ndërsa ndodhitë në natyrë duke i perceptuar si fenomene natyrore duhet t'i tolerojë dhe të mos e prishë qetësinë. Në këtë mënyrë nga aspekti i abstrahimit të individit nga shoqëria, të dy paradigmat filozofike dilnin në të njëjtën derë. Për formësimin e individualizmit modern, si shtojcë e këtyre ndikimeve filozofike kishte nevojë edhe për dy elemente. Njëri nga ta ishte vlera që kristianizmi ia kushtonte individit. Sipas revelatës kristiane individi, nuk duhej izoluar nga shoqëria, por rehatinë dhe shpëtimin mund ta arrinte vetëm duke u ndihmuar vëllezërve. Ky element i individualizmit, doli në skenë me fillimin e Reformacionit. Elementi i dytë ishte lindja e një sistemi ekonomik ku dominonte parimi i shkëmbimit, ngjarje kjo që ndodhi me zhvillimin e tregtisë dhe kapitalizmit nën prijësinë e klasës borgjeze.

Zhvillimet në drejtim të modernizmit nuk u kufizuan vetëm me zvogëlimin e ndikimit të hierarkisë së Kishës. Shtresat e gjera popullore emocionalisht i qëndronin besnik kristianizmit, Jezusit dhe Shën Mërisë, por zhvillimet në sferë të modernizmit ndikuan që evropiani besimin fetar ta hudhë në prapaskenën e jetës së vet. Kristianizmi veç më e humbi ndikimin e vet si një sistem besimi që e formëson jetën e përditshme të njeriut. Sjelljet e individit filluan të formësohen lirisht sipas kërkesave të



kësaj bote dhe sipas dëshirave të tij. Kristianizmi e humbi rolin e vet si faktor serioz në rrafshin ideor, politik, social dhe ekonomik. Përkundër kësaj, te njerëzit u mboll shpirti individualist, ideja për lirinë e individit dhe besimi se inidividi paraqet një vlerë të posaçme në shoqëri. Por, koha do të tregonte se individualizmi, që nuk ushqej me moralin kristian, ishte i përshtatshëm të shndërrohet në egoizëm. Orientimi i Humanizmit i cili e refuzonte mbinatyroren dhe i cili në vend të Zotit si vlerë më të madhe e tregonte njeriun e pastruar nga urdhërat dhe ndalesat e Tij, vinte duke i ndihmuar sa më tepër këtij orientimi. Si rezultat i domosdoshëm i këtij orientimi, mosdëshira e njeriut për të pranuar efekt tjetër jashtë natyrës së vet, pa marrë parasysh qëllimet e mira në fillim të rrugës, në fund njeriun do ta lë ballë për ballë me dëshirat, me tendencat, pasionin dhe përfitimin e vet. Përpyekja e utilitarizmit që nga orvatja e njeriut për ta arritur lumturinë duke vrapuar pas kënaqësive dhe duke ikur nga dhimbjet, të nxjerrë teori të moralit dhe politikës, mbështetej në arsyen e parimit vepror të lartpërmendur të sjelljes se numri më i madh i individëve do ta japë rezultatin e lumturisë më të madhe. Por, kjo arsye paraqiste vetëm një shpresë, pra nuk kishte as domosdoshmëri logjike e as themel në realitetin e marrëdhënieve shoqërore të njeriut. Postulati i utilitarianizmit i mbështetur në shpresë, u shndërrua në filozofinë se nëse çdokush e shikon interesin ose profitin e vet do të përparojë e tërë shoqëria. Ekonomia dhe politika u abstrahuan nga morali. Madje edhe shkolla *Laissez faire* ishte vepër e kësaj mendësie. Por, pas një kohe të shkurtër, u kuptua se një qëndrim i këtillë i politikës ekonomike dhe shoqërore është katastrofë dhe u konstatua se është e nevojshme që në forma të ndryshme të bëhen ndërhyrje sistematizuese.

Në shoqëritë evropiane, në të cilat kishte lëshuar rrënjë individualizmi - kapitalizmi i azdisur pas Revolucionit Industrial, sistemi nuk tregoi kurrfarë reagimi ndaj varfërisë së masave punëtore dhe "ushtrive" të të papunëve, ashtu që e çrregulloi balancin shoqëror dhe i shkeli normat morale. Ky ambient e lindi marksizmin dhe Revolucionin e vitit 1848. Ata që i jepnin vlerë individit, nuk e morën parasysh faktin se individit personalitetin e vet e fiton në shoqëri. Individualistët, nuk e vërejtën faktin se individit i pashpëtuar nga egoizmi i qenies biologjike dhe azgëllëku instiktiv (ngase shpëtimi nga to mund të realizohet me anë të edukatës që e ofrojnë institucionet shoqërore) nuk mund të fitojë personalitet. Socializmi i Marksit lindi si reaksion kundër shtyrjes së masave të gjera popullore në ujërat e varfërisë nga ana e kapitalizmit, i cili strukturën shoqërore e bazon në principin e profitit individual. Marksi pohoi se mundi i blëshëm i punëtorit është sjellë në pozitë të objektit të përdorur në sferën e prodhimit dhe në këtë mënyrë punëtori, i nxjerrë nga të qenët personalitet, është tjetërsuar ndaj shoqërisë dhe egos së vet. Socializmi i tij, të cilin ai e kishte projektuar me një qëndrim humanist dhe të cilin e prezentoj brenda kornizave të determinizmit historik, në Evropë nuk u bë fazë e ardhshme e paevitueshme e kapitalizmit. Kështu Rusia cariste, e cila në esencë ishte një shoqëri fshatare, si përfundim i një revolucioni të udhëhequr nga intelektualët idealistë, u shndërrua në regjim totalitar që e fshiu individin në tërësi.

Në botën moderne që i themi "Perëndim", ku i fuqim Evropën dhe SHBA-të, besohet se burimi i vetëm i së vërtetës është mendja e njeriut që mendon mbi përvojat e veta. Besohet se çdo individ është i lirë të japë vendim se ç'është e mirë për të. Besohet se kur bashkohen liria e mendimit dhe vendosjes së individëve, për shoqërinë

në tërësi, e më së paku për shumicën dërrmuese të saj do të ketë rezultate të mira. Paralel me këtë besim aplikohet edhe parimi i udhëheqjes me jetën me anë të autorizimit ligjdhënës të një kuvendi të bazuar në shumicën dërrmuese të votave dhe udhëheqjes me vendimin e një qeverie të formuar sipas parimit të njëjtë. Por, njerëzit janë në kërkim të vazhdueshëm të parimit i cili do ta determinojë përmbajtjen e ligjdhënësisë dhe ekzekutivës dhe i cili do ta sigurojë unitetin shoqëror. Çdo individ i cili mendon, e shpreh mendimin e vet specifik si ide ose si orientues të shoqërisë. Besimi individualist, pasi që paraqet liri në aspekt të caktimit të parimit mbi të cilin bazohet të menduarit vetanak dhe jeta në përgjithësi, shkakton lindjen e shumë besimeve tjera. Shumë sisteme filozofike, morale, ideologji, koncepte artistike, falli, mediumet, psikoanaliza, fetë me burim njerëzor, meditacioni, devijimet seksuale, anarkizmi, spiritualizmi, materializmi, komunizmi, nihilizmi, ekzistencializmi, pozitivizmi, darvinizmi, demokracia, nazizmi, fashizmi, feminizmi dhe shumë doktrina të vogla dhe të mëdha e paraqesin kandidaturën e tyre për ta kahëzuar jetën. Kështu si pasojë ka lindur fenomeni që njerëzit, fetë me burim nga revelata t'i shohin me skepsë. Atyre u është trumpetuar se duhet të jetojnë të lirë, ashtu që kanë mbetur në indefinitet dhe paqartësi në lidhje me atë se çfarë jete duhet jetuar.

*Kjo zbrazëti shpirtërore në të cilën kanë rënë njerëzit, ka shkaktuar destabilitet në jetën shoqërore, konflikte, shkatërrimin e familjes dhe rritjen e numrit të divorceve, faje seksuale, marrëdhënie seksuale jolegale, përhapje të disa sëmundjeve vdekjeprurëse si pasojë e prostitucionit dhe homoseksualizmit, alkoolizmin, përhapjen e narkomanisë deri në dimensione të rrezikut, maltretimin e fëmijëve në familjet e shkatërruara, delikuencën rinore, sëmundjet mentale, rritjen e numrit të vetëvrasjeve, shtimin*

e varfërisë paralel me shtimin e pasurisë, krijimin e një ambienti të vobektësisë së thellë ku fëmijët nuk do të mund të shfrytëzohen nga barazia në gjasat për zhvillim, përhapjen e egërsisë, çnjerëzisë, gjakderdhjes, eksploatimit, ekstremizmit dhe luftërave që sjellin psikopatizëm. Njerëzit e arsimuar dhe pushtetarët, të cilët duhej që popullit t'ia tregojnë rrugën e shpëtimit nga kjo gjendje tragjike në të cilën kishte rënë njerëzia, të gjitha këto dukuri që nuk përputhen me dinjitetin e njeriut i cilësojnë si shqetësime nga përparimi i qytetërimit.

Shkencëtarët objektivë të shoqërive perëndimore, të gjitha këto dukuri tragjike i studiojnë me sy kuantitativ, bëjnë analiza statistikore dhe mundohen të përcaktojnë se në këtë kaos cilat elemente janë të lidhura me elementet tjera sipas lidhjes kauzale (lidhjes shkak-pasojë). Vetëm në SHBA, në më tepër se 100 revista të shkencave shoqërore çdo muaj publikohen hulumtime të shumta të kësaj natyre dhe çdo vit botohen me qindra libra në lidhje me probelemt shoqërore. Në doracakun e titulluar *Directory of American Philosopher* figurojnë emrat e më tepër se 10.000 filozofëve që ligjërojnë nëpër universitetet e SHBA-ve dhe Kanadasë. Është publikuar se ekzistojnë mbi 175 revista filozofike dhe çdo vit botohen mbi 400 libra dhe mbi 4000 artikuj. Vetëm në SHBA, prej vitit 1960 e këndeje në fushën e filozofisë janë dhënë mbi 100.000 tituj doktrate. Nëse krijimtaria në sferën e filozofisë është e këtyre dimensioneve atëherë mund të pararendohet se në degët tjera është edhe më e pasur. Shkëlqimi i sukseseve të shkencave natyrore dhe teknologjisë e fascinojnë çdokënd. Por ç'e do kur as shkencat natyrore, as ato shoqërore e as filozofia nuk janë në gjendje t'i zgjidhin problemet e cekura më parë, të cilat janë të lidhura ngushtë me zbrazëtinë shpirtërore dhe degradimin shoqëror. Atëherë domosdo shtrohet pyetja:

vallë kush do t'i zgjidhë ato? Nga do të vijë zgjidhja? Është fat i keq që njëra palë e politikanëve energjinë e harxhojnë për t'i mbrojtur kolltuqet e tyre prej pushtetarësh (pozita), kurse pala tjetër (opozita) është drejtuar në drejtim të rrëzimit nga pushteti të pozitës. Ata nuk janë në gjendje (ose nuk duan) të gjejnë rrugëdalje nga kjo gjendje e dhimbshme e shoqërisë.

Sistemi i besimit dhe ai moral i qytetërimit perëndimor bazohet në (1) kristianizëm, (2) në orientimin pagan, që është përcjellë nga qytetërimi grek dhe ai romak dhe i cili kristianizmit i ka futur elemente të politeizmit dhe (3) në humanizëm e në individualizëm, i cili është dorë e zgjatur e humanizmit. Në këtë sistem të besimit dhe moralit të quajtur "qytetërim perëndimor", elementi i kristianizmit që do ta pengonte shndërrimin e individualizmit në egoizëm dhe adhurimin e fuqisë dhe suksesit në kuadër të orientimit pagan dhe plagosjen e indit shoqëror nga ana e pamëshirshmërisë, nuk e ka kryer funksionin e vet. Kristianizmi, në shoqëritë perëndimore nuk ka funksion tjetër pos lidhshmërisë emocionale të njerëzve dhe dekorit social. Ai nuk është në pozitë që të luajë rol të rëndësishëm në spektrin e sjelljeve të individëve dhe marrëdhënieve shoqërore. Zaten, tipari më karakteristik i sistemit të besimit dhe moralit të quajtur "qytetërim perëndimor" është shekullarizmi. Domethënia e shekullarizmit në rrafshin praktik është mbajtja ose nxjerrja e fesë jashtë jetës. Ditën e diel ai që dëshiron shkon në kishë, por pas daljes nga kisha, shpirti dominant në jetën e përditshme, nuk është shpirti i kristianizmit, i cili imponon butësi dhe mëshirë, por mentaliteti i shprehur në thënien e filozofit të çmuar të kohës së iluminizmit, Hobes-it, *homo homini lupus* që do të thotë "njeriu për njeriun është ujk". Bota shekulare është botë e atyre që e kanë parapëlqyer konkurrencën e egër, e atyre

që në rrugën e suksesit nuk njohin rregulla, e atyre që vobektësinë nuk e trajtojnë për gjendje të dhimbshme, por për paaftësi të turpshme, e atyre që pasi që nuk dinë kurrfarë parimi shpirtëror, mendjen ia kanë dorëzuar kthetrave të instiktit. Për këtë arsye, qytetërimi perëndimor, nuk mundohet që ta pengojë manipulimin e vrazhdë të individëve egoistë dhe grupeve eksploatuese (duke përfituar nga shkenca dhe teknologjia) me masat e gjera popullore, por përkundrazi ai, sipas parimit "çdokush le ta ruajë vetveten" e legalizon atë. Ky manipulim, pasi që nuk është i lidhur me asnjë besim, i udhëheq cilësitë e njerëzve me spiritualitet të zbehtë, siç janë instiktet seksuale, grykësinë, tendencën e arrogancës (që ekziston në thellësitë e dimensionit biologjik të njeriut), fitimin e fuqisë dhe mbisundimi me të tjerët. Qëllim i manipulimit është shtimi i profitit. Ky manipulim, i cili njeriun e bën të pësojë disfatë nga dimensionit i vet biologjik, paraqet cenim të dinjitetit njerëzor. Ironi e vërtetë është që individualizmi humanist i cili pretendon se është vlera më e madhe e njeriut dhe e cila nuk njeh dhe nuk pranon kurrfarë burimi mbinjerëzor të vlerave, në ombrellën e qytetërimin perëndimor ka lejuar që njerëzit të masovizohen në një trajtë ku nuk mund ta përdorin arsyen e vet.

Njerëzit janë hutuar në një gjendje të këtillë të galimatiasit. Jeta ku nuk njihet e Drejta dhe e Vërteta, nuk mund t'i sjellë lumturi njeriut. Bota shekulare, pasi që nuk është ndriçuar me dritën e Zotit të Lartmadhëruar, është larguar nga interesimi për të Drejtën dhe të Vërtetën. Kjo gjendje shpjegohet me një shprehje moderne: "E vërteta është relative". Pra, nëse nuk ekziston një i ditur, d.m.th. nëse nuk ekziston Zoti, nuk ekziston as e vërteta. Atëherë çdokush e mbron të vërtetën e vet. Fenomeni që i jep kuptim konceptit "e vërteta" është besimi në Zotin. Zoti është Ai që ka njohuri në detaje edhe

për atë që është në tokë edhe për atë në qiell, edhe për të dukshmen edhe për të padukshmen, edhe për sekretin e zemrës e edhe për të publikuarën. Zoti është Ai që di gjithçka. Është e pamundur që njerëzit ta themelojnë vëllazërinë dhe drejtësinë universale pa e respektuar këtë besim, pa iu përmbajtur urdhrave dhe ndalesave të Zotit. Ata që ndërgjegjen e bazojnë në mendjen e njeriut, njeriun e njohin aq pak, saqë nuk dinë se mendja e vetmuar do t'u nënshtrohet pasioneve dhe instikteve egoiste dhe se do ta "rehatojë" ndërgjegjen duke shpikur pretekste të ndryshme. Kurse Zoti e njeh njeriun, njërën nga krijesat e Tij të shumta, e di edhe urtësinë e dhurimit njeriut instiktin dhe mendjen, e di se këta dy janë të pamjaftueshëm për t'i siguruar njeriut paqe dhe për ta shpëtuar atë. Zoti njerëzit i këshillon që të besojnë dhe të sillen në përputhshmëri me urdhëresat dhe ndalesat e Tij. Zoti njeriut ia ka falur mendjen, por më vonë atë, e cila nëse mbetet e paudhëzuar, nëse nuk i nënshtrohet dëshirës së Tij pëson disfatë ndaj instikteve, e ka edukuar me nurin e besimit. Ai që nuk beson nuk e humb mendjen, por e fik dritën e cila ia tregon rrugën mendjes.

Filozofia e vetme e cila i drejtohet "shpirtit" të SHBA-ve, fuqisë më të madhe politike dhe ekonomike të kohës së sodit, është pragmatizmi. Sipas pragmatizmit e vërteta aq është relative, saqë ndryshon jo vetëm ndërmjet individëve por edhe vetëm për një individ. Sepse, pragmatizmi paraqet besimin se e vërteta vazhdimisht ndryshon sipas llogarisë së fitimit ose humbjes. E vërteta matet me atë se sa kryen punë në praktikë. E vërteta është ajo në çka realiteti i detyron individët të besojnë. Çdo individ, të vërtetën e ndërton me veprat e tij duke e pasur gjithmonë parasysh fitimin sa më të madh. Politika shtetërore e Amerikës bazohet mbi këtë filozofi. Por kjo filozofi nuk ka arritur që ta pengojë vetminë e individëve

me fatin e vet e as degradimet shoqërore. Struktura e familjes ka përjetuar një "tërmet të madh". Brenda shoqërisë është duke u shtuar një masë e cila nuk ndjen lidhshmëri ndaj asnjë institucioni shoqëror dhe ndaj asnjë sistemi të vlerave, një masë me instikte seksuale të pakontrolluara, që nuk di se ç'është e mira dhe mëshira, e cila mundohet t'i plotësojë kënaqësitë egoiste, e cila nuk ndjen kurrfarë përgjegjësie shoqërore dhe e cila nuk sheh për të vlefshme asgjë përveç fuqisë. Kjo masë e cila rritet, paraqet njëfarë tumori që duke e ngrënë shoqërinë nga brenda, më në fund do ta shkatërrojë.

Shkenca, këtë situatë e studion në mënyrë objektive. Por, për fat të keq nuk është duke e gjetur ilaçin. Sepse për shkencën (moderne/perëndimore-), njeriu është një datë (e dhënë) që është objekt studimi në dimension të abstraksionit. Kurse njeriu për ta rregulluar jetën e vet dhe për ta arritur lumturinë ka nevojë për besimin në Zot, i Cili i drejtohet shpirtit të tij, e udhëzon atë kah mirësia dhe e largon nga e keqja. Në shoqërinë moderne sundon kjo gjendje: Pikësëpari i bëhet barrierë individit që mos t'i vë vesh besimit në Zot dhe këshillave të Tij të cilat çojnë në mirësi dhe e pengojnë të ligën. Pasi që individët e shkatërrojnë jetën e vet dhe të të tjerëve, shkencëtarët fillojnë të hulumtojnë, psikologët mundohen të shërojnë, psikanalistët bëjnë përpjekje për të gjetur shkaqe në subkoshiencën e njeriut, burgjet shpresojnë përmirësimin e të dënuarve, gjyqet mundohen ta ndajnë të vërtetën nga e pavërteta dhe ta gjejnë fajtorin e kështu me radhë.

Tash shtrohen këto pyetje: Ky qytetërim i çuditshëm i cili individin e ka deprimuar shpirtërisht dhe e ka shkatërruar familjen, si do ta bashkojë njerëzimin; si do t'u gjejë zgjidhje çështjeve të njerëzimit? Sistemi i besimit dhe moralit i quajtur "qytetërim perëndimor", pasi që i ka themeluar institucionet publike zyrtare dhe pasi që



duke e përdorë teknologjinë ka arritur produktivitet, në të njëjtën kohë e ka shtuar edhe fuqinë e përgjithshme ekonomike dhe politike të shoqërive. Por, i njëjti ua ka hapur rrugët sëmundjeve shpirtërore dhe shoqërore dhe ka shkaktuar lindjen e negativiteteve që e grijnë strukturën shoqërore. Ky qytetërim akoma është i fortë, por në themelin e tij gjendet një cilësi që nuk përputhet me nevojat shpirtërore të njeriut dhe me vëllazërinë gjithbotërore për të cilën ai është i përmalluar.

Njerëzia është një tërësi. Çështjet e saj nuk mund të zgjidhen me qëndrim dyfytëresh. Përpyekjet për zgjidhjen e problemeve të një pjese të njerëzisë në shpinën e një pjese tjetër, gjithmonë si rezultat të pashmangshëm e kanë lindjen e problemeve të reja. Lumturia në këtë botë do të ekzistojë vetëm atëherë kur i tërë njerëzimi do të jetë i lumtur. Sepse, lumturia ekziston vetëm nëse përjetohet nga të gjithë. Nëse në njërën anë ekziston tirani, e nga ana tjetër i shtypuri, nuk do të mund të bëhet fjalë për lumturinë e asnjërës palë. Ky ligj vlen si për marrëdhëniet brendashoqërore, ashtu edhe për ato ndërshoqërore. Shkaku pse sot nuk mund t'u gjendet zgjidhje problemeve të njerëzimit nuk qëndron në mungesën e diturisë, por në kalbësinë e sistemeve të vlerave. Disa sisteme të vlerave nuk i marrin nën sqetulla bile as të gjithë pjesëtarët e një shoqërie, e aq më pak të gjithë njerëzinë. Për këtë arsye Kombet e Bashkuara nuk mund të sigurojnë unitet. Politika e privuar nga sistemi i vlerave të përbashkëta, nuk mund të bëhet tjetër gjë pos skenës së përleshjes së profiteve egoiste dhe pasioneve të këndellura. Sot në botë masa të mëdha të njerëzve vdesin nga varfëria, rrokullisen në kthetrat e sëmundjeve dhe epidemive të ndryshme, punojnë tërë ditën në kushte joshëndetësore duke e munduar trupin vetëm për një kafshatë buke, rënkojnë nën hijen e zullumit, nuk mund ta

drejtojnë barkun nga eksploatimi, vriten, priten, dhe zhduken nëpër rrëmujën e luftërave të padrejta dhe kështu bëhen sakrifica të terrorit. Vendimet politike dhe bisedat diplomatike nuk ndikojnë në jetën e njerëzve që jetojnë në mjerim dhe vobektësi. Politikanët dhe shkencëtarët të cilët nuk arrijnë ta ndryshojnë këtë panoramë të dhimbshme, përkundër kësaj, duke pasur për qëllim qytetërimin perëndimor, pohojnë se qytetërimi vazhdimisht përparon.

Veç ka dalë në shesh fakti se fuqitë politike, që i takojnë qytetërimin perëndimor dhe që dominojnë me botën janë hipokrite. Këto fuqi, nga njëra anë me një kënaqësi barbare dhe mizore të trashëguar nga qytetërimi romak e shikojnë terrorizimin e njerëzve, e nga ana tjetër me një nxitje që u shërben interesave të tyre vetanake flasin për cenimin e të drejtave njerëzore. Andaj te njerëzit veç më nuk mbretëron optimizmi, por pesimizmi. Parimeve të ftohta të shprehura me një përsosmëri gjeometrike, me tituj plot lajlelule rreth të drejtave njerëzore dhe të ngjashme, u mungon themeli i besimit i cili njerëzit i bashkon shpirtërisht. Kuptimin e kanë humbur si mbrojtja ashtu edhe cenimi i këtyre parimeve.

Ne vlerën e qytetërimin e shohim në një sistem të besimit dhe moralit i cili do ta bashkojë gjithë njerëzinë, do të sigurojë paqe dhe drejtësi dhe do të sjellë lumturinë e të gjithë individëve dhe shoqërive. Shpirti i qytetërimin perëndimor është nxirë deri në atë shkallë kur më nuk mund ta bart këtë vlerë. Ky qytetërim është ai i cili kristianizmin e ka reduktuar në dekor shpirtëror, i cili rrah gjoks se është kristian ekstrem duke e mohuar faktin se Islami është feja e Vërtetë, ky qytetërim i cili në vete bart racizmin biologjik dhe kulturor, i cili çdo gjë nga jeta e shoqërive brenda rrethit të qytetërimin të vet e tregon si shkallë të fundit të përparimit të njerëzimit në

sferë të qytetërimit, i cili pretendon se shoqëritë jashtë këtij rrethi do të mund të qytetërohen vetëm nëse u përngjajnë shoqërive perëndimore, i cili legalizon çdo lloj të amoralitetit dhe të profiterisë nën parullën e individualizmit dhe të drejtave njerëzore, i cili për hir të faktit se është trashëgimi nga qytetërimi klasik, i del zot shpirtit të botës politeiste greko-romake, shpirt ky adhures i fuqisë. Suksesi i qytetërimit perëndimor në fushë të shkencës dhe teknologjisë, dhe fuqia ekonomike, politike dhe ushtarake e arritur në bazë të këtij suksesi, është shkaktare që ky qytetërim i egër, një iluzion të qytetërimit t'ia imponojë gjithë botës si qytetërimi më i lartë. Botëkuptimi i qytetërimit perëndimor për balancin politik, i cili në vend të përdëllimit dhe mëshirës së kristianizmit e ka pëlqyer idealin e qytetërimit greko-romak për fuqi dhe superioritet (ideal ky i privuar nga koncepti i mirësisë), bazohet në mbjelljen e farës së ndarjes të popujt e shtypur, përçarjen e atyre shoqërive, konfliktin, dhe nga gjitha këto arritjen e përfitimit. Vallë ku do ta shpie njerëzinë përçarja brendashoqërore dhe ndërshoqërore?

Vallë a ekziston jashtë Islamit ndonjë burim i të vërtetës i cili mund ta shpëtojë njerëzimin nga kjo gjendje tragjike dhe i cili me të vërtetë do ta qytetërojë atë në tërësi? Islami është një fe universale e cila i drejtohet tërë njerëzimit, e cila të gjithë ata që besojnë i konsideron vëllezër. Sipas Islamit, prej krijimit të njeriut e deri më sot ekziston vetëm një fe autentike. Zoti është një dhe feja e Tij është një. Ajo fe është Islami. Zoti i Lartmadhëruar, me të gjithë peygamberët që i ka dërguar, i ka thirrë njerëzit që të shpëtojnë nga kaosi i shkaktuar nga instiktet e pafrenuara, nga krizat shpirtërore dhe kataklizmat shoqërore dhe të ecin drejt binarëve të fesë së Tij. Ata që nuk e pranojnë Islamin mund të jenë superiorë me dituri, teknologji dhe mund të dominojnë me njerëzit në saje

të kapitalit të vet, por sipas kriterit tonë të vlerës, nuk mund të pretendojnë për qytetërim. Është vetëm Zoti Ai që çdo gjë e di deri në detaje, fuqia më e madhe është e Tij, ndërsa thesaret e pakonsumueshme janë të më të Pasurit, të Zotit. Kur kalojmë nga plani i fiksimit të qytetërimeve në kuadër të kushteve të veta të formësimit, në planin e vlerësimit dhe gjykimit, me një objektivitet shkencor konstatojmë se ekziston vetëm një qytetërim i vërtetë - feja e Zotit, Islami. Feja e Zotit është fe e monoteizmit. Të gjithë njerëzit janë robërit e Zotit të vetëm, të pashoq. Ata nuk mund të pretendojnë për superioritet dhe sovranitet ndaj njëri-tjetrit. Vetëm Zoti është superior dhe sovran. Zoti i Lartë njerëzit i këshillon të bëjnë mirësi dhe të solidarizohen midis vete, të mos krijojnë tollovi, të besojnë dhe të bëhen vëllezër. Vallë, a mund të gjendet platformë më e bukur se kjo, e cila do të mund t'i bashkojë njerëzit?

Islami në mënyrë të përsosur e ka vënë baraspeshën ndërmjet individit dhe bashkësisë. Këtë botë (dunja) dhe atë të ardhshmen (ahiret) i ka shpurë në pozitë të tërësisë kompakte. Zoti në këtë botë edhe për besimtarin edhe për mosbesimtarin është i Gjithmëshirshëm (er-Rahmân), të gjithë njerëzve ua jep furnizimin (rizk) dhe i mbikëqyrë. Por, ata që duan ta shijojnë merhametin (mëshirën) e Zotit i Cili në botën e ardhshme është i Mëshirshëm vetëm për besimtarët (er-Rahîm), vrapojnë kah mirësia dhe e pengojnë të ligën. Asnjë sistem i besimit dhe moralit jashtë Islamit nuk ka sjellë parime metafizike dhe masa shoqërore për të evituar në mënyrë të plotë dhe të prerë egërsinë, maltretimin lëndor dhe shpirtëror dhe eksploatimin në relacionin njeri-njeri etj. Asnjë sistem i besimit dhe moralit nuk ka vurë theks dhe nuk ka këshilluar, duke iu drejtuar shpirtit, zemrës dhe mendjes së njeriut, sa Islami drejtësinë, dashurinë e ndërsjellë, punët

e mira, besnikërinë, besën, mosdëmtimin e shpirtit, pasurisë, nderit të tjetrit, kujdesin ndaj të drejtës së fqit, ndihmën ndaj të vobektit, bonjakut dhe të mbeturit në rrugë, mëshirën ndaj të sëmurëve, pleqve, bashkëshortit ose bashkëshortes, fëmijëve dhe prindërve etj. Zoti i Cili shpall se njeriut i cili nuk e mohon Atë dhe Ditën e Gjykimit, do të mund t'i falen të gjitha mëkatet, i Cili këshillon moskëputjen e shpresës në mëshirën e Tij, po ashtu ka shpallur se nuk do ta falë njeriun i cili vjen me hak të robit, po bile edhe nëse tërë jetën e ka kaluar duke bërë ibadet, se në këtë rast shpëtimi është i mundshëm vetëm me kërkimin e faljes nga personi ndaj të cilit është bërë faji. Vallë, a mund të ketë parim më të mirë se ky për jetësimin e kohezionit dhe drejtësisë shoqërore? Paraardhësit tanë të cilët e kanë pëlqyer këtë parim kanë thënë se: "Drejtësia është themeli i pronës dhe sovranitetit". Kushti i lumturisë së një shoqërie është jetësimi i drejtësisë.

Nuk ekziston rrugë tjetër e bashkimit të njerëzimit, pos hyrjes në Islam - i cili është qytetërim i vërtetë - dhe të kuptuarit e drejtë të Islamit nga ana e muslimanëve. Të gjitha çështjet e njerëzimit mund të rezymohen si çështje e pëlqimit nga zemra e burimit autentik të qytetërimit. Islami, paraqet besim se nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe se Muhammedi (a.s.) është robi dhe i dërguari i Tij dhe sjellje në përputhshmëri me urdhëresat dhe ndalesat hyjnore. Islami paraqet stilin jetësor të personit i cili e ka zgjedhur këtë fe. Islami është edukatë. Shteti paraqet një organizatë të themeluar nga njerëzit me qëllim të jetës brenda një rendi ose sistemi. Njerëzit e rritur me edukatë islame këtë organizatë ose institucion e udhëheqin në të mirë të njerëzve. Ata nuk bëjnë padrejtësi dhe shpërdorime. Çështja e udhëheqjes së shtetit është çështje e edukatës, ndërsa sjellja e njeriut në pushet sipas edukatës islame është çështje e të qenët i mirë.

Shpirti i Islamit nuk lejon që feja të shndërrohet në despotizëm ideologjik. Islami këshillon sjelljen me të mirë edhe ndaj jobesimtarit, përderisa ai nuk bën fesad, trazira dhe përderisa nuk bën përçmim dhe cenim të fesë. Besimtari i cili gjithmonë e ka parasysh se Zoti është i Mëshirshëm ndaj të gjithë robërve (er-Rahmân) nuk i bën keq dhe padrejtësi asnjë njeriu tjetër. Islami është zgjidhja e vetme e cila mund ta sigurojë shpëtimin, kohezionin dhe paqen shoqërore. Islami është qytetërimi i vetëm autentik. Jeta të cilën muslimani e merr shembull është jeta që përputhet me sunnetin e Muhammedit (a.s.). Ata që duan ta vlerësojnë Islamin, nuk duhet t'u referohen sjelljeve të disa muslimanëve injorantë dhe që e dëmtojnë Islamin, por traditës (sunnetit) së Muhammedit (a.s.). **Nëse Kur'ani Famëlart dhe Muhammedi (a.s.) nuk këshillojnë gjë tjetër pos mirësisë, atëherë obligim bëhet përpjekja për njoftimin dhe mbjelljen e edukatës islame te njerëzia.** Nëse te muslimanët ekzistojnë disa qëndrime dhe sjellje jo të pëlqyeshme, rruga e përmirësimit të tyre është përpjekja për përhapjen e edukatës së vërtetë islame.

Muslimanët me qëllim të fitimit të kënaqësisë së Zotit dhe të qenët të dobishëm për njerëzit duhet të merren me shkencë dhe të punojnë shumë. Këshillë e Muhammedit (a.s.) është që njeriu të fitojë dituri aq sa i mundëson mendja e tij. Muslimanit nuk i ka hije që ta shikojë ftohtë dhe ta përçmojë shkencën vetëm pse më vonë e kanë zhvilluar evropianët. Nëse njerëzit për të fituar shkencë vrapojnë kah Evropa dhe Amerika, muslimanit i takon që të zhvillojë shkencë të nivelit më të lartë. Nëse evropiani sundon me njerëzit në saje të fuqisë së fituar nga shkenca, muslimani duhet që të zhvillojë shkencë e cila do të shkojë në të mirë të njerëzisë dhe para së gjithash për ta fituar kënaqësinë e Zotit. Sepse,

shkenca ka të bëjë me studimin e rendit të vënë nga Zoti në botën të cilën e ka krijuar po Ai, ndërsa me anë të mendjes (që është dhuratë e Tij) duhet të përfitojë dituri dhe këtë dituri ta shfrytëzojë në të mirë. Rendi i fenomeneve natyrore, që nuk janë gjë tjetër pos shenjave që tregojnë fuqinë e pakufishme të Zotit është burim i një emocionaliteti hyjnor, kurse puna në rrugë të shkencës me këtë emocion paraqet një lloj ibadeti.

*Në Islam nuk lejohet armiqësia ndaj asnjë individi ose shoqërie. Shkaku pse e elaborojmë qytetërimin perëndimor është njohja e tij, mosmashtimi me shkëlqimin e jashtëm të tij dhe përkujtimi i vlerës së qytetërimit tonë. Superioriteti i qytetërimit tonë neve nuk na nxit në krenari, por në modesti. Sepse, zotëruesi i vërtetë i qytetërimit tonë është All-llahu i Lartmadhëruar. **Muslimani nuk lavdërohet, por ai lavdëron dhe (e) falënderon (All-llahun e Lartmadhëruar).** Si kërkesë e lavdërimit të Zotit, muslimani përlodhshëm në jetën e vet punon për realizimin e kualiteteve të larta që i ka dhuruar Zoti në esencën e qytetërimit. Muslimani i cili nuk e përdor mendjen, e cila po ashtu është dhunti e Tij, është njeri i cili nuk e njeh vlerën e dhuntisë. Në këtë kontekst, nuk duhet harruar se duke i hapur sytë, duhet të marrim nga metodologjia shkencore e cila ka përjetuar përparim në kuadër të qytetërimit perëndimor, nga teknikat mendore të çdo fushe, nga shkathtësitë teknologjike etj. Nuk është punë e njeriut të mençur që të distancohemi nga shkenca, sepse “të tjerët merren me shkencë duke e neglizhuar fenë”. Ky qëndrim, joshkencërinë dhe joshkathtësinë në sferë teknologjike i paraqet si kërkesa të besimit. Besimtari i cili nuk zhvillon shkencë duke e përdorë mendjen dhe i cili nuk ua lehtëson njerëzve punën duke prodhuar teknologji në saje të shkencës, nuk mund t'i shërbejë mirë fesë.*

Muslimani, duhet të përpiqet që në mënyrë të përsosur ta jetojë moralin islam, por në të njëjtën kohë

duhet të shpëtojë nga impotenca e joshkencërisë dhe pashkathtësisë. Shoqëria perëndimore dhe njerëzia në tërësi, kanë nevojë për Islamin. Po ashtu edhe shoqëritë muslimane, kanë nevojë ta kuptojnë mirë Islamin dhe shkencën, e cila është një element kulturor që ka lindur nën flatrat e qytetërimit perëndimor. Teoria e qytetërimit e elaboruar në kreun e tretë të këtij libri tregon se ndryshimi kulturor, i cili shoqërinë tonë do ta sjellë në gjendje që të zhvillojë shkencë mund të jetë në kornizat e qytetërimit islam. Pasi që ta dimë se ç'vlerë ka qytetërimi ynë dhe pas nxitjes së ndjenjave për mbrojtjen e tij duke ruajtur vetëbesimin, nuk ka pse të druajmë nga kontaktet dhe marrëdhëniet miqësore me evropianin, amerikanin dhe me tërë botën. Le të pasurohemi me shkencë, le ta pasurojmë jetën tonë, le të ndajmë nga kapitali ynë dhe le ta sjellim popullin tonë në nivelin jetësor që ai e meriton. Atëbotë shoqëria me moralin, diturinë dhe harmoninë sociale do të jetë në një gjendje kur secili do të jetë i lumtur. Ja pra, ndoshta atëherë e tërë bota do ta kuptojë se ilaçi të cilin e kërkon është në pranimin e Islamit dhe në të jetuarit ashtu si duhet të jetojë besimtari musliman. Nëse studiohet mirë jeta e Muhammedit (a.s.) do të vërehet se kjo është rruga e cila njerëzit do t'i tërheqë kah Islami dhe rruga e arritjes së paqes gjithbotërore. Muslimani, cilësitë të cilat All-llahu (xh.sh.) dëshiron t'i shohë te besimtari, duhet t'i mësojë duke e hulumtuar mirë Kur'anin dhe duke e marrë për shembull apo pish-tar Muhammedin (a.s.). Thelbi i Islamit është mirësi, e mirësinë e do çdokush. Njerëzit e kohës sonë janë të hutuar, gjenden në një situatë të kaosit, andaj e kërkojnë rrugën e shpëtimit. Sot çdokush ka nevojë për mirësi. Ndër cilësitë kryesore të muslimanit janë mirësia, butësia, falja e tjetrit dhe solidariteti. Në Islam njeriut nuk i lejohet t'i thejë zemrat e njerëzve. Aty fjala e bukur është



lëmoshë (sadaka). I Madhi Zot e ka ndaluar ashpërsinë dhe tejkalimin e kufirit. Ai bile edhe peygamberit të Tij të dashur i ka thënë *"Nëse ata (idhujtarët) refuzojnë, Ne nuk të kemi dërguar ty rojë të tyre, ti ke për obligim vetëm komunikimin."* (Kur'ani, esh-Shura, 48) Sot rruga më efektive e muslimanit për kumtimin e së vërtetës është të jetuarit e një jete përplot me sjellje të hijshme dhe mirësi, mu ashtu siç ka këshilluar Kur'ani Famëlart dhe siç na ka dhënë shembull i Dërguari i All-llahut. Me rëndësi është po ashtu që të mos bëjmë dialektikë të kotë me Perëndimin e as që të mos ndërhyjmë ashpër në jetën e njerëzve përrreth. Nëse njerëzit të ne shohin një stil jetësor shembullor, më në fund i mbledhin mendtë dhe vrapojnë kah ajo jetë.

Bota islame para vetes ka shumë mundësi dhe një obligim të madh në drejtim të shpëtimit të njerëzimit. Turqia, në kushtet e sotme, duke e bashkuar përvojën historike të prijësisë shekullore me botën islame dhe përfitimet nga kontaktet e përafërta me Perëndimin, mund ta ringjallë botën islame. Po ashtu duke e mbjellur mendësinë shkencore, mund ta ngrejë nivelin e të menduarit dhe shkencën prapë mund ta sjellë në pozitë të një institucioni shoqëror frytdhënës. Një sinkretizëm i këtillë në histori asnjëherë nuk është realizur. Përsikaj përparimit të madh teknologjik në njërën anë të botës, mund të thuhet se në rrënjët e krizës shpirtërore në të cilën sot ka rënë njerëzimi dhe në rrënjët e disekuilibre shoqërore qëndron mungesa e një sinkretizmi të kësaj natyre. Me të vërtetë stili jetësor që do të lind nga bashkimi i nivelit të lartë të mendimit dhe teknikave shkencore të zgjedhjes së problemeve me sistemin moral, do t'u japë përgjigje të gjitha çështjeve të njerëzimit. Bota islame ka gjasa të mëdha për realizimin e një gjëje të këtillë. Bota islame ose do ta arrijë një sukses të këtillë dhe do të bëhet shpresa e

njerëzimit, ose duke jetuar një jetë primitive të mbështetur me një pamje moderne, së bashku me tërë njerëzimin do të hapërojë kah një ardhmëri e mjegullt.

## Treguesi

### A

adhurimet (*ibadat*), 59  
afekti, 122  
afetarizmi, 122  
Afrika, 123  
agronomët, 89  
ahireti, 158  
Akadi, 86  
Akhenatoni, 100, 101  
aksiomatike, 25  
Aleanca e Natos, 132  
Aleksandri (Leka), 95  
Alkibiadesi, 115  
alkoolizmi, 149  
All-llahu, 161  
ambiguitetet, 55  
Amerika, 131, 153  
Amonhotepi, 100  
amoraliteti, 157  
Anadulli, 89, 92  
anarkizmi, 149  
antikiteti, 77, 143  
antropologjia, 9  
arena, 123, 142  
aristokracia feudale, 145  
Aristokratët, 106  
Aristoteli, 25, 114, 136

arsimimi, 22, 124  
arsyetimi konkret, 16  
arti, 29, 91, 95, 102, 113  
asirianët, 90, 91  
astrologjia, 81  
astronomia, 89, 102  
Asurbanipali, 91  
Athina, 105, 106, 111, 112, 115  
Atoni, 100  
autoriteti social, 84  
Azia e Vogël, 111

### B

babilonasit, 89, 92, 95  
Babilonia, 89, 90  
balanci shoqëror, 148  
bashkësia, 20, 98, 158  
Bashkimi Sovjetik, 132  
Bernard, Claude, 30  
Benedikti, Ruth, 39  
besimet, 38, 97, 138, 143, 149  
bestytnitë, 63, 81, 137, 143  
bihejviorizmi, 140  
blegtoria, 105  
borgjezia, 145  
bota e mendimit, 136  
bota islame, 163

bota politeiste greko-romake,  
157

botëkuptimet, 10, 39, 88

bujqësia, 52, 120

bukuria, 103, 104, 109, 117,  
138

burokratët, 89

## C

Cezari, 102, 123

*cité*, 77

## D

darwinizmi, 140, 149

deduksioni logjik, 45

degradimi, 116, 125, 134, 150

deistët, 140

deizmi, 140

dekori social, 151

delikuenca rinore, 149

Delosi, 112

demokracia athinase, 114

demosi, 115

despotizmi ideologjik, 160

determinizmi historik, 148

Deti i Zi, 123

devijimet seksuale, 149

dialektika e fjalës, 31

dija shkencore, 19

dijetarët perëndimorë, 38

diktatori, 83

dimensioni politik, 82

dinjiteti njerëzor, 152

Dita e Gjykimit, 159

dituria, 19, 34

drejtësia, 68, 100, 106, 114,  
117, 134, 153, 156, 159

dukuritë natyrore, 81, 103  
dunjaja, 158

## E

edukata, 22, 29, 108, 114,  
122, 139, 148, 159, 160

Egjipti, 12, 56, 74, 98, 124

ekonomia monetare, 82

ekspansioni, 144

eksploatimi, 95, 100, 131,  
137, 150, 156

ekstremizmi, 137, 150

ekzemplarët, 44, 132

ekzistenca, 38, 74, 113, 142

ekzistencializmi, 149

Elamiti, 87

elementet kulturore, 58, 60

energja shpirtërore, 54, 69

*Ensi*, 85

Epikuri, 122

Er-Rahîm, 158

Er-Rahmân, 158, 160

Eskili, 111

etika, 56

Eufrati, 77

evenimentet historike, 74

Evropa, 25, 131, 145, 148

*ezel*, 97

## F

familja, 20, 74, 83, 108

fantazia, 9, 50

fantazma, 104

faraoni, 97, 98, 99, 101, 102

fashizmi, 149

feja e Zotit, 158

feminizmi, 149

fenomenet, 10, 18, 22, 25,  
33, 43, 141, 142  
Fermani i Milanos, 134  
fesadi, 160  
feudalizmi, 131  
filozofia e moralit, 117  
filozofia e natyrës, 110  
filozofia stoike, 146  
fisnikët, 134  
Frankforti, Henri, 39  
frymëzimi hyjnor, 94  
fshatarët, 84  
fuqitë e padukshme, 59  
furnizimi (rizk), 158

## G

Galileu, 25  
psikologjia *geshtaltt*, 40  
Gokalp, Zija, 35, 49  
Gyngori, Erol, 38  
Greqia, 12, 56, 74, 111, 124  
Gubarru, 93  
Guti, 87

## Gj

Gjermania, 144  
gjuha, 17, 19, 22, 36, 87

## H

Hamurabi, 87  
harmonia sociale, 162  
hegjemonia, 121  
heretikët, 137  
hierarkia klerike, 145  
Hiksosi, 99  
hipoteza, 12, 22, 31

historia, 10, 29, 65, 74, 102,  
133  
hititët, 101  
Hobbesi, 151  
*homo politicus*, 39  
homoseksualizmi, 122, 149  
hulumtimi shkencor, 11, 40  
humanizmi, 147  
Humanizmi, 131  
hyjnor/e, 85, 133, 144, 159

## I

ideali, 110, 112, 114  
identitetet, 39, 53  
ideologjia, 143  
idetë, 31, 32, 49, 61, 117, 121  
*Iliada*, 103  
imazhi, 138  
imitimi, 65, 109, 120  
India, 56  
individit, 70, 113, 134, 143,  
146, 148, 154, 158, 161  
individualizmi, 122, 145,  
151, 157  
infrastruktura, 121  
institucioni, 73, 80, 108, 114,  
119, 137, 154, 163  
interaksioni, 20  
interpretimi, 108  
introspeksioni, 17, 19  
Isai, 25, 77, 85, 87, 89, 90,  
92, 95, 97, 99, 100, 101,  
103, 105, 106, 107, 111,  
112, 115, 116, 119, 120,  
121, 123, 124, 134, 136  
Islami, 129, 131, 157, 158,  
159, 162,

**J**

jeta ekonomiko-shoqërore,  
80

jeta shoqërore, 55, 66

Jetishi, Kazëm, 49

**K**

Kalvini, 144

Kanunet e Hamurabit, 87

kaosi, 110, 150

kapaciteti mental, 17

kapitali, 95

kapitalizmi, 145, 146, 148

Karnaktuti, 100

Kartagjena, 121

kasitasit, 89

katastrofa, 110, 147

Kisha, 132, 135, 138

klanet, 119

klasa e mesme, 145

Klistenesi, 107

koha, 32, 52, 135, 137, 143,  
145, 151, 162

kohezioni, 160

kolonitë, 106, 131

kombet, 35, 36

Kombet e Bashkuara, 132, 155

komedia, 108

kompaktësia, 85

komuniteti, 86, 87, 144

komunizmi, 149

konceptet, 10, 12, 17, 31, 117

konfederata, 112

konservatorizmi, 120

Konstantini, 134

konsujt, 119, 121

kontaktet politike, 66

Korinti, 115, 121

kristianizmi, 124, 131, 134, 146

kriza shpirtërore, 163

Kroberi, 37

kronologjia, 74, 92

kultura, 9, 10, 12, 22, 31, 32,  
33, 34, 35, 36, 37, 39, 43,  
46, 47, 48, 50, 51, 55, 58,  
59, 60, 62, 63, 65, 67, 68,  
70, 87, 91, 106, 108, 113,  
122, 125, 133

kultura lëndore, 38

kultura shpirtërore, 63

kultura zgjedhëse, 66

*Kulturvölker*, 36

Kur'ani Famëlartë, 129

**L**

Lagashi, 86

*Laissez faire*, 147

lidhja kauzale, 150

lidhjet strukturore, 67

liria e individit, 109, 147

Londra, 100

Lufta e Parë Botërore, 132

Lufta e Peloponezit, 112, 116

luftërat, 66, 87, 89, 91, 120,  
156

*lugal*, 83

Luteri (Luther), 143

**M**

MacIver, R. M., 35

magjia, 59, 91, 102

Maqedonia, 121

marksizmi, 148

marrëdhëniet ndërnjerëzore, 57, 120  
 marrëdhëniet shoqërore, 55, 67  
 matematika, 89  
 materializmi, 140, 149  
 meditacioni, 149  
 mendësia shkencore, 29, 30  
 mendimi, 16, 18, 20, 25, 26, 27, 29, 33, 36, 40, 43, 48, 61, 81, 89, 93, 98, 104, 110, 117, 124, 135, 137, 139, 148, 163  
 mendimtarët, 9, 32, 136, 139  
 Menesi, 97  
 mësimi, 16, 21, 74, 91, 116  
 mesjeta, 132  
 Mesopotamia, 12, 56, 74, 77, 84, 92, 124  
 metafizika, 62, 140, 141, 158  
 metoda aristoteliane, 25  
 metodologjia shkencore, 29, 47  
 Mileti, 105  
 mirësia, 100, 104, 117, 134, 137, 154, 157, 158, 160, 162  
 misioni politik, 116  
 mitologjitë, 22, 80, 110  
 mjekësia, 91  
 modernizmi evropian, 141  
 monarkia, 85, 97, 145  
 monogamia, 80  
 morali, 20, 54, 57, 59, 64, 66, 68, 69, 70, 75, 96, 105, 116, 124, 129, 133, 151, 156, 158

Muhammedi (a.s), 129  
 muzeumet, 132

## N

Naksosi, 105, 112  
*Naturvölker*, 36  
 natyra, 18, 26, 27, 37, 45, 49, 53, 55, 58, 59, 60, 68, 84, 98, 111, 147  
 nazizmi, 149  
 ndërmarra (iniciativa) individuale, 80  
 ndjenjat, 22, 38, 40, 91, 137, 138, 139, 142, 146, 162  
 ndryshimet kulturore, 12, 34, 70  
 ndryshimi teknologjik, 63  
 ndryshorët, 33  
 Nebushadnehari, 92, 94  
 ngritja shpirtërore, 60  
 nihilizmi, 149  
 Nili, 98  
 Ninevehu, 90  
 normat morale, 22, 148

## Nj

njeriu i kulturuar, 34  
 njohuritë, 22, 38  
 Nju Jorku, 100

## O

objektiviteti shkencor, 158  
 observimet, 11, 92, 141  
*Odiseja*, 103  
 optimizmi, 94  
 organizimi shoqëror, 82

## P

pabarazia, 87  
Palestina, 99  
pallati, 90, 93, 95, 101, 145  
paqja shoqërore, 160  
paradigmat filozofike, 146  
parafytyrimi, 76  
paragjykimi, 52  
parimet sqaruese, 18  
parlamenti, 82, 85  
Parthenoni, 110  
pasionet egoiste, 58  
patriçinjtë, 119  
*Pax Romana*, 123  
Perandoria Romake, 102, 134  
perceptimi, 15, 16, 18, 21, 40  
perëndimizimi, 48  
përgjegjësia shoqërore, 154  
Perikleu, 107, 115  
përkufizimet, 10, 31, 33, 38  
përleshja e Maratonit, 111  
pesimizmi, 78  
pikëpamjet, 19, 34, 37, 51, 57, 62, 81, 83  
piktura, 138  
piramida, 97  
Platea, 111  
Platoni, 117  
plebët, 119  
polisi, 108, 110, 115  
politika, 90, 147, 153, 155  
popujt barbarë, 124  
popullacioni, 44, 45  
postulati, 147  
pozitivizmi, 140, 149  
pragmatizmi, 153

premisat, 45, 47  
presioni, 84, 123, 135, 137, 138  
prestigji, 113  
priftërinjtë, 84, 87, 88, 94, 100, 101  
primitive, 37, 50, 52, 55, 59, 68, 164  
primitivizmi, 125  
profetizimet, 92  
projeksionet, 18, 54  
Protagora, 113  
provat, 26  
psikanaliza, 140  
psikopatizmi, 150  
puna produktive, 84  
pushtetet botërore, 143

## Q

qytetërimi, 9, 10, 12, 22, 31, 32, 34, 35, 36, 37, 38, 46, 47, 48, 49, 52, 53, 54, 56, 58, 60, 64, 65, 66, 67, 69, 70, 74, 75, 77, 84, 102, 110, 112, 114, 124, 129, 133, 134, 150, 152, 156, 157, 159, 161  
qytetërimi grek, 37, 111, 130, 133  
qytetërimi greko-romak, 157  
qytetërimi hindus, 129  
qytetërimi kristian, 130  
qyteti, 74, 77, 78, 82, 86, 95, 108, 111, 119  
qytet-shteti, 77, 82, 86, 105, 116, 123, 124



## R

racioja, 54, 118, 142  
racionaliteti, 59  
*raison d' être*, 74  
reaksioni emocional, 68  
Reformacioni, 131, 132, 143  
relativiteti, 113  
rendi i ri botëror, 130  
renesansa, 131, 132  
republika, 120  
Revolucioni Francez, 132  
Revolucioni Industrial, 131, 132  
Revolucioni komunist, 132  
robërit, 79, 87, 95, 108, 117, 131, 158  
Roma, 12, 100, 121, 122, 131  
Rusia cariste, 148

## Rr

rregulli demokratik, 107

## S

Sapir, E., 34  
sakrifica, 103, 156  
Samosi, 105  
Sargoni, 86  
satisfaksioni shpirtëror, 129  
*scientizmit*, 140  
sëmundjet shpirtërore, 155  
Senasheribi, 90  
senati, 119  
Sinani, Mimar (Arkitekt), 61  
Siria, 99, 101  
Sirusi, 95  
sistemet metafizike, 140

sistemi hidrolik, 92  
sistemi i besimit, 57, 58, 60, 61, 64, 69, 74, 134, 151, 154  
sistemi jetik, 67  
skulptura greke, 138  
socializmi, 148  
social-psikologët, 32  
sociologjia, 9  
sofistët, 113  
Sokrati, 117  
solidariteti, 76, 80, 84, 95, 162  
sovrانيتeti, 69, 159  
Spanja, 121  
Sparta, 105, 112, 115  
spiritualizmi, 149  
Stambolli, 100  
stoikët, 146  
strategjia e verifikimit, 26  
struktura e familjes, 154  
struktura ekonomike, 54, 69, 131  
struktura gjenetike, 21  
subkoshienca, 154  
Sulejmanija, 62

## Sh

SHBA-të, 132, 148, 150, 153  
Shekulli i Ri, 29  
shekulli i trimërisë, 105  
Shën Mëria, 146  
shërbimet publike, 113  
shkatërrimi i qytetërimeve, 12  
shkencat natyrore, 150  
shkencëtarët, 9, 30, 46  
shoqëria e qytetit, 82

shoqëria politike, 73  
shoqëritë, 37, 50, 59, 67, 68,  
73, 75, 84, 148, 151, 162  
shpëtimi personal, 99  
shprehitë, 61, 63  
Shtatë mrekullitë botërore, 92  
shtëpia e Zotit, 78  
shteti, 101, 105, 113, 115,  
121, 159

## T

Takitusi, 123  
terminologjia, 31, 44, 140  
të vërtetat ekzakte, 141  
të menduarit, 10, 16, 28, 35,  
57, 80, 105, 133, 149, 163  
të menduarit simbolik, 60  
Tebesi, 100  
teknologjia, 38, 62, 63  
tempulli, 78, 100  
tendencat instiktive, 58, 73  
teologët, 139  
teoria e qytetërimit, 12  
teoria shkencore, 11, 36, 43,  
51  
*terbije*, 22  
Tigri, 90  
tipologjitë, 10  
tjetërsimi, 37  
Tokëvili, 145  
tradita, 51, 61, 129  
tragjedia, 108  
Turhani, Mumtaz, 48

## Th

Thurnwald, R., 35

## U

udhëheqësit, 90, 120, 130  
Umma, 86  
Ungjilli, 136, 139, 144  
uniteti politik, 78  
uniteti shoqëror, 149  
Uri, 87  
urtësia, 114, 153  
Urukagina, 86  
utopia, 118

## V

veprat, 22, 51  
vëllazëria, 153, 155  
veprat filozofike, 37  
veprat heroike, 104  
veprat klasike, 139  
veprat kulturore, 61, 62  
vetëdija konceptuese, 17  
*virtus*, 121  
vlerat, 35, 63, 113  
vula hyjnore, 85

## Z

zakonet e mira (urf), 37, 61  
zbulesa hyjnore (vahj), 22  
Zoti, 78, 79, 91, 154, 157, 159

**Jëllmaz Ozakpënar**  
**KULTURA DHE QYTETËRIMI**  
**/NJË TEORI MBI QYTETËRIMIN/**

**Boton: Logos-A**

**Për botuesin: Adnan Ismaili**  
**Kryeredaktor: Husamedin Abazi**

**Redaktor gjuhësor: Isa Bajçinca**  
**Redaktor artistik & disenji: Edi Agagjyshi**  
**Redaktor teknik & faqosës: Azem Zaimi**

**Mbikëqyrës i shtypit: Imer Gogjufi**  
**Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup**  
**Shtypi: Focus - Prishtinë**

**Copyright©Logos-A, 2003**

**Shënimi i CIP katalogut i këtij libri gjendet**  
**në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare**  
**ISBN 9989-58-020-0**

**[www.logos-a.com.mk](http://www.logos-a.com.mk)**





Është lindur në vitin 1934 në Bajabat.

Në vitin 1957 është diplomuar në Universitetin e Stambollit, në Fakultetin e Letërsisë, degën e filozofisë, kurse në vitin 1960 në Universitetin e Kembrixhit, në Fakultetin e Biologjisë, në degën e psikologjisë.

Në vitin 1964 e ka mbrojtur disertacionin e doktoratës në Universitetin e Stambollit, në katedrën e psikologjisë eksperimentale.

Në vitin 1971 e ka fituar titullin e docentit, kurse në vitin 1978 atë të profesorit.

Në saje të bursës "Alexander von Humboldt", në periudhën 1972-74 ka bërë hulumtime shkencore në Universitetin e Kelnit, në Institutin e Hulumtimeve Sociologjike, kurse në vitin 1978 në Universitetin e Bernit, në degën e psikologjisë pedagogjike.

Gjatë viteve 1980-81 si "fullbright" profesor ka punuar në Universitetin e Oregonit, në degën e psikologjisë.

Në periudhën 1982-88 e ka ushtruar funksionin e dekanit të Fakultetit Pedagogjik në Universitetin Selçuk (Konja).

Është autor i disa veprave akademike të botuara si: Psikolojinin Temel Mefhumları (Konceptet themelore të psikologjisë), Öğrenmede Dikkat Problemi (Problemi i kujdesit gjatë të mësuarit), Hatırlama ve Tanıma Prosesleri ve Hafıza Yanılmalarının Doğuşu (Proceset e kujtimit dhe njohjes dhe lindja e mashtrimeve të kujtesës).

Aktualisht është anëtar i trupit mësues në Universitetin e Stambollit, në Fakultetin e Letërsisë, degën e psikologjisë. Tema të specializuara të tij janë "kujtesa", "të menduarit" dhe "teoria e intelektit".

ISBN 998958020-0



9 789989 580208